<p>kalimit kufitar dhe pas kontroleve të kryera kufitare i lejohet hyrja, në pajtim me dispozitat e këtij ligji, ligjit përkatës për kontrollin e kufirit, apo marrëveshjeve ndërkombëtare.</p> <p>2. Në rast të kalimit transit në Republikën e Kosovës, i huaji duhet të dëshmojë se i lejohet hyrja në vendin e destinacionit dhe se do të largohet nga territori i Republikës së Kosovës.</p> <p>3. I huaji obligohet që gjatë hyrjes, transitit, daljes dhe qëndrimit në Republikën e Kosovës të mbajë me vete dokument të vlefshëm udhëtimi, përveç në rastet kur parashihet ndryshe me legjislacionin në fuqi ose me marrëveshje ndërkombëtare.</p> <p>4. I huaji që është regjistruar në dokumentin e udhëtimit të personit tjetër mund të hyjë dhe të dalë nga territori i Republikës së Kosovës vetëm me personin në dokumentin e udhëtimit të të cilit ai është regjistruar.</p> <p>5. I huaji që ka hyrë në territorin e Republikës së Kosovës dhe ka më shumë se një shtetësi, obligohet që gjatë qëndrimit apo daljes së tij nga Republika e Kosovës të përdorë dokumentin e</p>	<p>the border crossing points and after the border controls, he or she is allowed to enter, in accordance with the provisions of this law, the relevant law on border control or international agreements.</p> <p>2. In case of transit through the Republic of Kosovo, a foreigner shall prove that he or she is allowed to enter the country of destination and that he or she will leave the territory of the Republic of Kosovo.</p> <p>3. A foreigner shall be obliged to hold a valid travel document during the entry, transit, exit and stay in the Republic of Kosovo, except in cases where it is provided otherwise by the applicable legislation or by international agreement.</p> <p>4. A foreigner who is registered in the travel document of another person can enter and leave the territory of the Republic of Kosovo only with the person in whose travel document he or she is registered.</p> <p>5. A foreigner who has entered the territory of the Republic of Kosovo and has more than one citizenship shall be obliged to use a valid document of the same country with whose document he or</p>	<p>nakon izvršenih graničnih kontrola mu je dozvoljen ulazak, u skladu sa odredbama ovog zakona, relevantnog zakona o graničnoj kontroli ili međunarodnih sporazuma.</p> <p>2. U slučaju tranzitnog prelaska preko Republike Kosovo, stranac mora dokazati da mu je dozvoljen ulazak u zemlju odredišta i da će napustiti teritoriju Republike Kosovo.</p> <p>3. Stranac je dužan da tokom ulaska, tranzita, izlaska i boravka u Republici Kosovo, nosi sa sobom važeću putnu ispravu, osim u slučajevima kada je drugačije određeno važećim zakonodavstvom ili međunarodnim sporazumom.</p> <p>4. Stranac koji je upisan u putnu ispravu drugog lica može da ulazi i da izlazi sa teritorije Republike Kosovo samo sa licem u čiju je putnu ispravu on upisan.</p> <p>5. Stranac koji je ušao na teritoriju Republike Kosovo i ima više od jednog državljanstva, dužan je da tokom svog boravka ili izlaska iz Republike Kosovo,</p>
--	--	---

<p>vlefshëm të shtetit të njëjtë me të cilin ka hyrë në Republikën e Kosovës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Hyrja e paligjshme</p> <p>1. I huaji konsiderohet se ka hyrë në mënyrë të paligjshme në Republikën e Kosovës nëse:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. kalon kufirin shtetëror jashtë pikave dhe orarit të përcaktuar për kalimin e kufirit;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. shmang kontrollin kufitar;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. përdor dokumente të falsifikuara udhëtimi, dokumente të një personi tjetër, apo një dokument të paautorizuar për të kaluar kufirin shtetëror të Republikës së Kosovës;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. ka hyrë në Republikën e Kosovës gjatë periudhës për të cilën ka ndalim të hyrjes.</p> <p>2. I huaji vlerësohet se ka hyrë në mënyrë të paligjshme në Republikën e Kosovës kur nuk ka shënime zyrtare të bëra sipas procedurave ligjore në fuqi në</p>	<p>she entered the Republic of Kosovo during his or her stay or exit from the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Article 6 Illegal entry</p> <p>1. A foreigner shall be considered to have illegally entered the Republic of Kosovo if he or she:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. crosses the state border outside the points and schedule established for crossing the border;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. avoids border control;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. uses falsified travel documents, documents of another person or an unauthorized document to cross the state border of the Republic of Kosovo;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. has entered the Republic of Kosovo during the period for which there is an entry ban.</p> <p>2. A foreigner shall be considered to have illegally entered the Republic of Kosovo when there are no official entries made according to the applicable legal</p>	<p>koristi važeću ispravu iste države kojom je ulazio u Republiku Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Član 6 Nezakonit ulazak</p> <p>1. Smatra se da je stranac nezakonito ulazio u Republiku Kosovo ako:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. prelazi državnu granicu van prelaza i vremena određenog za prelazak granice;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. izbegava graničnu kontrolu;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. koristi falsifikovane putne isprave, isprave drugog lica ili neovlašćenu ispravu za prelazak državne granice Republike Kosovo;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. ulazi u Republiku Kosovo tokom perioda kada ima zabranu ulaska.</p> <p>2. Smatra se da je stranac nezakonito ulazio u Republiku Kosovo kada nema službenih beleški izrađenih u skladu sa važećim zakonskim procedurama, u</p>
--	---	--

<p>dokumentin e tij të udhëtimit apo shënime në sistemet elektronike të kontrollit kufitar.</p> <p>3. Policia e Kosovës bën ekzaminimin, identifikimin, regjistrimin, profilizimin, referimin, ndërsa MPB bën akomodimin e përkohshëm dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme për të huajin me qëndrim të paligjshëm në territorin e Republikës së Kosovës.</p> <p>4. Rregullat për zbatimin e paragrafit 3 të këtij nenit si dhe procedurat, procesi i ekzaminimit, identifikimit, regjistrimit, profilizimit, referimit, të drejtat dhe detyrimet e të huajve të akomoduar, kohëzgjatjen e qëndrimit, si dhe menaxhimi i hapësirave akomoduese përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Ministri i MPB-së.</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Kriteret e përgjithshme të hyrjes së të huajit</p> <p>1. Të huajit i lejohet hyrja në Republikën e Kosovës për qëndrim në kohëzgjatje jo më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë në çdo periudhë njëqind e</p>	<p>procedures in his or her travel document or entries in the electronic border control systems.</p> <p>3. The Kosovo Police shall conduct the examination, identification, registration, profiling and referral, while MIA shall provide temporary accommodation and necessary services to foreigners with illegal stay in the territory of the Republic of Kosovo.</p> <p>4. The rules for the implementation of paragraph 3 of this Article and the procedures, the process of examination, identification, registration, profiling, referral, the rights and obligations of the foreigners accommodated, the duration of stay, as well as the management of the accommodation spaces shall be determined by a bylaw adopted by the Minister of MIA.</p> <p style="text-align: center;">Article 7 General criteria for the entry of foreigners</p> <p>1. A foreigner shall be allowed to enter the Republic of Kosovo for a stay of no longer than ninety (90) days in each one hundred and eighty (180) day period if he or she meets the following conditions:</p>	<p>njegovoj putnoj ispravi ili beleške u elektronskim sistemima granične kontrole.</p> <p>3. Policija Kosova vrši ispitivanje, identifikaciju, registraciju, profilisanje, upućivanje dok MUP vrši privremeni smeštaj i pružanje usluga strancima sa nezakonitim boravkom na teritoriji Republike Kosovo.</p> <p>4. Pravila za sprovođenje stava 3. ovog člana, kao i procedure, proces ispitivanja, identifikacije, registracije, profilisanja, upućivanja, prava i obaveze smeštenih stranaca, trajanje boravka, kao i upravljanje smeštajnim prostorijama, utvrđiće se podzakonskim aktom koji donosi ministar MUP-a.</p> <p style="text-align: center;">Član 7 Opšti kriterijumi za ulazak stranca</p> <p>1. Strancu se dozvoljava ulazak u Republiku Kosovo za boravak u trajanju od najviše devedeset (90) dana u okviru perioda od sto osamdeset (180) dana, ako ispunjava sledeće uslove:</p>
---	---	---

<p>tetëdhjetë (180) ditore, nëse ai plotëson kushtet si në vijim:</p> <p>1.1. posedon dokument të vlefshëm të udhëtimit, të njohur nga Republika e Kosovës i cili plotëson kriteret e mëposhtme:</p> <p>1.1.1. ka afat vlefshmërie të paktën tre (3) muaj prej datës së synuar të përfundimit të qëndrimit në territor, ose dokument tjetër të autorizuar për kalimin e kufirit shtetëror;</p> <p>1.1.2. është lëshuar brenda dhjetë (10) viteve të fundit.</p> <p>1.2. ka vizë hyrëse të vlefshme kur viza kërkohet, apo ka leje qëndrimi të vlefshëm të Republikës së Kosovës;</p> <p>1.3. arsyeton qëllimin, kushtet e hyrjes dhe qëndrimit, si dhe dëshmon se ka mjete të mjaftueshme financiare për jetesë, qoftë gjatë kohëzgjatjes së qëllimit të qëndrimit në Republikën e Kosovës dhe për kthim në vendin e origjinës, apo transit në vendin e tretë në të cilin është i sigurt së do të pranohet, apo është në gjendje që ato mjete t'i fitojë ligjërisht;</p>	<p>1.1. possesses a valid travel document, recognized by the Republic of Kosovo, which meets the following criteria:</p> <p>1.1.1. has a validity period of at least three (3) months from the intended date of the end of the stay in the territory or other document authorized for crossing the state border;</p> <p>1.1.2. is issued within the last ten (10) years.</p> <p>1.2. has a valid entry visa when a visa is required, or has a valid residence permit of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.3. justifies the purpose, conditions of entry and stay as well as proves that he or she has sufficient subsistence funds, either during the duration of the purpose of stay in the Republic of Kosovo and for returning to the country of origin or transit to the third country in which he or she is sure he or she will be accepted or is able to acquire those funds legally;</p>	<p>1.1. poseduje važeću putnu ispravu, koju priznaje Republika Kosovo, koja ispunjava sledeće kriterijume:</p> <p>1.1.1. ima rok važenja od najmanje tri (3) meseca od ciljnog dana za završetak boravka na teritoriji ili drugu ispravu ovlašćenu za prelazak državne granice;</p> <p>1.1.2. je izdata u poslednjih deset (10) godina.</p> <p>1.2. ima važeću ulaznu vizu kada se traži viza, ili ima važeću dozvolu za boravak Republike Kosovo;</p> <p>1.3. opravdava cilj, uslove za ulazak i boravak i dokaže da ima dovoljna finansijska sredstva za život, kako za vreme nameravanog boravka u Republici Kosovo, tako i za povratak u zemlju porekla ili tranzita u treću zemlju u kojoj je uveren da će biti primljen, ili je u stanju da ta sredstva stekne zakonito;</p>
--	--	--

<p>1.4. nuk ka ndalesë të hyrjes në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.5. nuk përbën kërcënim për sigurinë shtetërore, rendin publik dhe shëndetin publik në Republikën e Kosovës.</p> <p>2. Në rast të kalimit transit, përveç kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, i huaji duhet të posedojë dokument i cili i mundëson hyrjen në shtetin e destinacionit.</p> <p>3. Me qëllim të llogaritjes së afatit të qëndrimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, data e hyrjes së parë konsiderohet si dita e parë e qëndrimit në territorin e Republikës së Kosovës, ndërsa data e daljes konsiderohet si dita e fundit e qëndrimit.</p> <p>4. Hyrja në dhe dalja nga Republika e Kosovës e të huajit brenda ditës llogaritet një ditë qëndrimi.</p> <p>5. Të huajit i cili nuk i plotëson njërin ose më shumë nga kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, i lejohet hyrja në Republikën e Kosovës në një pikë të caktuar të kalimit kufitar, nëse kjo</p>	<p>1.4. has no entry ban to the Republic of Kosovo;</p> <p>1.5. does not pose a threat to state security, public order and public health in the Republic of Kosovo.</p> <p>2. In case of transit, in addition to the conditions defined in paragraph 1 of this Article, the foreigner shall possess a document that enables him or her to enter the country of destination.</p> <p>3. In order to calculate the period of stay defined in paragraph 1 of this Article, the date of first entry shall be considered as the first day of stay in the territory of the Republic of Kosovo, while the date of exit shall be considered as the last day of stay.</p> <p>4. Entry to and exit from the Republic of Kosovo of a foreigner within a day shall be counted as one day of stay.</p> <p>5. A foreigner who does not meet one or more of the conditions defined in paragraph 1 of this Article shall be allowed to enter the Republic of Kosovo at a certain border crossing point if this is</p>	<p>1.4. nema zabranu ulaska u Republiku Kosovo;</p> <p>1.5. ne predstavlja pretnju po nacionalnu bezbednost, javni red i javno zdravlje u Republici Kosovo.</p> <p>2. U slučaju tranzitnog prelaska, pored uslova utvrđenih u stavu 1. ovog člana, stranac mora imati ispravu koja mu omogućava ulazak u zemlju odredišta.</p> <p>3. U cilju izračunavanja roka boravka utvrđenog u stavu 1. ovog člana, datum prvog ulaska smatraće se prvi dan boravka na teritoriji Republike Kosovo, dok će se datum izlaska smatrati poslednji dan boravka.</p> <p>4. Ulazak i izlazak stranca iz Republike Kosovo u toku dana računa se kao jedan dan boravka.</p> <p>5. Strancu, koji ne ispunjava jedan ili više uslova utvrđenih stavom 1. ovog člana, dozvoljen je ulazak u Republiku Kosovo na određenom graničnom prelazu, ako se to traži iz humanitarnih razloga, državnih</p>
---	--	--

<p>kërkohet për arsye humanitare, interesa shtetërore ose detyrime ndërkombëtare të Republikës së Kosovës.</p> <p>6. Përjashtimisht paragrafit 1 të këtij neni, Qeveria e Republikës së Kosovës me vendim mund të përcaktojë kriteret e hyrjes, kohëzgjatjen e qëndrimit dhe dokumentet e nevojshme për hyrjen dhe qëndrimin në raste të caktuara të të huajve në Republikën e Kosovës.</p> <p>7. Ministri i MPB-së me vendim përcakton shumën e mjeteve të mjaftueshme financiare për jetesë dhe listën jo-shteruese të dokumenteve shtesë të cilat mund t'i kërkohen të huajit në mënyrë që të verifikojë plotësimin e kushteve të përcaktuara në nën-paragrafin 1.3. të këtij neni.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Refuzimi i hyrjes së të huajit në Republikën e Kosovës</p> <p>1. I huaji i cili nuk i plotëson kushtet për hyrje të përcaktuara me këtë ligj, i refuzohet hyrja në territorin e Republikës së Kosovës dhe i lëshohet vendimi me arsyetim për refuzimin e hyrjes.</p>	<p>required for humanitarian reasons, state interests or international obligations of the Republic of Kosovo.</p> <p>6. In derogation from paragraph 1 of this Article, the Government of the Republic of Kosovo may by decision determine the entry criteria, the duration of stay and the necessary documents for the entry and stay of certain cases of foreigners in the Republic of Kosovo.</p> <p>7. The Minister of MIA shall, by a decision, set the amount of sufficient subsistence funds and the non-exhaustive list of additional documents that may be required from a foreigner in order to verify the fulfilment of the conditions defined in subparagraph 1.3. of this Article.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Refusal of a foreigner's entry to the Republic of Kosovo</p> <p>1. A foreigner, who does not meet the conditions for entry defined by this Law, shall be refused entry to the territory of the Republic of Kosovo and a decision is issued with reasons for the refusal of entry.</p>	<p>interesa ili međunarodnih obaveza Republike Kosovo.</p> <p>6. Izuzetno od stava 1. ovog člana, Vlada Republike Kosovo može odlukom da utvrdi kriterijume za ulazak, trajanje boravka i potrebna dokumenta za ulazak i boravak u određenim slučajevima stranaca u Republici Kosovo.</p> <p>7. Ministar MUP-a Odlukom utvrđuje iznos dovoljnih finansijskih sredstava za život i neiscrpan spisak dodatnih dokumenata koji se mogu tražiti strancu radi provere ispunjenosti uslova utvrđenih u tački 1.3. ovog člana.</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Odbijanje ulaska stranca u Republiku Kosovo</p> <p>1. Strancu, koji ne ispunjava uslove za ulazak utvrđenih ovim zakonom, biće mu odbijen ulazak na teritoriji Republike Kosovo, i izdaće mu se odluka sa obrazloženjem odbijanja ulaska.</p>
---	--	---

<p>2. I huaji ka të drejtë që kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni të parashtrojë ankesë në Komisionin e Ankesave për të Huajt. Ankesa kundër vendimit për refuzim të hyrjes nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit.</p> <p>3. Procedurat për refuzimin e hyrjes si dhe forma standarde e vendimit për refuzim të hyrjes përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Ministri i MPB-së.</p> <p>4. Përbërja, detyrat, përgjegjësitë dhe procedurat e vendimmarrjes së Komisionit të Ankesave për të Huajt rregullohen me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës pas propozimit të Ministrit të MPB-së.</p> <p>5. Shtetasit e huaj apo personat pa shtetësi të cilët shprehin qëllimin e tyre që të aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Kosovës trajtohen si aplikantë, në pajtim me dispozitat e ligjit përkatës për azil.</p>	<p>2. A foreigner may appeal with the Foreigners' Appeals Commission against the decision from paragraph 1 of this Article. The appeal against the decision to refuse entry shall not stay the execution of the decision.</p> <p>3. The procedures for refusal of entry as well as the standard form of the decision for refusal of entry shall be defined by the bylaw adopted by the Minister of MIA.</p> <p>4. The composition, duties, responsibilities and decision-making procedures of the Foreigners' Appeals Commission shall be regulated by a bylaw adopted by the Government of the Republic of Kosovo at the proposal of the Minister of MIA.</p> <p>5. Foreign nationals or stateless persons, who express their intention to apply for international protection in the Republic of Kosovo, shall be treated as applicants in accordance with the provisions of the relevant Law on Asylum.</p>	<p>2. Stranac ima pravo da podnese žalbu na odluku iz stava 1. ovog člana Žalbenoj komisiji za strance. Žalba na odluku o odbijanju ulaska ne obustavlja izvršenje odluke.</p> <p>3. Procedure za odbijanje ulaska, kao i standardni obrazac odluke o odbijanju ulaska utvrđuje se podzakonskim aktom kojeg donosi ministar MUP-a.</p> <p>4. Sastav, dužnosti, odgovornosti i procedure odlučivanja Žalbene komisije za strance biće uređeni podzakonskim aktom, koji usvaja Vlada Republike Kosovo na predlog ministra MUP-a.</p> <p>5. Sa stranim državljanima ili licima bez državljanstva, koji izražavaju svoju nameru da podnesu zahtev za međunarodnu zaštitu u Republici Kosovo, postupano će se kao sa podnosiocima zahteva u skladu sa značenjem odredaba relevantnog Zakona o azilu.</p>
---	---	---

<p align="center">Nënkapitulli 2 Dalja e të Huajve</p>	<p align="center">Subchapter 2 Exit of foreigners</p>	<p align="center">Potpoglavlje 2 Izlazak stranaca</p>
<p align="center">Neni 9 Dalja e të huajit nga Republika e Kosovës</p> <p>1. I huaji mund të dalë lirshëm nga Republika e Kosovës.</p> <p>2. Të huajit i ndalohet dalja nga Republika e Kosovës, me vendim të Policisë së Kosovës, për arsyet e mëposhtme:</p> <p>2.1. i huaji posedon dokument udhëtimi të huaj të pavlefshëm, dokument të falsifikuar, apo përdor dokument udhëtimi autentik të personave të tjerë;</p> <p>2.2. i huaji nuk i plotëson kushtet për hyrje në shtetin tjetër;</p> <p>2.3. për të huajin ekziston dyshimi i bazuar se do t'i shmanget ndjekjes për vepër penale, ekzekutimit të dënimit, urdhër-arrestit apo letërreshtimit;</p>	<p align="center">Article 9 Exit of foreigners from the Republic of Kosovo</p> <p>1. A foreigner may leave the Republic of Kosovo freely.</p> <p>2. A foreigner shall be prohibited from leaving the Republic of Kosovo by decision of the Kosovo Police on the following grounds:</p> <p>2.1. a foreigner possesses an invalid foreign travel document, a forged document or uses an authentic travel document of other persons;</p> <p>2.2. a foreigner fails to meet the conditions for entering the other country;</p> <p>2.3. there is a grounded suspicion that the foreigner will avoid prosecution for a criminal offence, the execution of a sentence, an arrest warrant or a wanted notice;</p>	<p align="center">Član 9 Izlazak stranca iz Republike Kosovo</p> <p>1. Stranac može slobodno da izlazi iz Republike Kosovo.</p> <p>2. Strancu se zabranjuje izlazak iz Republike Kosovo odlukom Policije Kosova iz sledećih razloga:</p> <p>2.1. stranac poseduje nevažeću tuđu putnu ispravu, falsifikovanu ispravu ili koristi verodostojnu putnu ispravu drugih lica;</p> <p>2.2. stranac ne ispunjava uslove za ulazak u drugu državu;</p> <p>2.3. za stranca postoji osnovana sumnja da će izbegavati gonjenje za krivično delo, izvršenje kazne, nalog za hapšenje ili poternicu;</p>

<p>2.4. këtë e kërkojnë shkaqet e mbrojtjes dhe sigurisë, në mbështetje të vlerësimit të një organi kompetent për siguri.</p> <p>3. Të huajit i lejohet dalja nga Republika e Kosovës kur pushojnë së ekzistuari shkaqet nga paragrafi 2 i këtij neni.</p> <p>4. I huaji ka të drejtë që kundër vendimit nga paragrafi 2.1 dhe 2.2 i këtij neni të parashtojë ankesë në Komisionin e Ankesave për të Huajt.</p> <p>5. I huaji kundër vendimit nga paragrafi 2.3 dhe 2.4 i këtij neni nuk ka të drejtë ankese, por mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente.</p> <p>6. Ankesa kundër vendimit për refuzim të daljes nuk pezullon ekzekutimin e vendimit për refuzim të daljes.</p> <p>7. Procedurat dhe rregullat për zbatim të këtij neni, përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Ministri i MPB-së.</p>	<p>2.4. this is required for reasons of protection and security, in support of an assessment by a competent security body.</p> <p>3. A foreign shall be allowed to leave the Republic of Kosovo when the reasons from paragraph 2 of this Article cease to exist.</p> <p>4. A foreigner shall be entitled to appeal the decision from paragraphs 2.1 and 2.2 before the Foreigners' Appeals Commission.</p> <p>5. A foreigner may not appeal the decision from paragraphs 2.3. and 2.4. of this Article, but may initiate an administrative conflict before the competent court.</p> <p>6. The appeal against the decision to refuse exit shall not stay the execution of the decision to refuse exit.</p> <p>7. The procedures and rules for the implementation of this Article shall be defined by a bylaw adopted by the Minister of MIA.</p>	<p>2.4. to nalažu razlozi odbrane i bezbednosti, podržavajući procenu nadležnog organa za bezbednost.</p> <p>3. Strancu se dozvoljava izlazak iz Republike Kosovo kada prestaju da postoje razlozi iz stava 2. ovog člana.</p> <p>4. Stranac ima pravo da podnese žalbu na odluku iz stava 2.1 i 2.2 ovog člana Žalbenoj komisiji za strance.</p> <p>5. Stranac nema pravo žalbe na odluku iz stava 2.3 i 2.4 ovog člana, ali može pokrenuti upravni spor pred nadležnim sudom.</p> <p>6. Žalba na odluku o odbijanju izlaska ne obustavlja izvršenje odluke o odbijanju izlaska.</p> <p>7. Procedure za sprovođenje ovog člana, utvrđuju se podzakonskim aktom kojeg donosi ministar MUP-a.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 10 Detyrimet e transportuesit</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 Obligations of the carrier</p>	<p style="text-align: center;">Član 10 Obaveze prevoznika</p>
<p>1. Transportuesi mund të sjellë një të huaj në pikën e kalimit kufitar të Republikës së Kosovës, në qoftë se i huaji plotëson kushtet për hyrje në Republikën e Kosovës dhe në rast të transitit ka dokument që mundëson hyrjen në vendin e destinacionit.</p> <p>2. Nëse të huajit i është refuzuar hyrja në Republikën e Kosovës, transportuesi që e ka sjellë atë në pikën e kalimit kufitar duhet që me kërkesën e organit kompetent për kontrollin e kufirit ta kthejë në shtetin nga i cili ka hyrë, në shtetin ku dokumenti i të huajit është lëshuar, apo në ndonjë shtet tjetër që me siguri do ta pranojë atë.</p> <p>3. Nëse transportuesi nuk mund ta kthejë të huajin nga Republika e Kosovës në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, duhet që menjëherë dhe me shpenzimet e tij të sigurojë transportues tjetër.</p> <p>4. Detyrimet që rrjedhin nga ky nen duhet të zbatohen edhe ndaj transportuesit që bart të huajin në kufirin shtetëror ose brenda territorit të</p>	<p>1. A carrier may bring a foreigner to the border crossing point of the Republic of Kosovo if the foreigner meets the conditions for entry to the Republic of Kosovo and in case of transit has a document that enables entry to the country of destination.</p> <p>2. If a foreigner has been refused entry to the Republic of Kosovo, the carrier who brought him or her to the border crossing point shall, at the request of the competent body for border control, take him or her back to the country from which he or she entered, to the country where the foreigner's document was issued or to any other country that is certainly receiving him or her.</p> <p>3. If a carrier cannot return the foreigner from the Republic of Kosovo in accordance with paragraph 2 of this Article, it shall immediately and at its own expense provide another carrier.</p> <p>4. The obligations arising from this Article shall also apply to the carrier who carries the foreigner to the state border or within the territory of the Republic of</p>	<p>1. Prevoznik može dovesti stranca na granični prelaz Republike Kosovo, ako stranac ispunjava uslove za ulazak u Republiku Kosovo, i u slučaju tranzita ima ispravu koja mu omogućava ulazak u zemlju odredišta.</p> <p>2. Ako je strancu odbijen ulazak u Republiku Kosovo, prevoznik koji ga je doveo na graničnom prelazu treba da ga, na zahtev nadležnog organa za graničnu kontrolu, vrati u zemlju iz koje je ulazio, u zemlju u kojoj je izdata isprava stranca, ili u bilo koju drugu zemlju koja ga sigurno prima.</p> <p>3. Ako prevoznik ne može da vrati stranca iz Republike Kosovo, u skladu sa stavom 2. ovog člana, treba da odmah i o svom trošku obezbediti drugog prevoznika.</p> <p>4. Obaveze koje proizilaze iz ovog člana moraju se primeniti i na prevoznika koji prevozi stranca na državnoj granici ili na teritoriji Republike Kosovo, koji prolazi</p>

<p>Republikës së Kosovës që është duke kaluar transit, ose të cilit i është refuzuar transporti i mëtejshëm nga transportuesi tjetër, ose të cilit i është refuzuar hyrja në shtetin e destinacionit dhe është kthyer në Republikën e Kosovës.</p> <p>5. Organizatori i udhëtimeve turistike, apo të punës në Republikën e Kosovës, është i obliguar që për të huajin që i është ofruar shërbimi përkatës të mbulojë shpenzimet e largimit nga Republika e Kosovës, nëse të huajt i është refuzuar hyrja në Republikën e Kosovës dhe nëse këto shpenzime i huaji nuk mund t'i mbulojë vetë.</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli 3 Vizat</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Regjimi i Vizave</p> <p>1. Për hyrje në territorin e Republikës së Kosovës, ose për të kaluar transit nëpër të, të huajt i lëshohet vizë hyrje ose transiti.</p> <p>2. Vizat lëshohen nga misionet diplomatike apo konsullore të Republikës së Kosovës dhe nga Policia e Kosovës.</p>	<p>Kosovo who is in transit, or who has been refused further transportation by another carrier, or who is refused entry to the country of destination and returned to the Republic of Kosovo.</p> <p>5. The organizer of tourist or business trips in the Republic of Kosovo shall be obliged to cover the costs of leaving the Republic of Kosovo for foreigners, who have been provided with the relevant service, if the foreigner has been refused entry to the Republic of Kosovo and if the foreigner cannot cover such costs himself or herself.</p> <p style="text-align: center;">Subchapter 3 Visas</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Visa Regime</p> <p>1. For entering the territory of the Republic of Kosovo or transiting through it, a foreigner shall be issued an entry or transit visa.</p> <p>2. Visas shall be issued by the diplomatic or consular missions of the Republic of Kosovo and the Kosovo Police.</p>	<p>tranzit ili kome je drugi prevoznik odbio dalji transport ili kome je odbijen ulazak u zemlju odredišta i vraćen je u Republici Kosovo.</p> <p>5. Organizator turističkih ili službenih putovanja u Republici Kosovo, dužan je da strancima kojima je pružena relevantna usluga, pokrije troškove udaljenja iz Republike Kosovo, ako je strancu odbijen ulazak u Republiku Kosovo i ako stranac ne može sam pokriti ove troškove.</p> <p style="text-align: center;">Potpoglavlje 3 Vize</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Vizni režim</p> <p>1. Za ulazak na teritoriji Republike Kosovo ili tranzitni prelazak kroz nju, strancu se izdaje ulazna ili tranzitna viza.</p> <p>2. Vize izdaju diplomatska ili konzularna predstavništva Republike Kosovo i Policija Kosova.</p>
--	--	---

<p>3. Viza e lëshuar nuk garanton hyrjen e të huajit në Republikën e Kosovës.</p> <p>4. Qeveria e Republikës së Kosovës me vendim përcakton regjimin e vizave në bazë të propozimit të Ministrisë përkatëse për punë të jashtme.</p>	<p>3. The issued visa shall not guarantee the foreigner's entry to the Republic of Kosovo.</p> <p>4. The Government of the Republic of Kosovo shall by decision determine the visa regime based on the proposal of the relevant Ministry of Foreign Affairs.</p>	<p>3. Izdata viza ne garantuje ulazak stranca u Republiku Kosovo.</p> <p>4. Vlada Republike Kosovo odlukom utvrđuje vizni režim na osnovu predloga relevantnog ministarstva za spoljne poslove.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 12 Llojet e vizave</p> <p>1. Republika e Kosovës lëshon këto lloje të vizave:</p> <p>1.1. vizë transit e tipit “A”;</p> <p>1.2. vizë transit e tipit “B”; dhe</p> <p>1.3. vizë hyrëse, si në vijim:</p> <p>1.3.1. vizë hyrëse e tipit “C”; dhe</p> <p>1.3.2. vizë hyrëse e tipit “D”.</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 Types of visas</p> <p>1. The Republic of Kosovo shall issue the following types of visas:</p> <p>1.1. “A” type transit visa;</p> <p>1.2. “B” type transit visa; and</p> <p>1.3. entry visa, as follows:</p> <p>1.3.1. “C” type entry; and</p> <p>1.3.2. “D” type entry visa.</p>	<p style="text-align: center;">Član 12 Vrste viza</p> <p>1. Republika Kosovo izdaje ove vrste viza:</p> <p>1.1. tranzitna viza tipa „A“;</p> <p>1.2. tranzitna viza tipa „B“; i</p> <p>1.3. ulazna viza, kao u nastavku:</p> <p>1.3.1. ulazna viza tipa „C“; i</p> <p>1.3.2. ulazna viza tipa „D“.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 13 Viza transit e tipit “A”</p> <p>1. Viza transit e tipit “A” është vizë transit në aeroport që i jep të drejtën të huajit të hyjë dhe të qëndrojë në zonën për</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 “A” type transit visa</p> <p>1. “A” type transit visa shall be an airport transit visa that entitles a foreigner to enter and stay in the international traffic</p>	<p style="text-align: center;">Član 13 Tranzitna viza tipa „A“</p> <p>1. Tranzitna viza tipa „A“ je aerodromska tranzitna viza koja daje pravo strancu da ulazi i boravi u međunarodni tranzitni</p>

<p>qarkullim ndërkombëtar të aeroportit deri në nisjen e fluturimit për në vendin e destinacionit. Vlefshmëria e kësaj vize jepet në përputhje me kohën dhe rezervimet e biletave për udhëtimin, në të cilin aplikuesi parashikon të kalojë transit.</p> <p>2. I huaji qëçili gjatë kohës së qëndrimit në aeroport, apo gjatë fluturimeve ndërkombëtare, nuk e lëshon zonën ndërkombëtare transitore nuk ka nevojë për vizë.</p> <p>3. Me përjashtim të paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, Qeveria e Republikës së Kosovës mund të përcaktojë që shtetasit e huaj të shteteve të caktuara, si dhe mbajtësit e pasaportave të lëshuara nga organet kompetente të atyre shteteve, duhet të kenë viza transite-ajrore.</p> <p>4. Viza transite-ajrore lëshohet për një (1), dy (2) ose më shumë kalime transiti nëpër zonën ndërkombëtare të transitit ajror.</p> <p>5. Vlefshmëria e vizës transite-ajrore përfshin një periudhë lejimi shtesë prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh.</p> <p>6. Me përjashtim të paragrafit 5 të këtij neni, koha shtesë nuk zbatohet nëse</p>	<p>area of the airport until the departure of the flight to the country of destination. The validity of this visa shall be granted in accordance with the time and ticket reservations for the journey, in which the applicant intends to transit.</p> <p>2. A foreigner who, during his or her stay at the airport or during international flights, does not leave the international transit zone, shall not need a visa.</p> <p>3. In derogation from paragraphs 1 and 2 of this Article, the Government of the Republic of Kosovo may decide that foreign nationals of certain countries, as well as holders of passports issued by competent state authorities, shall have air-transit visas.</p> <p>4. An air-transit visa shall be issued for one (1), two (2) or more transits through the international air transit area.</p> <p>5. The validity of the transit-air visa shall also include an additional tolerating period of fifteen (15) days.</p> <p>6. In derogation from paragraph 5 of this Article, the additional time shall not</p>	<p>prostor aerodroma do polaska leta u zemlju odredišta. Rok važenja ove vize se izdaje u skladu sa vremenom i rezervacijom karata za putovanje, u koje podnosilac zahteva namerava da prođe tranzitno.</p> <p>2. Strancu, koji tokom boravka na aerodromu ili tokom međunarodnih letova ne napusti međunarodni tranzitni prostor, nije potrebna viza.</p> <p>3. Izuzetno od stava 1. i 2. ovog člana, Vlada Republike Kosovo može utvrditi da strani državljani pojedinih država, kao i nosioca pasoša izdatih od nadležnih državnih organa, moraju imati aerodromske tranzitne vize.</p> <p>4. Aerodromska tranzitna viza se izdaje za jedan (1), dva (2) ili više tranzit prelazaka kroz međunarodni tranzitni prostor aerodroma.</p> <p>5. Rok važenja aerodromske tranzitne vize obuhvata dodatni tolerisani period od petnaest (15) dana.</p> <p>6. Izuzetno od stava 5. ovog člana, dodatno vreme se ne primenjuje ako za to</p>
--	---	---

<p>ekzistojnë arsye që ndërlidhen me sigurinë shtetërore, rendin publik apo marrëdhëniet ndërkombëtare.</p> <p>7. Viza transite-ajrore shumë hyrëse jepet për një periudhë kohore deri në gjashtë (6) muaj.</p> <p>8. Rregullat dhe procedurat për pajisjen me vizë hyrëse të tipit “A” si dhe formati i afishes së vizës përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përgjegjës për punë të jashtme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 14 Vizë transit e tipit “B”</p> <p>1. Vizë transit e tipit “B” është vizë tokësore që i jep të drejtë të huajit të hyjë dhe të kalojë transit nëpër territorin e Republikës së Kosovës.</p> <p>2. I huaji i cili kalon nëpër territorin e Republikës së Kosovës është i obliguar që pas hyrjes në pikën e kalimit kufitar të dalë nga territori i Republikës së Kosovës brenda katër (4) orëve.</p> <p>3. Viza transite-tokësore shumë hyrëse jepet për një periudhë kohore deri në gjashtë (6) muaj.</p>	<p>apply if there are reasons related to state security, public order or international relations.</p> <p>7. Multiple entry air-transit visa shall be issued for a period of up to six (6) months.</p> <p>8. The rules and procedures for issuing the “A” type entry visa as well as the format of the visa sticker shall be defined by a bylaw of the Minister responsible for foreign affairs.</p> <p style="text-align: center;">Article 14 “B” type transit visa</p> <p>1. “B” type transit visa shall be a land visa that entitles a foreigner to enter and transit through the territory of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. A foreigner, who transits through the territory of the Republic of Kosovo, shall be obliged to leave the territory of the Republic of Kosovo within four (4) hours after entering the border crossing point.</p> <p>3. Multiple-entry land transit visa shall be issued for a period of up to six (6) months.</p>	<p>postoje razlozi koji se odnose na nacionalnu bezbednost, javni red ili međunarodne odnose.</p> <p>7. Aerodromska tranzitna viza sa više ulazaka izdaje se na vremenski period do šest (6) meseci.</p> <p>8. Pravila i procedure za izdavanje ulazne vize tipa „A“, kao i format nalepnice vize utvrđuju se podzakonskim aktom nadležnog ministra za spoljne poslove.</p> <p style="text-align: center;">Član 14 Tranzitna viza tipa „B“</p> <p>1. Tranzitna viza tipa „B“ je kopnena viza koja daje pravo strancu da ulazi i prelazi tranzit preko teritorije Republike Kosovo.</p> <p>2. Stranac koji prolazi preko teritorije Republike Kosova dužan je da nakon ulaska na graničnom prelazu, napusti teritoriju Republike Kosovo u roku od četiri (4) sata.</p> <p>3. Kopnena viza za tranzitni prelazak sa više ulazaka izdaje se na vremenski period do šest (6) meseci.</p>
---	--	--

4. Rregullat dhe procedurat për pajisjen me vizë hyrëse të tipit “B” si dhe formati i afishes së vizës përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përgjegjës për punë të jashtme.

Neni 15
Viza hyrëse e tipit “C”

1. Viza hyrëse e tipit “C” lëshohet për qëllim të hyrjes dhe qëndrimit në territorin e Republikës së Kosovës dhe i jep të drejtën mbajtësit të saj të hyjë dhe të qëndrojë në Republikën e Kosovës jo më gjatë se nëntëdhjetë (90) ditë brenda çdo periudhe prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve.

2. Viza hyrëse e tipit “C” lëshohet për një (1), dy (2) apo më shumë hyrje. Periudha e vlefshmërisë së vizës hyrëse nuk mund të jetë më e gjatë se pesë (5) vjet.

3. Viza hyrëse e tipit “C” për më shumë hyrje lëshohet për një periudhë të vlefshmërisë prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet, nëse i huaji ka dëshmuar:

3.1. nevojën ose qëllimin për të udhëtuar shpesh dhe/ose rregullisht, sidomos për arsye të profesionit apo

4. The rules and procedures for obtaining the “B” type entry visa as well as the format of the visa sticker shall be defined by a bylaw of the Minister responsible for foreign affairs.

Article 15
“C” type visa type

1. “C” type entry visa shall be issued for the purpose of entering and staying in the territory of the Republic of Kosovo and entitles its holder to enter and stay in the Republic of Kosovo for no longer than ninety (90) days within any period of one hundred and eighty (180) days.

2. “C” type entry visa shall be issued for one (1), two (2) or more entries. The validity period of the entry visa may not be longer than five (5) years.

3. “C” type entry visa for multiple entries shall be issued for a period of validity of six (6) months to five (5) years if a foreigner has proven:

3.1. the necessity or intention to travel frequently and/or regularly, especially for occupational purposes

4. Pravila i procedure za izdavanje ulazne vize tipa „B“, kao i format nalepnice vize utvrđuju se podzakonskim aktom ministra nadležnog za spoljne poslove.

Član 15
Ulazna viza tipa „C“

1. Ulazna viza tipa „C“ se izdaje u cilju ulaska i boravka na teritoriju Republike Kosovo i daje pravo njenom nosiocu da ulazi i boravi u Republiku Kosovo najduže devedeset (90) dana u okviru bilo kog perioda od sto osamdeset (180) dana.

2. Ulazna viza tipa „C“ izdaje za jedan (1), dva (2) ili više ulazaka. Rok važenja ulazne vize ne može biti duži od pet (5) godina.

3. Ulazna viza tipa „C“ za više ulazaka izdaje se na rok važenja od šest (6) meseci do pet (5) godina, ako stranac dokaže:

3.1. potrebu ili cilj da putuje često i/ili redovno, posebno zbog svog profesije ili porodičnog statusa, kao

<p>statusit familjar siç janë qëllime biznesi, se është shërbyes civil i përfshirë në kontakte të rregullta zyrtare me institucione të Republikës së Kosovës, përfaqësues i organizatave të shoqërisë civile që udhëtojnë për qëllim edukimi, trajnimi, për seminare dhe konferenca, anëtar i familjes së një shtetasi të Republikës së Kosovës, anëtar i familjes së shtetasit të huaj që qëndron në mënyrë të ligjshme në Republikën e Kosovës;</p> <p>3.2. integritetin dhe besueshmërinë, veçanërisht përmes përdorimit ligjor të vizave të lëshuara më parë, gjendjes së tij financiare në vendin e origjinës dhe qëllimit të vërtetë për t'u larguar nga territori i Republikës së Kosovës para skadimit të afatit të vizës së kërkuar.</p> <p>4. Rregullat dhe procedurat për pajisjen me vizë hyrëse të tipit “C”, si dhe formati i afishes së vizës, përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përgjegjës për punë të jashtme.</p>	<p>or family status such as business purposes, civil servants involved in regular official contacts with institutions of the Republic of Kosovo, representatives of civil society organizations who travel for purposes of education, training, seminars and conferences, family members of a citizen of the Republic of Kosovo, family members of a foreign citizen who is legally staying in the Republic of Kosovo;</p> <p>3.2. integrity and reliability, especially through the legal use of previously issued visas, his or her financial situation in the country of origin and the true intention to leave the territory of the Republic of Kosovo before the expiration of the visa requested.</p> <p>4. The rules and procedures for issuing “C” type entry visa as well as the format of the visa sticker shall be determined by a bylaw of the Minister responsible for foreign affairs.</p>	<p>što su: poslovne svrhe, državni službenici uključeni u redovnim zvaničnim kontaktima sa institucijama Republike Kosovo, predstavnici organizacija civilnog društva koji putuju u svrhu obrazovanja, obuke, seminara i konferencija, članovi porodice državljanina Republike Kosovo, članovi porodice stranog državljanina koji zakonito boravi u Republici Kosovo;</p> <p>3.2. integritet i pouzdanost, posebno u upotrebi prethodno izdatih viza, svoje finansijsko stanje u zemlji porekla i njegov istiniti cilj da napusti teritoriju Republike Kosovo pre isteka roka važenja vize za koju je podneo zahtev.</p> <p>4. Pravila i procedure za izdavanje ulazne vize tipa „C“, kao i format nalepnice vize utvrđuju se podzakonskim aktom ministra nadležnog za spoljne poslove.</p>
---	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 16 Viza hyrëse e tipit “D”</p>	<p style="text-align: center;">Article 16 “D” type entry visa</p>	<p style="text-align: center;">Član 16 Ulazna viza tipa „D“</p>
<p>1. Viza hyrëse e tipit “D” është vizë që i lëshohet shtetasit të huaj që ka për qëllim të hyjë dhe qëndrojë në Republikën e Kosovës më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë brenda njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve dhe kur për t’u pajisur me lejeqëndrim për këta të huaj kërkohet vizë.</p> <p>2. Viza hyrëse e tipit “D” jepet me vlefshmëri deri në një (1) vit, me kohë qëndrimi nëntëdhjetë (90) ditë, por jo për më shumë se 180 ditë, llogaritur që nga dita e hyrjes së parë.</p> <p>3. Viza hyrëse e tipit “D” lëshohet me një (1), dy (2) apo më shumë hyrje dhe i jep të drejtë mbajtësit të pajiset me lejeqëndrim pas hyrjes në Republikën e Kosovës.</p> <p>4. Viza hyrëse e tipit “D” lëshohet pasi që misioni diplomatik ose konsullor të marrë miratimin nga MPB se i huaji ka plotësuar kushtet për marrjen e lejeqëndrimit në Republikën e Kosovës, në pajtim me kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.</p>	<p>1. “D” type entry visa shall be a visa issued to a foreign citizen who intends to enter and stay in the Republic of Kosovo for more than ninety (90) days within one hundred and eighty (180) days and when to be granted with a residence permit, a visa is required for such foreigners.</p> <p>2. “D” type entry visa shall be valid for up to one (1) year, with a stay of ninety (90) days, but not for more than 180 days, calculated from the day of first entry.</p> <p>3. “D” type entry visa shall be issued for one (1), two (2) or more entries entitled its holder to be provided with a residence permit after entering the Republic of Kosovo.</p> <p>4. “D” type entry visa is issued after the diplomatic or consular mission receives approval from the MIA that the foreigner has met the conditions for obtaining a residence permit in the Republic of Kosovo in accordance with the criteria defined in the applicable legislation.</p>	<p>1. Ulazna viza tipa „D“ izdaje se stranom državljaninu kojim ima za cilj da ulazi i boravi u Republici Kosovo više od devedeset (90) dana u periodu od sto osamdeset (180) dana, i kada je ovom strancu potrebna viza za dobijanje dozvole za boravak.</p> <p>2. Ulazna viza tipa „D“ se izdaje sa rokom važenja godinu dana, vremenom boravka od devedeset (90) dana, ali ne duže od sto osamdeset (180) dana, računajući od dana prvog ulaska.</p> <p>3. Ulazna viza tipa „D“ se izdaje za jedan (1), dva (2) ili više ulazaka daje pravo nosiocu da dobije dozvolu za boravak nakon ulaska u Republiku Kosovo.</p> <p>4. Ulazna viza tipa „D“ se izdaje nakon što diplomatsko ili konzularno predstavništvo dobije odobrenje od MUP-a da je stranac ispunio uslove za dobijanje dozvole za boravak u Republici Kosovo, u skladu sa kriterijumima utvrđenim u važećem zakonodavstvu.</p>

<p>1.7. arsyeve humanitare;</p> <p>1.8. mbrojtjes së viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjes së të huajve që kanë qenë subjekt i veprimeve për lehtësim të migrimit ilegal dhe që bashkëpunojnë me autoritetet kompetente;</p> <p>1.9. mbrojtjes ndërkombëtare, mbrojtjes së përkohshme dhe për personat me status të pa shtetësisë;</p> <p>1.10. punës.</p> <p>2. I huaji që plotëson kriteret për qëndrim të përkohshëm sipas këtij ligji i lëshohet lejeqëndrimi.</p> <p>3. Forma, përmbajtja, kërkesat dhe procedura për aplikim dhe pajisje me lejeqëndrim, sipas paragrafit 2 të këtij neni, rregullohen me akt nënligjor të miratuar nga Ministri i MPB-së.</p> <p style="text-align: center;">Neni 32 Parashtrimi i kërkesës për leje qëndrim të përkohshëm</p> <p>1. Kërkesa për pajisje me lejeqëndrim për herë të parë parashtrohet në misionet</p>	<p>1.7. humanitarian reasons;</p> <p>1.8. protection of victims of human trafficking and protection of foreigners who have been subject to actions to facilitate illegal migration, who cooperate with the competent authorities;</p> <p>1.9. persons under international protection, temporary protection and persons with stateless status;</p> <p>1.10. employment.</p> <p>2. A foreigner who meets the criteria for a temporary stay according to this Law shall be issued a residence permit.</p> <p>3. The form, content, requirements and procedures for applying for and obtaining a residence permit according to paragraph 2 of this Article shall regulated by a bylaw adopted by the Minister of MIA.</p> <p style="text-align: center;">Article 32 Submitting an application for a temporary residence permit</p> <p>1. The application for obtaining a residence permit for the first time shall be</p>	<p>1.7. humanitarnih razloga;</p> <p>1.8. zaštite žrtava trgovine ljudima i strancima koji su bili podvrgnuti radnjama za olakšavanje ilegalne migracije, koje sarađuju sa nadležnim organima;</p> <p>1.9. lica pod međunarodnom zaštitom, privremenom zaštitom i lica sa statusom bez državljanstva;</p> <p>1.10. rada.</p> <p>2. Strancu koji ispunjava kriterijume za privremeni boravak u skladu sa ovim zakonom izdaje se dozvola za boravak.</p> <p>3. Oblik, sadržaj, uslovi i procedura za podnošenje zahteva i izdavanje dozvole za boravak, u skladu sa stavom 2. ovog člana, uređuju se podzakonskim aktom koji donosi ministar MUP-a.</p> <p style="text-align: center;">Član 32 Podnošenje zahteva za dozvolu za privremeni boravak</p> <p>1. Zahtev za izdavanje dozvole za boravak po prvi put se podnosi</p>
---	---	--

<p>diplomatike apo konsullore të Republikës së Kosovës.</p> <p>2. I huaji, i cili për të hyrë në Republikën e Kosovës nuk ka nevojë për vizë, mund të parashtojë kërkesën për lejeqëndrim të përkohshëm në MPB.</p> <p>3. Përfundimisht paragrafit 1 të këtij neni, kërkesa për lejeqëndrim të përkohshëm mund të parashtrohet në MPB në rastet e marrëveshjeve ndërkombëtare, për arsye humanitare, nga personat pa shtetësi, në rastet e mbrojtjes së viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore dhe të të huajve që kanë qenë subjekt i veprimeve për lehtësim të migrimit ilegal, nga personat nën mbrojtje ndërkombëtare dhe për lejeqëndrimin në rrethana të jashtëzakonshme.</p> <p>4. Kërkesa për lejeqëndrim mund të parashtrohet edhe përmes platformave shtetërore për shërbime elektronike. Qeveria, me propozim të MPB-së me akt nënligjor përcakton procedurën për zbatimin e këtij paragrafi.</p>	<p>submitted to the diplomatic or consular missions of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. A foreigner who does not need a visa to enter the Republic of Kosovo may submit an application for a temporary residence permit to the MIA.</p> <p>3. In derogation from paragraph 1 of this Article, the application for temporary residence may be submitted to the MIA in cases of international agreements, for humanitarian reasons, by stateless persons and in cases of protection of victims of human trafficking and foreigners who have been subject to actions to facilitate illegal migration, by persons under international protection and for a residence permit in exceptional circumstances.</p> <p>4. The application for a residence permit may also be submitted through state platforms for electronic services. The Government shall, upon the proposal of MIA, determine the procedure for the implementation of this paragraph through a bylaw.</p>	<p>diplomatskim ili konzularnim predstavništvima Republike Kosovo.</p> <p>2. Stranac, kojem je za ulazak u Republiku Kosovo potrebna viza, može da MUP-u podnese zahtev za dozvolu za privremeni boravak.</p> <p>3. Izuzetno od stava 1. ovog člana, podnošenje zahteva za dozvolu za privremeni boravak može se podneti MUP-u, u slučajevima međunarodnih sporazuma, iz humanitarnih razloga, od strane lica bez državljanstva, u slučajevima zaštite žrtava trgovine ljudima i stranaca koji su bili podvrgnuti radnjama za olakšavanje ilegalne migracije, od strane lica pod međunarodnom zaštitom i za dozvolu za boravak u vanrednim okolnostima.</p> <p>4. Zahtev za dozvolu za boravak može se podneti i preko državnih platformi za elektronske usluge. Vlada, na predlog MUP-a, podzakonskim aktom utvrđuje postupak za sprovođenje ovog stava.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 33 Kriteret për dhënien e lejeqëndrimit të përkohshëm</p>	<p style="text-align: center;">Article 33 Criteria for granting a temporary residence permit</p>	<p style="text-align: center;">Član 33 Kriterijumi za izdavanje dozvole za privremeni boravak</p>
<p>1. Të huajit i jepet lejeqëndrimi i përkohshëm nëse:</p> <p>1.1. dëshmon qëllimin e qëndrimit të përkohshëm;</p> <p>1.2. posedon dokument të vlefshëm udhëtimi;</p> <p>1.3. posedon mjete të mjaftueshme financiare për jetesë;</p> <p>1.4. dëshmon se ka siguruar akomodim;</p> <p>1.5. posedon sigurim shëndetësor;</p> <p>1.6. posedon dëshmi që nuk është i dënuar për vepër penale, lëshuar nga organi kompetent i shtetit shtetas i të cilit është i huaji, apo nga shteti i vendbanimit të tij të fundit;</p> <p>1.7. nuk ka ndalesë të hyrjes dhe qëndrimit në Republikën e Kosovës.</p>	<p>1. A foreigner shall be granted a temporary residence permit if he or she:</p> <p>1.1. proves the purpose of the temporary stay;</p> <p>1.2. possesses a valid travel document;</p> <p>1.3. possesses sufficient subsistence funds;</p> <p>1.4. proves that he or she has an accommodation to move in;</p> <p>1.5. has health insurance;</p> <p>1.6. possesses a certificate that he or she has not been convicted of a criminal offence, issued by the competent authority of the state of which the foreigner is a citizen or by the state of his or her last residence;</p> <p>1.7. there is no ban on entering and staying in the Republic of Kosovo.</p>	<p>1. Strancu se izdaje dozvola za privremeni boravak, ako:</p> <p>1.1. dokaže cilj privremenog boravka;</p> <p>1.2. poseduje važeću putnu ispravu;</p> <p>1.3. poseduje dovoljna finansijska sredstva za život;</p> <p>1.4. dokaže da je obezbedio smeštaj;</p> <p>1.5. poseduje zdravstveno osiguranje;</p> <p>1.6. priloži dokaz da nije osuđivan za krivično delo, izdat od nadležnog organa države čiji je stranac državljanin ili države poslednjeg prebivališta;</p> <p>1.7. nema zabranu ulaska i boravka u Republici Kosovo.</p>

<p>2. Të huajit të përcaktuar sipas nënparagrafëve 1.7, 1.8 dhe 1.9 të nenit 31 të këtij Ligji, mund ti lëshohet lejeqëndrimi edhe nëse nuk plotëson kriteret e parapara në paragrafi 1 të këtij neni.</p> <p>3. Për tu pajisur me lejeqëndrim i huaji nuk duhet të përbëjë kërcënim për sigurinë shtetërore, rendin publik ose shëndetin publik.</p> <p>4. Përveç kriterëve të përgjithshme të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, i huaji për tu pajisur me lejeqëndrim duhet të plotësojë edhe kriteret specifike për secilin lejeqëndrim sipas nenit 31 të këtij Ligji.</p> <p>5. Para marrjes së vendimit për lejeqëndrim për qëllim punësimi në Republikën e Kosovës MPB merr miratimin paraprak nga APRK. Procedura e miratimit përcaktohet me akt nënligjor nga Ministri i ministrisë përkatëse për punë.</p>	<p>2. A foreigner defined according to subparagraphs 1.7, 1.8 and 1.9 of Article 31 of this Law may be issued a residence permit even if he or she does not meet the criteria outlined in paragraph 1 of this Article.</p> <p>3. In order to obtain a residence permit, a foreigner shall not pose a threat to state security, public order or public health.</p> <p>4. In addition to the general criteria defined in paragraph 1 of this Article, a foreigner to be provided with a residence permit shall also meet the specific criteria for each residence permit under Article 31 of this Law.</p> <p>5. MIA shall, before making a decision on a residence permit for the purpose of employment in the Republic of Kosovo, receive prior approval from the EARK. The approval procedure shall be defined by a bylaw adopted by the Minister of the relevant ministry of labour.</p>	<p>2. Strancu, utvrđenom u skladu sa tačkama 1.7, 1.8 i 1.9 člana 31. ovog zakona, može se izdati dozvola za boravak i ako ne ispunjava kriterijume propisane stavom 1. ovog člana.</p> <p>3. Za dobijanje dozvole za boravak, stranac ne sme predstaviti pretnju po nacionalnu bezbednost, javni red i javno zdravlje.</p> <p>4. Pored opštih kriterijuma utvrđenih stavom 1. ovog člana, za izdavanje dozvole za boravak, stranac treba da ispunjava i posebne kriterijume za svaku dozvolu za boravak iz člana 31. ovog zakona.</p> <p>5. MUP, pre donošenja odluke o dozvoli za boravak u svrhu zapošljavanja u Republici Kosovo dobija prethodno odobrenje AZRK-a. procedura usvajanja utvrđuje se podzakonskim aktom od strane ministra nadležnog za rad.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 34 Vendimi për lejeqëndrim të përkohshëm</p> <p>1. Lidhur me kërkesën për lejeqëndrim të përkohshëm vendos MPB brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e pranimit të kërkesës.</p> <p>2. Kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni mund të parashtrohet ankesë në Komisionin e Ankesave për të Huajt brenda tridhjetë (30) ditëve.</p> <p>3. Komisioni i Ankesave për të Huajt vendos lidhur me ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 34 Decision on temporary residence permit</p> <p>1. MIA shall decide on the application for a temporary residence permit within sixty (60) days from the day of the receipt of the application.</p> <p>2. The decision from paragraph 1 of this Article may be appealed within thirty (30) days before the Foreigners' Appeals Commission.</p> <p>3. The Foreigners' Appeals Commission shall decide on the appeal within thirty (30) days from the day of receipt of the appeal.</p>	<p style="text-align: center;">Član 34 Odluka o dozvoli za privremeni boravak</p> <p>1. U vezi sa zahtevom za dozvolu za privremeni boravak odlučuje MUP u roku od šezdeset (60) dana od dana prijema zahteva.</p> <p>2. Na odluku iz stava 1. ovog člana u roku od trideset (30) dana, može se podneti žalba Žalbenoj komisiji za strance.</p> <p>3. Žalbena komisija za strance odlučuje o zahtevu u roku od trideset (30) dana od dana prijema žalbe.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 35 Qëndrimi i fëmijëve të lindur në Republikën e Kosovës</p> <p>Prindi që ka lejeqëndrim në Republikën e Kosovës, apo kujdestari ligjor i fëmijës së lindur në Republikën e Kosovës duke përfshirë fëmijën në rrezik të pashtetësisë, është i obliguar të parashtrojë kërkesë për lejeqëndrim për fëmijën, brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga data e lindjes së fëmijës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 35 Residence of children born in the Republic of Kosovo</p> <p>A parent who has a residence permit in the Republic of Kosovo or the legal guardian of a child born in the Republic of Kosovo, including a child at risk of statelessness, shall be obliged to submit an application for a residence permit for the child within ninety (90) days from the date of the child's birth.</p>	<p style="text-align: center;">Član 35 Boravak dece rođene u Republici Kosovo</p> <p>Roditelj koji ima dozvolu za boravak u Republici Kosovo ili zakonski staratelj deteta koje je rođeno u Republici Kosovo, uključujući dete koje u riziku od statusa lica bez državljanstva, dužan je da podnese zahtev za dozvolu za boravak deteta, u roku od devedeset (90) dana od dana rođenja deteta.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 36 Periudha e vlefshmërisë së lejeqëndrimit të përkohshëm</p> <p>1. Lejeqëndrimi i përkohshëm lëshohet për një periudhë mbi nëntëdhjetë ditë (90) deri në një (1) vit, përveç rasteve kur është paraparë ndryshe me këtë ligj apo me marrëveshje ndërkombëtare.</p> <p>2. Periudha e vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit duhet të jetë të paktën tre (3) muaj më e gjatë se periudha për të cilën është lëshuar lejeqëndrimi i përkohshëm.</p> <p>3. I huaji që gëzon statusin e mbrojtjes ndërkombëtare, mbrojtjes së përkohshme dhe statusin e pa shtetësisë pajiset me lejeqëndrim të përkohshëm në bazë të vendimit të organit kompetent për dhënien e këtij statusi, përveç nëse arsyet bindëse të sigurisë shtetërore apo rendit publik kërkojnë ndryshe.</p>	<p style="text-align: center;">Article 36 Period of validity of the temporary residence permit</p> <p>1. A temporary residence permit shall be issued for a period of more than ninety days (90) to one (1) year unless otherwise provided by this Law or an international agreement.</p> <p>2. The validity period of the travel document shall be at least three (3) months longer than the period for which the temporary residence permit was issued.</p> <p>3. A foreigner who enjoys the status of international protection, temporary protection and the status of statelessness shall be provided with a temporary residence permit based on the decision of the competent authority for issuing such status unless compelling reasons of state security or public order require otherwise.</p>	<p style="text-align: center;">Član 36 Rok važenja dozvole za privremeni boravak</p> <p>1. Dozvola za privremeni boravak se izdaje na rok od preko devedeset dana (90) do jedne (1) godine, osim u slučajevima kada je ovim zakonom ili međunarodnim ugovorom nije drugačije određeno.</p> <p>2. Rok važenja putne isprave mora biti najmanje tri (3) meseca duži od roka na koji je izdata dozvola za privremeni boravak.</p> <p>3. Strancu koji uživa status međunarodne zaštite, privremene zaštite i status lica bez državljanstva biće izdata dozvola za privremeni boravak na osnovu odluke nadležnog organa za izdavanje ovog statusa, osim ako ubedljivi razlozi nacionalne bezbednosti ili javnog reda ne zahtevaju drugačije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 37 Vazhdimi i lejeqëndrimit të përkohshëm</p> <p>1. Kërkesa për vazhdimin e lejeqëndrimit të përkohshëm duhet të</p>	<p style="text-align: center;">Article 37 Extension of the temporary residence permit</p> <p>1. An application for the extension of the temporary residence permit shall be</p>	<p style="text-align: center;">Član 37 Produženje dozvole za privremeni boravak</p> <p>1. Zahtev za produženje dozvole za privremeni boravak treba podneti MUP-u</p>

<p>paraqitet në MPB jo më herët se gjashtëdhjetë (60) ditë dhe jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para skadimit të lejeqëndrimit të përkohshëm.</p> <p>2. MPB nxjerr vendim lidhur me kërkesën për vazhdim të lejeqëndrimit brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i kërkesës.</p> <p>3. Vazhdimi i lejeqëndrimit bëhet nga data e skadimit të lejeqëndrimit paraprak.</p> <p>4. I huaji, i cili ka paraqitur kërkesën për vazhdimin e lejeqëndrimit të përkohshëm para skadimit të lejeqëndrimit të përkohshëm ekzistues, mund të qëndrojë në territorin e Republikës së Kosovës deri në vendosje lidhur me kërkesën.</p> <p>5. Në rast të mosparaqitjes së kërkesës për vazhdim të lejeqëndrimit të përkohshëm brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, i huaji duhet të ndjekë procedurat për paraqitjen për herë të parë të kërkesës për aplikim për lejeqëndrim.</p>	<p>submitted to MIA no earlier than sixty (60) days and no later than thirty (30) days before the expiration of the temporary residence permit.</p> <p>2. MIA shall issue a decision regarding the application for an extension of the residence permit within thirty (30) days from the receipt of the application.</p> <p>3. The extension of the residence permit shall be made from the date of expiry of the previous residence permit.</p> <p>4. A foreigner submitting an application for the extension of the temporary residence permit before the expiration of the existing temporary residence permit may stay in the territory of the Republic of Kosovo until a decision on the application is rendered.</p> <p>5. In case of failure to submit an application for an extension of the temporary residence permit within the deadline defined in paragraph 1 of this Article, a foreigner shall follow the procedures for submitting the application for the residence permit application for the first time.</p>	<p>ne raniye od šezdeset (60) dana i najkasnije trideset (30) dana pre isteka dozvole za privremeni boravak.</p> <p>2. MUP donosi odluku u vezi sa zahtevom za produženje dozvole za privremeni boravak, u roku od trideset (30) dana od prijema zahteva.</p> <p>3. Produženje dozvole za boravak vrši se od dana isteka prethodne dozvole za boravak.</p> <p>4. Stranac, koji je podneo zahtev za produženje dozvole za privremeni boravak pre isteka postojeće dozvole za privremeni boravak, može boraviti na teritoriji Republike Kosovo do odlučivanja u vezi sa zahtevom.</p> <p>5. U slučaju nepodnošenja zahteva za produženje dozvole za privremeni boravak u roku utvrđenom stavom 1. ovog člana, stranac treba da poštuje procedure za podnošenje zahteva za izdavanje dozvole za boravak po prvi put.</p>
--	---	---

<p>6. I huaji, i cili aplikon për vazhdim të lejeqëndrimit të përkohshëm dhe nuk e ndërron qëllimin e aplikimit paraprak, në momentin e parashtrimit të kërkesës për vazhdim të lejeqëndrimit të përkohshëm duhet të paraqesë dokumentet si në vijim:</p> <p>6.1. dokument të vlefshëm udhëtimi;</p> <p>6.2. dëshmi që posedon mjete të mjaftueshme financiare për jetesë;</p> <p>6.3. sigurim shëndetësor;</p> <p>6.4. dëshminë e adresës së banimit;</p> <p>6.5. dëshmi që nuk është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë me dënim prej një (1) apo më shumë vjet burgim në Republikën e Kosovës.</p> <p>7. I huaji me lejeqëndrim të përkohshëm mund të parashtojë kërkesë për lejeqëndrim të radhës për një qëllim tjetër, para skadimit të periudhës për të cilën është lëshuar ai lejeqëndrim, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni. Në këtë rast, i huaji duhet të plotësojë</p>	<p>6. A foreigner who applies for the extension of the temporary residence permit and does not change the purpose of the previous application, shall submit the following documents at the time of submitting the application for the extension of the temporary residence permit:</p> <p>6.1. valid travel document;</p> <p>6.2. evidence that he or she has sufficient subsistence funds;</p> <p>6.3. health insurance;</p> <p>6.4. evidence of residential address;</p> <p>6.5. evidence that he or she has not been convicted by a final judgment by a punishment of one (1) or many years of imprisonment in the Republic of Kosovo.</p> <p>7. A foreigner with a temporary residence permit may submit an application for another residence permit for another purpose, before the expiration of the period for which that residence permit was issued, in accordance with paragraph 1 of this Article. In this case, the foreigner</p>	<p>6. Stranac, koji podnosi zahtev za produženje dozvole za privremeni boravak, a ne menja svrhu prethodnog podnošenja zahteva, u trenutku podnošenja zahteva za produženje dozvole za privremeni boravak, treba da priloži sledeća dokumenta:</p> <p>6.1. važeću putnu ispravu;</p> <p>6.2. dokaz da poseduje dovoljna finansijska sredstva za život;</p> <p>6.3. zdravstveno osiguranje;</p> <p>6.4. dokaz o adresi stanovanja;</p> <p>6.5. dokaz da nije osuđivan pravosnažnom presudom kaznom od godinu dana ili većom kaznom zatvora u Republici Kosovo.</p> <p>7. Stranac sa dozvolom za privremeni boravak može podneti zahtev za izdavanje druge dozvole za boravak u drugu svrhu, pre isteka roka za koji je izdata ta dozvola za boravak, u skladu sa stavom 1. ovog člana. U ovom slučaju, stranac treba da ispunjava kriterijume kao</p>
---	---	--

<p>kriteret sikur aplikon për herë të parë për atë qëllim të qëndrimit.</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli 2 Qëndrimi i përkohshëm për qëllim të ribashkimit familjar</p> <p style="text-align: center;">Neni 38 Lejeqëndrimi i përkohshëm për qëllim të ribashkimit familjar</p> <p>1. Lejeqëndrimi i përkohshëm për qëllim të ribashkimit familjar mund t'i jepet një të huaji që plotëson kushtet e nenit 33 të këtij ligji dhe është anëtar i ngushtë i familjes së:</p> <p style="margin-left: 40px;">1.1. shtetasit të Kosovës;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.2. të huajit që ka lejeqëndrim të përkohshëm;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.3. të huajit që ka lejeqëndrim të përhershëm;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.4. të huajit që i është dhënë mbrojtje ndërkombëtare apo mbrojtje e përkohshme në pajtim me ligjin përkatës për Azil;</p>	<p>shall meet the criteria as if applying for the first time for that purpose of stay.</p> <p style="text-align: center;">Subchapter 2 Temporary stay for the purpose of family reunification</p> <p style="text-align: center;">Article 38 Temporary residence permit for the purpose of family reunification</p> <p>1. The temporary residence permit for the purpose of family reunification may be granted to a foreigner who meets the conditions under Article 33 of this Law and is a close family member of:</p> <p style="margin-left: 40px;">1.1. a citizen of Kosovo;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.2. a foreigner who has a temporary residence permit;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.3. a foreigner who has a permanent residence permit;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.4. a foreigner who has been granted international protection or temporary protection in accordance with the relevant Law on Asylum;</p>	<p>da podnese zahtev po prvi put za tu svrhu boravka.</p> <p style="text-align: center;">Potpoglavlje 2 Privremeni boravak po osnovu spajanja porodice</p> <p style="text-align: center;">Član 38 Dozvola za privremeni boravak po osnovu spajanja porodice</p> <p>1. Dozvola za privremeni boravak po osnovu spajanja porodice može se izdati strancu koji ispunjava uslove iz člana 33. ovog zakona i član je uže porodice:</p> <p style="margin-left: 40px;">1.1. državljanina Kosova;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.2. strancu koji ima dozvolu za privremeni boravak;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.3. strancu koji ima dozvolu za stalni boravak;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.4. strancu, kome je dodeljena međunarodna zaštita ili privremena zaštita u skladu sa relevantnim Zakonom o azilu;</p>
--	--	---

<p>1.5. të huajit që i është dhënë statusi i personit pa shtetësi.</p> <p>2. Lejeqëndrimi i përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar nuk i jepet anëtarit të familjes së të huajit që i është lëshuar lejeqëndrimi për punë sezonale.</p> <p style="text-align: center;">Neni 39 Anëtarët e familjes</p> <p>1. Anëtarët e familjes së sponsorit në kuptim të këtij ligji janë:</p> <p>1.1. bashkëshorti i sponsorit;</p> <p>1.2. fëmijët e mitur të pamartuar të sponsorit dhe të bashkëshortit të tij, duke përfshirë fëmijët e adoptuar në pajtim me vendimin e marrë nga autoriteti kompetent i Republikës së Kosovës, apo me një vendim i cili është automatikisht i zbatueshëm për shkak të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, apo që duhet të njihet në pajtim me detyrimet ndërkombëtare;</p> <p>1.3. fëmijët e mitur të pamartuar, duke përfshirë fëmijët e adoptuar të</p>	<p>1.5. a foreigner who has been granted the status of a stateless person.</p> <p>2. A temporary residence permit for the purpose of family reunification shall not be granted to family members of a foreigner who was granted a residence permit for seasonal work.</p> <p style="text-align: center;">Article 39 Family members</p> <p>1. The sponsor's family members in the light of this Law shall be:</p> <p>1.1. spouse of the sponsor;</p> <p>1.2. unmarried minor children of the sponsor and of his spouse, including children adopted in accordance with the decision taken by the competent authority of the Republic of Kosovo, or a decision which is automatically applicable due to the international obligations of the Republic of Kosovo, or that should be recognized in accordance with international obligations;</p> <p>1.3. unmarried minor children including adopted children of the</p>	<p>1.5. strancu, kome je dodeljen status lica bez državljanstva.</p> <p>2. Dozvola za privremeni boravak po osnovu spajanja porodice neće se izdati članu porodice stranca kome je izdata dozvola za boravak za sezonski rad.</p> <p style="text-align: center;">Član 39 Članovi porodice</p> <p>1. Članovi porodice sponzora u smislu ovog zakona su:</p> <p>1.1. supružnici sponzora;</p> <p>1.2. maloletna neudata i neoženjena deca sponzora i njegovog supružnika, uključujući decu koja su usvojena u skladu sa odlukom donete od strane nadležnog organa Republike Kosovo, ili odluke koje je automatski primenljiva zbog međunarodnih obaveza Republike Kosovo, ili treba da se prizna u skladu sa međunarodnim obavezama;</p> <p>1.3. maloletna neudata i neoženjena deca, uključujući usvojenu decu</p>
---	---	---

<p>sponsorit kur sponsori ka kujdestarinë dhe fëmijët janë të varur prej tij. Ribashkimi familjar mund të autorizohet për fëmijët, kujdestaria e të cilëve është e ndarë, me kusht që pala tjetër që e ndan kujdestarinë ka dhënë pajtimin;</p> <p>1.4. fëmijët e mitur të pamartuar, duke përfshirë fëmijët e adoptuar të bashkëshortit kur bashkëshorti ka kujdestarinë dhe fëmijët janë të varur prej tij. Ribashkimi familjar mund të autorizohet për fëmijët, kujdestaria e të cilëve është e ndarë, me kusht që pala tjetër e cila ndan kujdestarinë ka dhënë pajtimin;</p> <p>1.5. prindërit e sponsorit apo bashkëshortit, të cilët janë të varur nga ai dhe nuk gëzojnë mbështetje të duhur familjare në vendin e origjinës;</p> <p>1.6. fëmijët e rritur të pamartuar të sponsorit apo bashkëshortit, të cilët objektivisht nuk janë në gjendje të kujdesen për vete për arsye shëndetësore.</p> <p>2. Përfshirë nga paragrafi 1 i këtij neni, autoriteti kompetent mund të</p>	<p>sponsor when the sponsor has custody and the children are dependent on him. Family reunification may be authorized for children whose custody is separated, provided that the other party sharing custody has given their consent;</p> <p>1.4. unmarried minor children including adopted children of the spouse when the spouse has custody and the children are dependent on him or her. Family reunification may be authorized for children whose custody is separated, provided that the other party who shared custody has given his or her consent;</p> <p>1.5. parents of the sponsor or spouse, who are dependent on them and do not enjoy adequate family support in the country of origin;</p> <p>1.6. adult unmarried children of the sponsor or spouse, who are objectively unable to take care of themselves for health reasons.</p> <p>2. In derogation from paragraph 1 of this Article, the competent authority may also</p>	<p>sponzora kada sponsor ima starateljstvo i deca zavise od njega. Spajanje porodice može se odobriti za decu, čije je starateljstvo podeljeno, pod uslovom da druga strana koja deli starateljstvo dala njenu saglasnost;</p> <p>1.4. maloletna neudata i neoženjena deca, uključujući usvojenu decu supružnika kada supružnik ima starateljstvo i deca zavise od njega. Spajanje porodice može se odobriti za decu, čije je starateljstvo podeljeno, pod uslovom da druga strana koja deli starateljstvo dala njenu saglasnost;</p> <p>1.5. roditelji sponzora ili supružnika, koji su zavisni od njih i ne uživaju odgovarajuću podršku porodice u mestu porekla;</p> <p>1.6. odrasla neudata i neoženjena deca sponzora ili supružnika, koja objektivno nisu u stanju da se staraju o sebi iz zdravstvenih razloga.</p> <p>2. Izuzetno od stava 1. ovog člana, nadležni organ može takođe da smatra</p>
---	---	---

<p>konsiderojë gjithashtu si anëtarë të familjes së personave sipas paragrafit 1 të nenit 38 të këtij ligji edhe persona të tjerë, nëse ka arsye të veçanta personale apo serioze humanitare për ribashkim familjar në Republikën e Kosovës.</p> <p>3. Në rastin e një martese poligame, kur sponsori tashmë ka një bashkëshort që jeton me të në territorin e Republikës së Kosovës, nuk jepet lejeqëndrimi për qëllim të ribashkimit familjar me një bashkëshort të mëvonshëm.</p> <p>4. Bashkëshortë sipas paragrafit 1 të këtij neni konsiderohen edhe partnerët jashtëmartesorë:</p> <p>4.1. që jetojnë së bashku për një periudhë prej së paku tre (3) vjet, ose</p> <p>4.2. që kanë të regjistruar bashkëjetesën; ose</p> <p>4.3. që kanë një fëmijë të përbashkët të mitur të pamartuar duke përfshirë fëmijë të adoptuar, apo fëmijë të rritur të pamartuar të cilët objektivist nuk janë në gjendje të kujdesen për vete për arsye shëndetësore.</p>	<p>consider as family members of persons under paragraph 1 of Article 38 of this Law other persons if there are special personal or serious humanitarian reasons for family reunification in the Republic of Kosovo.</p> <p>3. In the case of a polygamous marriage, when the sponsor already has a spouse living with him in the territory of the Republic of Kosovo, the residence permit shall not be granted for the purpose of family reunification with a subsequent spouse.</p> <p>4. According to paragraph 1 of this Article, spouses shall also consider extramarital partners:</p> <p>4.1. living together for a period of at least three (3) years, or</p> <p>4.2. who have registered cohabitation; or</p> <p>4.3. who have a joint minor unmarried child including adopted children, or adult unmarried children who are objectively unable to take care of themselves for health reasons.</p>	<p>članove porodica lica iz stava 1. člana 38. ovog zakona, i druga lica, ako postoje posebni lični ili ozbiljni humanitarni razlozi za spajanje porodice u Republici Kosovo.</p> <p>3. U slučaju poligamnog braka, kada sponzor već ima supružnika koji živi sa njim na teritoriji Republike Kosovo, neće se izdati dozvola za boravak po osnovu spajanje porodice sa sledećim supružnikom.</p> <p>4. Supružnici iz stava 1. ovog člana smatraju se i vanbračni partneri:</p> <p>4.1. koji žive zajedno u periodu od najmanje tri (3) godine, ili</p> <p>4.2. koji imaju registrovani zajednički život; ili</p> <p>4.3. koji imaju zajedničko maloletno neudato i neoženjeno dete, uključujući usvojeno decu ili odraslu neudatu i neoženjenu decu, koja objektivno nisu u stanju da se staraju o sebi iz zdravstvenih razloga.</p>
--	--	--

5. Lejeqëndrimi për qëllim të ribashkimit familjar nuk jepet nëse bashkëshorti, ose partneri jashtëmartesor, është i martuar ose është në një marrëdhënie afatgjatë me një person tjetër.

Neni 40

Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm për anëtarët e familjes së të huajit që gëzojnë mbrojtje në pajtim me Ligjin për Azil

1. Me qëllim të ribashkimit familjar, anëtari i familjes së personit që i është dhënë statusi i mbrojtjes ndërkombëtare apo mbrojtjes së përkohshme në përputhje me ligjin për azil, për fitimin e lejeqëndrimit të përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar nuk i kërkohet të përmbushë kushtet e përcaktuara në nënparagrafin 1.3, 1.4 dhe 1.5 të nenit 33 të këtij ligji.

2. Nëse i huaji që i është njohur statusi i mbrojtjes ndërkombëtare në përputhje me ligjin për azil është fëmijë i pashoqëruar, atëherë Republika e Kosovës:

5. The residence permit for the purpose of family reunification shall not granted if the spouse or extramarital partner is married or in a long-term relationship with another person.

Article 40

Entry and temporary stay for family members of a foreigner who enjoys protection in accordance with the Law on Asylum

1. For the purpose of family reunification, a family member of a person who has been granted international protection or temporary protection status in accordance with the Law on Asylum, in order to obtain a temporary residence permit for the purpose of family reunification, shall not required to fulfil the conditions outlined in subparagraphs 1.3, 1.4 and 1.5 of Article 33 of this Law.

2. If a foreigner who has been granted international protection status in accordance with the Law on Asylum is an unaccompanied child, then the Republic of Kosovo shall:

5. Dozvola za boravak po osnovu spajanja porodice neće se izdati ako je supružnik ili vanbračni partner u braku ili je u dugoročnoj vezi sa drugom osobom.

Član 40

Ulazak i privremeni boravak članova porodice stranca koji uživaju zaštitu u skladu sa Zakonom o azilu

1. U cilju spajanja porodice, član porodice lica kome je dodeljen status međunarodne zaštite ili privremene zaštite u skladu sa Zakonom o azilu, za dobijanja dozvole za privremeni boravak po osnovu spajanja porodice, nije dužan da ispunjava uslove utvrđene tačkama 1.3, 1.4 i 1.5 člana 33. ovog zakona.

2. Ako je stranac kome je priznat status međunarodne zaštite u skladu sa Zakonom o azilu, dete bez pratnje, tada Republika Kosovo:

<p>2.1. autorizon hyrjen dhe qëndrimin e prindërve të tij me qëllim të ribashkimit familjar;</p> <p>2.2. autorizon hyrjen dhe qëndrimin me qëllim të ribashkimit familjar të kujdestarit ligjor të tij, apo ndonjë anëtar tjetër të familjes, kur prindërit nuk mund të gjinden.</p> <p>3. Kur personi nën mbrojtje ndërkombëtare, apo mbrojtje të përkohshme sipas ligjit për azil, nuk mund të ofrojë dëshmi zyrtare të marrëdhënies familjare, MPB-ja merr parasysh dëshmi të tjera të ekzistencës së marrëdhënies së tij që vlerësohen në pajtim me legjislacionin në fuqi. Kërkesa nuk mund të refuzohet vetëm mbi bazën e mungesës së dëshmisë zyrtare të marrëdhënies familjare.</p> <p>4. Personave sipas këtij neni që parashtrajnë kërkesë për qëndrim të përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar u krijohen lehtësira për pajisje me vizë hyrëse. Rregullat për zbatim të këtij paragrafi përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Ministri përkatës për punë të jashtme.</p>	<p>2.1 authorize entry and stay for the purpose of family reunification of his or her parents;</p> <p>2.2 authorize the entry and stay for the purpose of family reunification of his or her legal guardian or any other family member, when the parents may not be identified.</p> <p>3. When the person under international protection or temporary protection according to the Law on Asylum is unable to provide official evidence of the family relationship, MIA takes into account other evidence of the existence of his or her relationship that is assessed in accordance with the applicable legislation. The application may not be rejected only on the basis of the lack of official evidence of the family relationship.</p> <p>4. Persons under this Article who submit an application for temporary residence for the purpose of family reunification, shall be provided facilities for obtaining an entry visa. The rules for the implementation of this paragraph shall be defined by a bylaw adopted by the Minister responsible for foreign affairs.</p>	<p>2.1. odobriće ulazak i boravak po osnovu spajanja porodice njegovih roditelja;</p> <p>2.2. odobriće ulazak i boravak po osnovu spajanja porodice njegovog zakonskog staratelja ili bilo kog drugog člana porodice, kada se roditelji ne mogu naći.</p> <p>3. Kada lice pod međunarodnom zaštitom ili privremene zaštite u skladu sa Zakonom o azilu ne može da priloži službeni dokaz o porodičnim odnosima, MUP će uzeti u obzir druge dokaze o postojanju takvih odnosa, koji će biti ocenjeni u skladu sa važećim zakonodavstvom. Zahtev se ne može odbijati samo na osnovu nedostatka službenog dokaza o porodičnim odnosima.</p> <p>4. Licima iz ovog člana, koja podnesu zahtev za privremeni boravak po osnovu spajanja porodice, biće obezbeđene olakšice za izdavanje ulazne vize. Pravila za sprovođenje ovog stava utvrdiće se podzakonskim aktom koji usvaja ministar nadležnog ministarstva za spoljne poslove.</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 41 Vlefshmëria e lejeqëndrimit të përkohshëm për qëllim të ribashkimit familjar</p> <p>1. Lejeqëndrimi i përkohshëm për qëllim të ribashkimit familjar jepet në afat vlefshmërie prej një (1) viti, ose deri në skadimin e lejeqëndrimit të përkohshëm të të huajit i cili kërkon ribashkimin familjar.</p> <p>2. I huaji, i cili ka qëndruar me lejeqëndrim të përkohshëm për qëllim të ribashkimit familjar për të paktën dy (2) vitet e fundit, pajiset me lejeqëndrim me afat vlefshmërie prej dy (2) vitesh, ose deri në skadimin e lejeqëndrimit të përkohshëm të të huajit me të cilin është kërkuar ribashkimi familjar.</p> <p>3. Afati i lejeqëndrimit të përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar me shtetas të Republikës së Kosovës për herë të parë është (2) dy vjet. Pas kësaj periudhe lejeqëndrimi i përkohshëm sipas këtij paragrafi mund të vazhdohet për një afat vlefshmërie prej pesë (5) vitesh.</p>	<p style="text-align: center;">Article 41 Validity of a temporary residence permit for the purpose of family reunification</p> <p>1. A temporary residence permit for the purpose of family reunification shall be granted for a validity period of one (1) year or until the expiration of the temporary residence permit of a foreigner who seeks family reunification.</p> <p>2. A foreigner, who has stayed with a temporary residence permit for the purpose of family reunification for at least the last two (2) years, shall be provided with a residence permit with a validity period of two (2) years or until the expiration of the foreigner's temporary residence permit with which family reunification was requested.</p> <p>3. The term of the temporary residence permit for the purpose of family reunification with citizens of the Republic of Kosovo for the first time shall be (2) two years. After this period, the temporary residence permit according to this paragraph may be extended for a validity period of five (5) years.</p>	<p style="text-align: center;">Član 41 Rok važenja dozvole za privremeni boravak po osnovu spajanja porodice</p> <p>1. Dozvola za privremeni boravak po osnovu spajanja porodice izdaje se na rok važenja od jedne (1) godine ili do isteka dozvole za privremeni boravak stranca koji traži spajanje porodice.</p> <p>2. Strancu, koji je boravio sa dozvolom za privremeni boravak po osnovu spajanja porodice najmanje u dve (2) poslednje godine, izdaje mu se dozvola za boravak sa rokom važenja od dve (2) godine ili do isteka dozvole za privremeni boravak stranca sa kojim je zatraženo spajanje porodice.</p> <p>3. Rok važenja dozvola za privremeni boravak po osnovu spajanja porodice sa državljaninom Republike Kosovo, po prvi put, je dve (2) godine. Nakon ovog perioda, dozvola za privremeni boravak u skladu sa ovim stavom, može se produžiti na rok važenja od pet (5) godina.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 42 Lejeqëndrimi autonom</p>	<p style="text-align: center;">Article 42 Autonomous residence permit</p>	<p style="text-align: center;">Član 42 Samostalni boravak</p>
<p>1. Bashkëshortët, bashkëjetuesit, prindërit dhe fëmijët e rritur të pamartuar sipas paragrafit 1 të nenit 39 të këtij ligji kanë të drejtë të pajisen me lejeqëndrim autonom të ndarë nga ai i sponsorit, në qoftë se kanë qëndruar në Republikën e Kosovës për të paktën tre (3) vite të vazhdueshme me lejeqëndrim për ribashkim familjar, me kusht që të mos kenë marrë lejeqëndrim për arsye të tjera nga ajo e ribashkimit familjar.</p> <p>2. Përjashtimisht, një të huaji nga paragrafi 1 i këtij neni mund t'i jepet një lejeqëndrim autonom nëse atij i është dhënë lejeqëndrimi i përkohshëm për qëllim të ribashkimit familjar për një periudhë të vazhdueshme prej një (1) viti dhe në rast se personi që ka shërbyer si sponsor ka vdekur.</p> <p>3. Përjashtimisht, kur zgjidhja e marrëdhënies familjare me bashkëshortin/bashkëjetuesin bëhet për shkak të dhunës në familje ose formave të tjera të dhunës me bazë gjinore, viktimave të dhunës me bazë gjinore u</p>	<p>1. Spouses, cohabitants, parents and unmarried adult children under paragraph 1 of Article 39 of this Law have the right to be provided with an autonomous residence permit separate from that of the sponsor, if they have stayed in the Republic of Kosovo for at least three (3) continuous years with a residence permit for family reunification, provided that they have not received a residence permit for reasons other than family reunification.</p> <p>2. Exceptionally, a foreigner from paragraph 1 of this Article may be granted an autonomous residence permit if he or she has been granted a temporary residence permit for the purpose of family reunification for a continuous period of one (1) year and in the event that the person who has served as a sponsor has died.</p> <p>3. Exceptionally, when the termination of the family relationship with the spouse/cohabitant is due to domestic violence or other forms of gender-based violence, victims of gender-based violence shall be granted an autonomous</p>	<p>1. Supružnici, vanbračni partneri i odrasla neudata i neoženjena deca, iz stava 1. člana 39. ovog zakona, imaju pravo na izdavanje dozvole za samostalni boravak odvojen od sponzora, ako su boravili u Republici Kosovo neprekidno najmanje tri (3) godine sa dozvolom za boravak po osnovu spajanje porodice, pod uslovom da nisu dobili dozvolu za boravak iz drugih razloga koji nisu spajanje porodice.</p> <p>2. Izuzetno, strancu iz stava 1. ovog člana, može se odobriti samostalni boravak ako je njemu izdata dozvola za privremeni boravak po osnovu spajanja porodice u neprekidnom roku od jedne (1) godine, i ako je lice koje je služilo ka sponzor preminulo.</p> <p>3. Izuzetno, kada je raskid porodičnih odnosa sa supružnikom/vanbračnim partnerom vrši usled nasilja u porodici ili drugih oblika rodno zasnovanog nasilja, žrtvama rodno zasnovanog nasilja se, na zahtev, izdaje dozvola za samostalni</p>

<p>jepet sipas kërkesës së tyre lejeqëndrim autonom, pavarësisht nga kohëzgjatja e martesës ose marrëdhënies familjare.</p> <p style="text-align: center;">Neni 43</p> <p style="text-align: center;">Të drejtat e të huajve me qëndrim të përkohshëm për qëllim të ribashkimit familjar dhe lejeqëndrimin autonom</p> <p>I huaji, të cilit i është dhënë lejeqëndrim i përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar dhe i huaji me lejeqëndrim autonom, gëzon të drejtën për shkollim, aftësim profesional, punë dhe vetëpunësim.</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli 3</p> <p style="text-align: center;">Lejeqëndrimi i përkohshëm me qëllim të arsimimit, trajnimit, kërkimit shkencor, shërbimit vullnetar, skemave të shkëmbimit të studentëve ose projekteve arsimore dhe <i>au pairing</i></p> <p style="text-align: center;">Neni 44</p> <p style="text-align: center;">Lejeqëndrimi i përkohshëm me qëllim të arsimimit para universitar</p> <p>1. Lejeqëndrimi i përkohshëm për qëllim të arsimimit para universitar i jepet</p>	<p>residence permit at their request, regardless of the duration of the marriage or family relationship.</p> <p style="text-align: center;">Article 43</p> <p style="text-align: center;">Rights of foreigners with temporary residence for the purpose of family reunification and autonomous residence permit</p> <p>A foreigner, who has been granted a temporary residence permit for the purpose of family reunification and a foreigner with an autonomous residence permit, shall be entitled to education, vocational training, employment and self-employment.</p> <p style="text-align: center;">Subchapter 3</p> <p style="text-align: center;">Temporary residence permit for the purpose of education, training, scientific research, voluntary service, student exchange schemes or educational projects and <i>au pairing</i></p> <p style="text-align: center;">Article 44</p> <p style="text-align: center;">Temporary residence permit for the purpose of pre-university education</p> <p>1. A temporary residence permit for the purpose of pre-university education shall</p>	<p>boravak, bez obzira na trajanje braka ili porodičnih odnosa.</p> <p style="text-align: center;">Član 43</p> <p style="text-align: center;">Prava stranaca sa privremenim boravkom po osnovu spajanja porodice i sa dozvolom za samostalni boravak</p> <p>Stranac kome je izdata dozvola za privremeni boravak po osnovu spajanja porodice i stranac sa dozvolom za samostalni boravak, uživa ima pravo na obrazovanje, stručno usavršavanje, zapošljavanje i samozapošljavanje.</p> <p style="text-align: center;">Potpoglavlje 3</p> <p style="text-align: center;">Dozvola za privremeni boravak po osnovu obrazovanja, obuke, naučnog istraživanja, volontiranja, programa razmene studenata ili obrazovnih projekata i <i>au pairing</i></p> <p style="text-align: center;">Član 44</p> <p style="text-align: center;">Dozvola za privremeni boravak po osnovu preduniverzitetskog obrazovanja</p> <p>1. Dozvola za privremeni boravak po osnovu preduniverzitetskog obrazovanja</p>
---	---	---

<p>një të huaji që përveç kriterëve nga neni 33 i këtij ligji, përmbush edhe kriteret e mëposhtme:</p> <p>1.1. dëshmon se është pranuar në institucionin arsimor parauniversitar;</p> <p>1.2. merr pjesë në një program të akredituar shtetëror ose rajonal të arsimit në kontekst të shkëmbimit të nxënësve, ose një projekti të arsimit të ofruar nga një institucion arsimor në përputhje me legjislacioni në fuqi;</p> <p>1.3. paraqet pëlqimin e prindërve ose kujdestarit ligjor për qëndrimin e planifikuar, qëllimi i të cilit është arsimimi parauniversitar në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.4. ofron dëshmi se institucioni arsimor ose një palë e tretë pranon përgjegjësinë për të huajin gjatë qëndrimit të tij në territorin e Republikës së Kosovës, veçanërisht për sa i përket shpenzimeve të shkollimit; dhe</p> <p>1.5. ofron dëshmi se i huaji do të akomodohet gjatë tërë qëndrimit nga</p>	<p>be issued to a foreigner who, in addition to the criteria from Article 33 of this Law, meets the following criteria:</p> <p>1.1. proves that he or she has been admitted to the pre-university educational institution;</p> <p>1.2. participates in an accredited state or regional education program in the context of student exchange or an education project provided by an educational institution in accordance with applicable legislation;</p> <p>1.3. presents the consent of the parents or legal guardian for the planned stay, the purpose of which is pre-university education in the Republic of Kosovo;</p> <p>1.4. provides evidence that the educational institution or a third party assumes the responsibility for the foreigner during his or her stay in the territory of the Republic of Kosovo, especially in terms of education expenses; and</p> <p>1.5. provides evidence that the foreigner will be accommodated</p>	<p>izdaje se strancu, koji pored kriterijuma iz člana 33. ovog zakona, ispunjava i sledeće kriterijume:</p> <p>1.1. dokaže da je primljen u preduniverzitetskoj obrazovnoj ustanovi;</p> <p>1.2. učestvuje u akreditovanom državnom ili regionalnom obrazovnom programu u kontekstu razmene učenika ili obrazovnom projektu pruženom od obrazovne ustanove u skladu sa važećim zakonodavstvom;</p> <p>1.3. priloži saglasnost roditelja ili zakonskog staratelja za planirani boravak, čije cilj preduniverzitetsko obrazovanje u Republici Kosovo;</p> <p>1.4. priloži dokaz da je obrazovna ustanova ili treće lice prihvata odgovornost za stranca tokom njegovog boravka na teritoriji Republike Kosovo, posebno u pogledu troškova školovanja; i</p> <p>1.5. priloži dokaz da će stranac tokom čitavog boravka biti smešten</p>
--	--	--

<p>një familje, në një objekt të veçantë akomodimi brenda institucionit arsimor, ose në çdo objekt tjetër të përzgjedhur në përputhje me rregullat e skemës së shkëmbimit të nxënësve apo projektit arsimor në të cilin merr pjesë i huaji, në përputhje me legjisllacionin në fuqi.</p> <p>2. Lejeqëndrimi i përkohshëm sipas paragrafit 1 të këtij neni lëshohet me afat vlefshmërie deri në një (1) vit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 45 Lejeqëndrimi i përkohshëm me qëllim të arsimimit të lartë</p> <p>1. Lejeqëndrimi i përkohshëm me qëllim të arsimimit të lartë i jepet të huajit që përveç kriterëve nga neni 33 i këtij ligji, përmbush edhe kriteret e mëposhtme:</p> <p>1.1. është pranuar në një institucion të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.2. dëshmon se ka njohuri të gjuhës në të cilën zhvillohet programi;</p>	<p>during the entire stay by a family, in a special accommodation facility within the educational institution, or in any other facility selected in accordance with the rules of the student exchange scheme or educational project in which he or she takes part, in accordance with the applicable legislation.</p> <p>2. The temporary residence permit under paragraph 1 of this Article shall be issued for a validity period of up to one (1) year.</p> <p style="text-align: center;">Article 45 Temporary residence permit for the purpose of higher education</p> <p>1. A temporary residence permit for the purpose of higher education shall be issued to a foreigner who, in addition to the criteria from Article 33 of this Law, also fulfils the following criteria:</p> <p>1.1. has been admitted to a higher education institution in the Republic of Kosovo;</p> <p>1.2. proves that he or she is proficient in the language in which the program is provided;</p>	<p>u porodici, u posebnom smeštajnom objektu u okviru obrazovne ustanove, ili u bilo kom drugom objektu odabranom u skladu sa pravilima programa razmene učenika ili obrazovnog projekta u kojem učestvuje stranac, u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p> <p>2. Dozvola za privremeni boravak u skladu sa stavom 1. ovog člana, izdaje se na rok važenja do jedne (1) godine.</p> <p style="text-align: center;">Član 45 Dozvola za privremeni boravak po osnovu visokog obrazovanja</p> <p>1. Dozvola za privremeni boravak po osnovu visokog obrazovanja izdaje se strancu, koji pored kriterijuma iz člana 33. ovog zakona, ispunjava i sledeće kriterijume:</p> <p>1.1. primljen je u visokoškolskoj ustanovi u Republici Kosovo;</p> <p>1.2. dokaže da zna jezik na kojem se program odvija;</p>
--	--	---

<p>1.3. ka mjete të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e studimit.</p> <p>2. Studentit të diplomuar në një nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës që kërkon punësim, mund t'i vazhdohet lejeqëndrimi edhe për nëntë (9) muaj. Kërkesa duhet të parashtrohet brenda tre (3) muajve nga data e diplomimit të tij.</p> <p>3. Të drejtën sipas paragrafit 1 të këtij neni e kanë edhe të huajt të cilët kryejnë praktikë si vazhdimësi të ciklit të studimeve në organizatat dhe institucionet e autorizuara, apo në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare apo marrëveshjeve ndërmjet institucioneve.</p> <p>4. Lejeqëndrimi i përkohshëm sipas këtij neni lëshohet me afat vlefshmërie deri në një (1) vit. Në rast të kërkesës për vazhdim të lejeqëndrimit për qëllim të arsimimit të lartë, lejeqëndrimi i përkohshëm lëshohet me afat vlefshmërie deri në përfundim të programit të studimit.</p>	<p>1.3. has sufficient funds to cover the study expenses.</p> <p>2. A student who has graduated from one of the institutions of higher education in the Republic of Kosovo and is looking for employment may have his or her residence permit extended for another nine (9) months. The application shall be submitted within three (3) months from the date of his or her graduation.</p> <p>3. The right according to paragraph 1 of this Article shall also be available to foreigners who carry out internships as a continuation of the cycle of studies in authorized organizations and institutions, or on the basis of international agreements or agreements between institutions.</p> <p>4. A temporary residence permit under this Article shall be issued with a validity period of up to one (1) year. In case of an application to extend the residence permit for the purpose of higher education, the temporary residence permit shall be issued with a validity period until the end of the study program.</p>	<p>1.3. ima dovoljna sredstva za pokrivanje troškova studiranja.</p> <p>2. Studentu, koji je diplomirao u jednoj od visokoškolskih ustanova u Republici Kosovo, koji traži zaposlenje, može da mu se produži dozvola za boravak na još devet (9) meseci. Zahtev treba podneti u roku od tri (3) meseca od dana njegovog diplomiranja.</p> <p>3. Pravo iz stava 1. ovog člana imaju i stranci koji obavljaju pripravnički staž kao nastavak ciklusa studija, u ovlašćenim organizacijama i ustanovama, ili na osnovu međunarodnih sporazuma ili sporazuma između ustanova.</p> <p>4. Dozvola za privremeni boravak iz ovog člana izdaje se na rok važenja do jedne (1) godine. U slučaju zahteva za produženje dozvole za boravak po osnovu visokog obrazovanja, dozvola za privremeni boravak se izdaje sa rokom važenja do završetka studijskog programa.</p>
---	---	--

5. I huaji me lejeqëndrim të përkohshëm sipas këtij neni mund të punojë jashtë orëve të rregullta të studimit, siç përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Ministri i MPB-së.

Neni 46
Lejeqëndrimi i përkohshëm me qëllim të kërkimit shkencor

1. Lejeqëndrimi i përkohshëm me qëllim të kërkimit shkencor i jepet të huajit i cili ka marrëveshje me një institucion të licencuar në Republikën e Kosovës dhe plotëson kriteret e nenit 33 të këtij ligji.

2. I huaji që ka marrëveshje me qëllim të kërkimit shkencor në ndonjë nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, apo shtetet të cilat janë pjesë e zonës Shengen, mund të qëndrojë me qëllim të kërkimeve shkencore deri në nëntëdhjetë (90) ditë në Republikën e Kosovës pa marrëveshje sipas paragrafit 1 të këtij neni, me kusht që t'i plotësojë kriteret nga neni 33 i këtij ligji.

3. Të huajit sipas paragrafit 1 të këtij neni që kërkon punësim pas përfundimit të kërkimit shkencor mund t'i vazhdohet lejeqëndrimi edhe për nëntë (9) muaj.

5. A foreigner with a temporary residence permit according to this Article may work outside regular study hours, as defined by a bylaw issued by the Minister of MIA.

Article 46
Temporary residence permit for the purpose of scientific research

1. A temporary residence permit for the purpose of scientific research shall be issued to a foreigner who has an agreement with a licensed institution in the Republic of Kosovo and meets the criteria of Article 33 of this Law.

2. A foreigner, who has an agreement for the purpose of scientific research in any of the European Union member states or the countries that are part of the Schengen area, may stay for the purpose of scientific research for up to ninety (90) days in the Republic of Kosovo without agreement according to paragraph 1 of this Article, provided that he or she meets the criteria from Article 33 of this Law.

3. A foreigner under paragraph 1 of this Article, who has completed scientific research that requires employment, may have his or her residence permit extended

5. Stranac sa dozvolom za privremeni boravak iz ovog člana, može da radi van redovnih časova studija, kao što je utvrđeno podzakonskim aktom koji donosi ministar MUP-a.

Član 46
Dozvola za privremeni boravak po osnovu naučnog istraživanja

1. Dozvola za privremeni boravak po osnovu naučnog istraživanja izdaje se strancu koji ima sporazum sa licenciranom institucijom u Republici Kosovo, i ispunjava kriterijume iz člana 33. ovog zakona.

2. Stranac koji ima sporazum po osnovu naučnog istraživanja sa bilo kojom zemljom članicom Evropske Unije ili zemljom koja je deo Šengen zone, može da boravi u Republici Kosovo po osnovu naučnih istraživanja, do devedeset (90) dana bez sporazuma iz stava 1. ovog člana, pod uslovom da ispunjava kriterijume iz člana 33. ovog zakona.

3. Strancu iz stava 1. ovog člana koji traži zaposlenje nakon završetka naučnog istraživanja, može se produžiti dozvola za boravak na još devet (9) meseci. Zahtev

<p>Kërkesa duhet të parashtrohet brenda tre (3) muajve nga data e përfundimit të kërimit shkencor.</p> <p>4. Lejeqëndrimi i përkohshëm për qëllim të kërimit shkencor lëshohet me afat vlefshmërie deri në një (1) vit. Në rast të kërkesës për vazhdim të lejeqëndrimit për qëllim të kërimit shkencor, lejeqëndrimi i përkohshëm lëshohet me afat vlefshmërie deri në përfundim të kërimit shkencor.</p> <p>5. I huaji me lejeqëndrim të përkohshëm sipas këtij neni mund të angazhohet në mësimdhënie, siç përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri i MPB-së.</p> <p style="text-align: center;">Neni 47 Lejeqëndrimi për shërbime vullnetare</p> <p>Lejeqëndrimi i përkohshëm me qëllim të shërbimit vullnetar i jepet të huajit që cili plotëson kriteret e nenit 33 të këtij ligji dhe ka marrëveshje me një organizatë apo organ tjetër përgjegjës për organizimin e skemës së shërbimit vullnetar në të cilën i huaji do të marrë pjesë.</p>	<p>for another nine (9) months. The application shall be submitted within three (3) months from the date of completion of the scientific research.</p> <p>4. A temporary residence permit for the purpose of scientific research shall be issued with a validity period of up to one (1) year. In case of an application to extend the residence permit for the purpose of scientific research, the temporary residence permit shall be issued for a validity period until the end of the scientific research.</p> <p>5. A foreigner with a temporary residence permit under this Article may engage in teaching, as defined by a bylaw issued by the Minister of MIA.</p> <p style="text-align: center;">Article 47 Residence permit for voluntary services</p> <p>A temporary residence permit for the purpose of voluntary service shall be issued to a foreigner who meets the criteria of Article 33 of this Law and has an agreement with an organization or other entity responsible for organizing</p>	<p>treba podneti u roku od tri (3) meseca od dana završetka naučnog istraživanja.</p> <p>4. Dozvola za privremeni boravak po osnovu naučnog istraživanja izdaje se sa rokom važenja do jedne (1) godine. U slučaju zahteva za produženje dozvole za boravak po osnovu naučnog istraživanja, dozvola za privremeni boravak se izdaje sa rokom važenja do završetka naučnog istraživanja.</p> <p>5. Stranac sa dozvolom za privremeni boravak iz ovog člana, može se angažovati u nastavi, kao što je utvrđeno podzakonskim aktom koji donosi ministar MUP-a.</p> <p style="text-align: center;">Član 47 Dozvola za boravak po osnovu volonterskih usluga</p> <p>Dozvola za privremeni boravak po osnovu volonterskih usluga izdaje se strancu koji ispunjava kriterijume iz člana 33. ovog zakona i ima sporazum sa organizacijom ili drugim nadležnim organom za organizovanje programa</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 48 Lejeqëndrimi “au pair”</p> <p>1. Lejeqëndrimi i përkohshëm “<i>au pair</i>” i jepet të huajit që përveç kriterëve nga neni 33 i këtij ligji, përmbush edhe kriteret e mëposhtme:</p> <p>1.1. ka nënshkruar marrëveshje me familjen pritëse;</p> <p>1.2. i huaji është mes moshës 18 dhe 30 vjeçare;</p> <p>1.3. paraqet dëshmi se familja pritëse ose organizata ndërmjetësuese pranon përgjegjësinë për të huajin gjatë qëndrimit të tij në territorin e Republikës së Kosovës, përsa i përket shpenzimeve të jetesës, akomodimit dhe sigurimit shëndetësor;</p> <p>1.4. ka njohuri bazike të njërës prej gjuhëve zyrtare në Kosovë;</p>	<p>the voluntary service scheme in which the foreigner will participate.</p> <p style="text-align: center;">Article 48 “Au pair” residence permit</p> <p>1. A “<i>au pair</i>” temporary residence permit shall be issued to a foreigner who, in addition to the criteria from Article 33 of this Law, also meets the following criteria:</p> <p>1.1. has signed an agreement with the host family;</p> <p>1.2. the foreigner is between the ages of 18 and 30 years;</p> <p>1.3. presents evidence that the host family or intermediary organization assumes the responsibility for the foreigner during his or her stay in the territory of the Republic of Kosovo in terms of living expenses, accommodation and health insurance;</p> <p>1.4. has basic knowledge of one of the official languages in Kosovo;</p>	<p>volonterskih usluga u kojoj će stranac učestvovati.</p> <p style="text-align: center;">Član 48 Dozvola za boravak „au pair“</p> <p>1. Dozvola za privremeni boravak „<i>au pair</i>“ se izdaje strancu, koji pored kriterijuma iz člana 33. ovog zakona, ispunjava i sledeće kriterijume:</p> <p>1.1. potpisao je ugovor sa porodicom domaćinom;</p> <p>1.2. stranac je između 18 i 30 godina;</p> <p>1.3. priloži dokaz da porodica domaćin ili posrednička organizacija prihvata odgovornost za stranca tokom njegovog boravka na teritoriji Republike Kosovo, u pogledu životnih troškova, smeštaja i zdravstvenog osiguranja.</p> <p>1.4. dokaže elementarno poznavanje jednog od službenih jezika na Kosovu;</p>
--	---	--

<p>1.5. ofron dëshmi për përfundimin e arsimit të mesëm, të lartë, apo kualifikimeve profesionale, ose që plotëson kushtet për të ushtruar një profesion të rregulluar, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi; dhe</p> <p>1.6. ka shtetësi të ndryshme nga anëtarët e familjes pritëse dhe nuk ka lidhje familjare me familjen pritëse.</p> <p>2. Kohëzgjatja maksimale e punës si <i>au pair</i> nuk mund të tejkalojë njëzetepesë (25) orë pune në javë. I huaji, sipas këtij neni, duhet të ketë të paktën një (1) ditë të lirë në javë nga puna si <i>au pair</i>.</p> <p style="text-align: center;">Neni 49 Lejeqëndrimi për qëllim të ndjekjes së praktikës</p> <p>Lejeqëndrimi i përkohshëm për praktikantët i jepet të huajit i cili plotëson kriteret e nenit 33 të këtij ligji dhe ka marrëveshje trajnimi me një organizatë vendore.</p>	<p>1.5. provides evidence of completion of secondary higher education, or professional qualifications or that meets the conditions to practice a regulated profession, as required by the applicable legislation; and</p> <p>1.6. has a different nationality from the members of the host family and is not related to the host family.</p> <p>2. The maximum duration of work as <i>an au pair</i> cannot exceed twenty-five (25) working hours per week. A foreigner under this Article shall have at least one (1) day off weekly from work as an <i>au pair</i>.</p> <p style="text-align: center;">Article 49 Residence permit for the purpose of pursuing an internship</p> <p>A temporary residence permit for interns shall be issued to a foreigner who meets the criteria of Article 33 of this Law and has a training agreement with a local organization.</p>	<p>1.5. priloži dokaz o završenom srednjom ili visokom obrazovanju ili stručnom spremom, ili koji ispunjava uslova za bavljenje regulisanom profesijom, kako se zahteva važećim zakonodavstvom; i</p> <p>1.6. ima različito državljanstvo od članova porodice domaćina i nema rodbinske veze sa porodicom domaćinom.</p> <p>2. Maksimalno trajanje obavljanja poslova <i>au pair</i> ne može prekoračiti dvadeset pet (25) dana nedeljno. Stranac iz ovog stava treba da ima najmanje jedan (1) slobodan dan nedeljno u obavljanu poslova <i>au pair</i>.</p> <p style="text-align: center;">Član 49 Dozvola za boravak po osnovu obavljanja pripravnčkog staža</p> <p>Dozvola za privremeni boravak za pripravnike izdaje se strancu koji ispunjava kriterijume iz člana 33. ovog zakona, i ima ugovor o obuci sa domaćom organizacijom.</p>
---	--	---

<p style="text-align: center;">Nënkapitulli 4 Lejeqëndrimi për arsye humanitare</p> <p style="text-align: center;">Neni 50 Lejeqëndrimi i përkohshëm për arsye humanitare</p> <p>1. Lejeqëndrimi i përkohshëm për arsye humanitare i jepet të huajit edhe nëse nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji, në rast se i huaji:</p> <p>1.1. ka qenë subjekt i kushteve të punës shfrytëzuese në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunon në një proces penal kundër punëdhënësit deri në përfundimin e procesit;</p> <p>1.2. është i mitur i braktisur ose ka mbetur pa mbrojtje prindërore, kujdestari apo shoqërues për arsye të tjera;</p> <p>1.3. është shtatzënë mbi gjashtë (6) muaj, apo qoftë edhe më pak se gjashtë (6) muaj në rast se rekomandohet nga organi kompetent shëndetësor;</p>	<p style="text-align: center;">Subchapter 4 Residence permit for humanitarian reasons</p> <p style="text-align: center;">Article 50 Temporary residence permit for humanitarian reasons</p> <p>1. A temporary residence permit for humanitarian reasons shall be issued to a foreigner even if he or she does not meet the criteria defined under Article 33 of this Law in case the foreigner:</p> <p>1.1. has been subject to exploitative work conditions in the Republic of Kosovo and cooperates in criminal proceedings against the employer until the completion of proceedings;</p> <p>1.2. is an abandoned minor or has been left without parental protection, guardian or companion for other reasons;</p> <p>1.3. is more than six (6) months pregnant, or even less than six (6) months, if recommended by the competent healthcare body;</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje 4 Dozvola za boravak iz humanitarnih razloga</p> <p style="text-align: center;">Član 50. Dozvola za privremeni boravak iz humanitarnih razloga</p> <p>1. Dozvola za privremeni boravak iz humanitarnih razloga izdaje se strancu i ako ne ispunjava kriterijume utvrđene članom 33. ovog zakona, ako je stranac:</p> <p>1.1. podvrgnut eksploatatorskim uslovima rada u Republici Kosovo i saraduje u krivičnom procesu protiv poslodavca do okončanja procesa;</p> <p>1.2. maloletnik koji je napušten ili iz drugih razloga ostao bez roditeljske zaštite, starateljstva ili pratioca;</p> <p>1.3. trudna žena više od šest (6) meseci ili manje od šest (6) meseci, na osnovu preporuke nadležnog zdravstvenog organa;</p>
--	---	---

<p>1.4. është i sëmurë rëndë dhe nuk mund të trajtohet në vendin e kthimit;</p> <p>1.5. kërkon të qëndrojë sepse është larguar nga vendi i tij për shkak të fatkeqësive natyrore;</p> <p>1.6. ka të drejtë në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare, apo për arsye të tjera serioze humanitare.</p> <p>2. Lejeqëndrimi për këtë qëllim të huajit i lëshohet me afat një (1) vjeçar dhe mund të vazhdohet vetëm në rastet kur vlerësohet se qëndrimi i tij nuk përbën kërcënim për sigurinë shtetërore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 51 Lejeqëndrimi për mbrojtjen e viktimave të trafikimit me njerëz</p> <p>1. Lejeqëndrimi i përkohshëm për të huajin që është viktimë e trafikimit i jepet të huajit edhe nëse kriteret e përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji nuk plotësohen dhe nëse i huaji:</p> <p>1.1. është viktimë e trafikimit me njerëz apo ka qenë subjekt i</p>	<p>1.4. is seriously ill and may not be treated in the place of return;</p> <p>1.5. wants to stay because he or she left his or her country due to natural disasters;</p> <p>1.6. has a right based on an international agreement or for other serious humanitarian reasons.</p> <p>2. The residence permit for this purpose shall be issued to a foreigner for a period of one (1) year and may be extended only in cases where it is assessed that his or her stay does not pose a threat to state security.</p> <p style="text-align: center;">Article 51 Residence permit for the protection of victims of human trafficking</p> <p>1. A temporary residence permit to a foreigner who is a victim of trafficking shall be issued to the foreigner even if the criteria defined under Article 33 of this Law are not met and if the foreigner:</p> <p>1.1. is a victim of human trafficking or has been subjected to actions to facilitate illegal migration;</p>	<p>1.4. teška bolesna osoba i ne može se lečiti u zemlji povratka;</p> <p>1.5. traži da boravi jer je napustio svoju zemlju zbog prirodne nepogode;</p> <p>1.6. ima pravo na osnovu međunarodnog sporazuma ili iz drugih humanitarnih razloga.</p> <p>2. Dozvola za boravak za ovu svrhu izdaje se strancu na rok od jedne (1) godine i može se produžiti samo u slučajevima kada se proceni da njegov boravak ne predstavlja pretnju po nacionalnu bezbednost.</p> <p style="text-align: center;">Član 51 Dozvola za boravak za zaštitu žrtava trgovine ljudima</p> <p>1. Dozvola za privremeni boravak izdaje se strancu koji je žrtva trgovine ljudima, i ako nisu ispunjeni kriterijumi utvrđeni članom 33. ovog zakona, i ako:</p> <p>1.1. je on žrtva trgovine ljudima ili je bio podvrgnut radnjama za olakšavanje ilegalne migracije;</p>
--	---	---

<p>veprimeve për lehtësim të migrimit ilegal;</p> <p>1.2. ka bashkëpunuar apo pranon të bashkëpunojë me autoritetet e drejtësisë dhe sigurisë me propozimin e autoriteteve të sigurisë shtetërore dhe ky bashkëpunim ka gjasa të ndikojë pozitivisht në hetimin ose gjykimin e rastit. Këtë të drejtë e gëzojnë edhe anëtarët e familjes së viktimës, siç është përcaktuar me këtë ligj;</p> <p>1.3. ka shkëputur të gjitha lidhjet me të dyshuarit për kryerjen e veprave të trafikimit me qenie njerëzore apo lehtësimin e migrimit ilegal.</p> <p>2. Lejeqëndrimi i lëshuar për këtë qëllim shërben vetëm për qëndrimin e të huajit dhe nuk mundëson rihyrjen në territorin e Republikës së Kosovës në rast se i huaji del nga territori.</p> <p>3. Lejeqëndrimi për këtë qëllim të huajit i lëshohet me afat një (1) vjeçar dhe mund të vazhdohet vetëm në rastet kur:</p>	<p>1.2. has cooperated or agrees to cooperate with the justice and security authorities at the proposal of the state security authorities and this cooperation is likely to positively affect the investigation or trial of the case. This right shall also be enjoyed by the members of the victim's family, as defined by this Law;</p> <p>1.3. has severed all ties with suspects for committing offences of human trafficking or facilitating illegal migration.</p> <p>2. The residence permit issued for this purpose shall serve only for the foreigner's stay and does not enable re-entry to the territory of the Republic of Kosovo in case the foreigner leaves the territory.</p> <p>3. A residence permit for this purpose shall be issued to a foreigner for a period of one (1) year and may be extended only in cases where:</p>	<p>1.2. saradivao ili pristaje na saradnju sa pravosudnim i bezbednosnim organima na predlog organa državne bezbednosti i ova saradnja će verovatno uticati pozitivno na istragu ili suđenje o slučaju. Ovo pravo uživaju i članovi porodice žrtve, kao što je utvrđeno ovim zakonom;</p> <p>1.3. prekinuo sve veze sa osumnjičenima za izvršenje dela trgovine ljudima ili olakšavanje ilegalne migracije.</p> <p>2. Dozvola za boravak koja je izdata za ovu svrhu služi samo za boravak stranca i ne omogućava ponovni ulazak na teritoriji Republike Kosovo ako stranac napusti teritoriju.</p> <p>3. Dozvola za boravak za ovu svrhu izdaje se strancu na rok od (1) godine i može se produžiti samo u slučajevima kada:</p>
--	--	---

<p>3.1. vlerësohet se qëndrimi i tij nuk përbën kërcënim për sigurinë shtetërore;</p> <p>3.2. vlerësohet se ekziston një vullnet i qartë i personit për të bashkëpunuar me organet e drejtësisë apo sigurisë gjatë hetimit ose procedimit penal dhe ky bashkëpunim ka gjasa të ndikojë pozitivisht në hetimin ose gjykimin e rastit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 52 Periudha e reflektimit</p> <p>1. Republika e Kosovës duhet të sigurojë që të huajve sipas nenit 51 të këtij ligji t'u lejohet një periudhë reflektimi që i lejon ata të rimarrin veten dhe ti ikin ndikimit të kryesve të veprave në mënyrë që ata të marrin një vendim të bazuar nëse do të bashkëpunojnë me autoritetet kompetente. Kohëzgjatja e periudhës së reflektimit duhet të jetë prej tridhjetë (30) deri në nëntëdhjetë (90) ditë dhe fillon të llogaritet nga momenti kur çështja i referohet njësisë përkatëse kundër trafikimit me njerëz.</p> <p>2. Periudha e reflektimit nuk nënkupton se i huaji do të pajiset me lejeqëndrim të përkohshëm.</p>	<p>3.1. it is estimated that his or her stay poses no threat to state security;</p> <p>3.2. it is estimated that there is a clear will of the person to cooperate with the justice or security authorities during the investigation or criminal proceedings and this cooperation is likely to positively affect the investigation or trial of the case.</p> <p style="text-align: center;">Article 52 Reflection period</p> <p>1. The Republic of Kosovo shall ensure that foreigners under Article 51 of this Law are allowed a reflection period that allows them to recover and avoid the influence of the perpetrators so that they can make an informed decision whether to cooperate with the competent authorities. The duration of the reflection period shall be from thirty (30) to ninety (90) days and starts counting from the time when the case is referred to the relevant unit against human trafficking.</p> <p>2. The reflection period shall not imply that the foreigner shall be granted a temporary residence permit.</p>	<p>3.1. se procenjuje da njegov boravak ne predstavlja pretnju po nacionalnu bezbednost;</p> <p>3.2. se procenjuje da postoji jasna volja lica da saraduje da pravosudnim i bezbednosnim organima tokom krivične istrage ili postupka i ova saradnja će verovatno uticati pozitivno na istragu ili suđenje o slučaju.</p> <p style="text-align: center;">Član 52 Period refleksije</p> <p>1. Republika Kosovo treba obezbediti da strancima, u skladu sa članom 51. ovog zakona, odobri period za refleksiju i da im omogućava da se oporave i oslobode uticaja počinilaca dela, tako da oni mogu da donesu odluku o tome da li će saradivati sa nadležnim organima. Trajanje perioda refleksije treba da bude od trideset (30) do devedeset (90) dana i počinje da se računa od trenutka kada je pitanje upućeno relevantnoj jedinici protiv trgovine ljudima.</p> <p>2. Period refleksije ne znači da će strancu biti izdata dozvola za privremeni boravak.</p>
--	--	---

<p>3. Gjatë periudhës së reflektimit në pritje të vendimit nga autoriteti kompetent, i huaji gëzon të drejtat e përcaktuara në nenin 53 të këtij ligji dhe kur është e mundur asistencë psikologjike, shërbime të përkthimit dhe interpretimit, sigurisë, mbrojtje dhe ndihmë ligjore falas sipas legjislacionit në fuqi. Gjatë periudhës së reflektimit, ndaj të huajit nuk shqiptohet vendim për kthim. Periudha e reflektimit mund të përfundojë në çdo kohë nëse autoritetet kompetente kanë gjetur që personi në mënyre aktive, vullnetarisht dhe me iniciativën e tij e ka ripërtërirë kontaktin me kryesit e veprave, apo për arsye të tjera që lidhen me politikën publike dhe mbrojtjen e sigurisë shtetërore.</p> <p>4. Pasi të ketë përfunduar periudha e reflektimit, me kërkesë të autoriteteve kompetente, i huaji mund të pajiset me lejeqëndrim të përkohshëm për së paku gjashtë (6) muaj.</p> <p>5. Lejeqëndrimi sipas paragrafit 5 të këtij neni vazhdohet nëse kriteret sipas nenit 51 vazhdojnë të përmbushen.</p>	<p>3. During the reflection period and while waiting for the decision from the competent authority, a foreigner shall enjoy the rights defined under Article 53 of this Law and, as appropriate, psychological assistance, translation and interpretation services, security, protection and free legal aid according to the applicable law. During the reflection period, no return decision shall be issued against the foreigner. The reflection period may end at any time if the competent authorities have found that the person concerned has actively, voluntarily and on his or her own initiative renewed contact with the perpetrators or for other reasons related to public policy and the protection of state security.</p> <p>4. After the reflection period has ended, at the request of the competent authorities, a foreigner may be provided with a temporary residence permit for at least six (6) months.</p> <p>5. The residence permit according to paragraph 5 of this article shall be extended if the criteria under Article 51 continue to be met.</p>	<p>3. Tokom perioda refleksije, u iščekivanju odluke nadležnih organa, stranac uživa prava utvrđena članom 53. ovog zakona, i kada je to moguće, psihološku pomoć, usluge prevođenja i tumačenja, bezbednost, zaštitu i besplatnu pravnu pomoć u skladu sa važećim zakonodavstvom. Tokom perioda refleksije protiv stranca se ne donosi odluka o vraćanju. Period refleksije se može okončati u bilo kom trenutku ako su nadležni organi utvrdili da je dotično lice aktivno, dobrovoljno i na svoju inicijativu obnovilo kontakte sa izvršiocima dela ili iz drugih razloga koji se odnose na javne politike i zaštitu nacionalne bezbednosti.</p> <p>4. Nakon okončanja perioda refleksije, na zahtev nadležnih organa, strancu se može izdati dozvola za privremeni boravak na najmanje šest (6) meseci.</p> <p>5. Dozvola za boravak iz stava 5. ovog člana se produžava ako su i dalje ispunjeni kriterijumi iz člana 51.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 53 Të drejtat e personave me lejeqëndrim për viktimat e trafikimit me njerëz</p> <p>1. I huaji, të cilit i është dhënë lejeqëndrimi i përkohshëm sipas nenit 51 të këtij ligji, ka të drejtë për strehim të sigurtë, kujdes shëndetësor, ndihmë financiare për të mbuluar kërkesat themelore jetësore kur kjo është e mundur, arsim dhe punë sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>2. Kujdes i veçantë i kushtohet grupeve të cënueshme si gratë shtatzëna, të miturit dhe personat me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës në familje, pakicat, grupet indigjene, komunitetin LGBTIQ+, si dhe grupet e viktimave veçanërisht të ndjeshme.</p>	<p style="text-align: center;">Article 53 Rights of persons with residence permit for victims of human trafficking</p> <p>1. A foreigner who has been granted a temporary residence permit under Article 51 of this Law shall be entitled to safe accommodation, healthcare, financial assistance to cover basic life requirements when this is possible, education and work according to the relevant applicable legislation.</p> <p>2. Special attention shall be paid to vulnerable groups such as pregnant women, minors and persons with disabilities, victims of domestic violence, minorities, indigenous groups, the LGBTIQ+ community, as well as particularly vulnerable victim groups.</p>	<p style="text-align: center;">Član 53 Prava na dozvolu za boravak lica koja su Źrtve trgovine ljudima</p> <p>1. Stranac kome je izdata dozvola za privremeni boravak iz člana 51. ovog zakona, ima pravo na bezbedan smeštaj, zdravstvenu zaštitu, novčanu pomoć za pokrivanje osnovnih životnih potreba kada je to moguće, obrazovanje i rad u skladu sa relevantnim važećim zakonodavstvom.</p> <p>2. Posebna pažnja se posvećuje ranjivim grupama, kao što su trudne žene, maloletnici i osobe sa invaliditetom, Źrtve nasilja u porodici, manjine, starosedelačke grupe, LGBTIQ+ zajednica, kao i posebno ranjive grupe Źrtava.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 54 Shfuqizimi i lejeqëndrimit të përkohshëm për viktimat e trafikimit me njerëz</p> <p>1. Lejeqëndrimi i përkohshëm sipas nenit 51 të këtij ligji shfuqizohet në qoftë se:</p>	<p style="text-align: center;">Article 54 Revocation of the temporary residence permit for victims of human trafficking</p> <p>1. A temporary residence permit under Article 51 of this Law shall be revoked if:</p>	<p style="text-align: center;">Član 54 Prestanak važenja dozvole za privremeni boravak za Źrtve trgovine ljudima</p> <p>1. Dozvola za privremeni boravak iz člana 51. ovog zakona, prestaje da vaŹi ako:</p>

<p>1.1. mbajtësi i lejeqëndrimit ka ripërtrirë kontaktet vullnetarisht dhe me iniciativën e vet me personat e dyshuar që kanë kryer veprat e trafikimit me njerëz apo lehtësim të migrimit ilegal;</p> <p>1.2. vërtetohet se bashkëpunimi i të huajit me autoritetet kompetente është kryer nën mashtrim apo pretendimet e tij janë të pavërteta ose mashtruese;</p> <p>1.3. autoritetet kompetente e ndërpresin procedurën;</p> <p>1.4. viktimat ndërpret bashkëpunimin me autoritetet;</p> <p>1.5. atë e kërkojnë arsye për mbrojtjen e politikave publike dhe sigurisë shtetërore.</p> <p>2. Me rastin e marrjes së vendimit përfundimtar për lejeqëndrimin e përkohshëm të viktimës së mitur kërkohet mendimi i autoriteteve kompetente për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz, duke pasur parasysh interesin më të mirë të fëmijës.</p>	<p>1.1. the holder of the residence permit has voluntarily renewed contacts and on his or her own initiative with the persons suspected of having committed the offences of human trafficking or facilitation of illegal migration;</p> <p>1.2. it is proven that the foreigner's cooperation with the competent authorities was carried out under fraud or when his or her claims are false or fraudulent;</p> <p>1.3. the competent authorities terminate the procedure;</p> <p>1.4. the victim ceases cooperation with the authorities;</p> <p>1.5. it is required by the reasons for the protection of public policies and state security.</p> <p>2. When making the final decision on the temporary residence permit of a minor victim, the opinion of the competent authorities for the prevention and combating of human trafficking shall be required, taking into account the best interest of the child.</p>	<p>1.1. je nosilac dozvole za boravak dobrovoljno i na svoju inicijativu obnovio kontakte sa osumnjičenim licima za izvršenje dela trgovine ljudima ili olakšavanja ilegalne migracije;</p> <p>1.2. se dokaže da je saradnja stranca sa nadležnim organima izvršena na prevaru ili kada su njegove tvrdnje neistinite ili obmanjujuće;</p> <p>1.3. nadležni organi prekinu postupak;</p> <p>1.4. žrtva prekine saradnju sa organima;</p> <p>1.5. to nalažu razlozi zbog zaštite javnih politika i nacionalne bezbednosti.</p> <p>2. Prilikom donošenja konačne odluke o dozvoli za privremeni boravak maloletne žrtve tražiće se mišljenje nadležnih organa za sprečavanje i suzbijanje trgovine ljudima vodeći računa o najboljem interesu deteta.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 55 Përcaktimi i statusit të pashtetësisë</p>	<p style="text-align: center;">Article 55 Determination of statelessness status</p>	<p style="text-align: center;">Član 55 Utvrđivanje statusa lica bez državljanstva</p>
<ol style="list-style-type: none"> 1. Njohja e statusit të pashtetësisë bëhet nga MPB. 2. Personi me status të pashtetësisë pajiset me lejeqëndrim të përkohshëm nëse ai synon të vazhdojë qëndrimin e tij në Republikën e Kosovës. 3. Personi të cilit i është njohur statusi i personit pa shtetësi gëzon të gjitha të drejtat e përcaktuara në Konventën e vitit 1954 në lidhje me Statusin e Personave Pashtetësi. 4. Procedura për aplikimin, kriteret, vlerësimin, miratimin dhe refuzimin e kërkesës për njohjen e statusit të pashtetësisë dhe pajisjen me lejeqëndrim, për personin pa shtetësi përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Ministri i MPB-së. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Recognition of statelessness status shall be made by MIA. 2. A person with stateless status shall be provided with a temporary residence permit if he or she intends to continue his or her stay in the Republic of Kosovo. 3. A person who has been recognized as a stateless person shall enjoy all the rights defined under the 1954 Convention relating to the Status of Stateless Persons. 4. The procedure for the application, criteria, assessment, approval and rejection of the application for the recognition of statelessness status and the provision of a residence permit of the stateless person, shall be defined by a bylaw adopted by the Minister of MIA. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Priznavanje statusa lica bez državljanstva vrši MUP. 2. Licu sa statusom bez državljanstva biće izdata dozvola za privremeni boravak ako on namerava da produži svoj boravak u Republici Kosovo. 3. Lice kojem je priznat status lica bez državljanstva uživa sva prava utvrđena Konvencijom iz 1954. godine o statusu lica bez državljanstva. 4. Postupak podnošenja zahteva, kriterijume, ocenjivanje, odobravanje i odbijanje zahteva za priznavanje statusa lica bez državljanstva i izdavanje dozvole za boravak lica bez državljanstva, utvrđuju se podzakonskim aktom koji donosi ministar MUP-a.

<p style="text-align: center;">Nënkapitulli 5 Refuzimi, anulimi dhe shfuqizimi i lejeqëndrimit të përkohshëm</p> <p style="text-align: center;">Neni 56 Refuzimi, anulimi dhe shfuqizimi i lejeqëndrimit të përkohshëm</p> <p>1. Kërkesa për lejeqëndrim të përkohshëm ose vazhdimin e lejeqëndrimit të përkohshëm refuzohet kur:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. kriteret për dhënien ose vazhdimin e lejeqëndrimit të përkohshëm nuk janë plotësuar;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. dokumentet e paraqitura janë siguruar me mashtrim, ose janë të falsifikuara.</p> <p>2. Lejeqëndrimi i përkohshëm i anulohet të huajit nëse vërtetohet se dokumentet e paraqitura nga i huaji janë siguruar me mashtrim, ose janë falsifikuar.</p> <p>3. Lejeqëndrimi i përkohshëm i shfuqizohet të huajit nëse:</p>	<p style="text-align: center;">Subchapter 5 Refusal, annulment and revocation of the temporary residence permit</p> <p style="text-align: center;">Article 56 Refusal, annulment and revocation of the temporary residence permit</p> <p>1. An application for a temporary residence permit or extension of a temporary residence permit shall be refused when:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. the criteria for granting or extending a temporary residence permit have not been met;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. the documents presented are obtained fraudulently or are falsified.</p> <p>2. The foreigner's temporary residence permit shall be annulled if it is proven that the documents presented by the foreigner were obtained fraudulently, or were falsified.</p> <p>3. The foreigner's temporary residence permit shall be revoked if:</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje 5 Odbijanje, poništavanje i oduzimanje dozvole za privremeni boravak</p> <p style="text-align: center;">Član 56. Odbijanje, poništavanje i oduzimanje dozvole za privremeni boravak</p> <p>1. Zahtev za izdavanje dozvole za privremeni boravak ili produženje dozvole za privremeni boravak se odbija kada:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. nisu ispunjeni kriterijumi za izdavanje ili produženje dozvole za privremeni boravak;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. su priloženi dokumenti pribavljeni na prevaru, ili su falsifikovani.</p> <p>2. Strancu se poništava dozvola za privremeni boravak ako se dokaže da su dokumenti koje je stranac dostavio pribavljeni na prevaru ili su falsifikovani.</p> <p>3. Strancu se oduzima dozvola za privremeni boravak ako:</p>
--	--	--

<p>3.1 pushojnë kriteret për dhënie e lejeqëndrimit të përkohshëm sipas nenit 33 të këtij ligji;</p> <p>3.2 qëndron jashtë territorit të Republikës së Kosovës për më shumë se tridhjetë (30) ditë pandërprerë pa ndonjë arsye objektive;</p> <p>3.3 qëndrimi i tij në Republikën e Kosovës është në kundërshtim me qëllimin e lejeqëndrimit të përkohshëm;</p> <p>3.4 qëndrimi i tij është në kundërshtim me sigurinë shtetërore.</p> <p>4. Kundër vendimit sipas paragrafëve 1, 2 dhe 3 të këtij neni mund të parashtrahet ankesë në Komisionin e Ankesave për të Huajt, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të vendimit.</p> <p>5. Përjashtimisht nga paragrafi 3, nënparagrafi 3.2 i këtij neni, të huajt që qëndron jashtë Republikës së Kosovës për më shumë se tridhjetë (30) ditë pandërprerë për shkaqe të arsyeshme, lejeqëndrimi i përkohshëm nuk i</p>	<p>3.1. the criteria for granting a temporary residence permit under Article 33 of this Law cease to apply;</p> <p>3.2. he or she stays outside the territory of the Republic of Kosovo for more than thirty (30) continuous days without any objective reason;</p> <p>3.3. his or her stay in the Republic of Kosovo is contrary to the purpose of the temporary residence permit;</p> <p>3.4. his or her stay is contrary to state security.</p> <p>4. The decision according to paragraphs 1, 2 and 3 of this Article may be appealed before the Foreigners' Appeals Commission within thirty (30) days from the date of the receipt of the decision.</p> <p>5. In derogation from paragraph 3, subparagraph 3.2 of this Article, the temporary residence permit of a foreigner who stays outside the Republic of Kosovo for more than thirty (30) continuous days for justified reasons shall not be revoked</p>	<p>3.1. prestaju da važe kriterijumi za izdavanje dozvole za privremeni boravak u skladu sa članom 33. ovog zakona;</p> <p>3.2. boravi van teritorije Republike Kosovo neprekidno duže od trideset (30) dana bez nekog objektivnog razloga;</p> <p>3.3. njegov boravak u Republici Kosovo je u suprotnosti sa ciljem dozvole za privremeni boravak;</p> <p>3.4. njegov boravak je u suprotnosti sa nacionalnom bezbednošću.</p> <p>4. Na odluku iz stava 1, 2. i 3. ovog člana može se podneti žalba Žalbenoj komisiji za strance, u roku od trideset (30) dana od dana prijema odluke.</p> <p>5. Izuzetno od stava 3. tačka 3.2. ovog člana, strancu koji boravi van Republike Kosovo neprekidno duže od trideset (30) dana iz opravdanih razloga, neće se oduzeti dozvola za privremeni boravak samo ako se MUP upozna sa ovim razlozima.</p>
---	--	---

<p>shfuqizohet vetëm nëse këto shkaqe i janë njoftuar MPB-së.</p> <p style="text-align: center;">Neni 57 Refuzimi apo shfuqizimi i lejeqëndrimit për rrethanat e sigurisë shtetërore</p> <p>1. Kontrollat e sigurisë për të huajt për qëllim të përcaktimit të arsyeve që lidhen me sigurinë shtetërore kryhen nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë.</p> <p>2. Në raste të refuzimit apo shfuqizimit të lejeqëndrimit të të huajit për arsye që ndërlidhen me sigurinë shtetërore, lëshohet vendim pa arsyetim lidhur me rrethanat për të cilat është nxjerrë ky vendim.</p> <p>3. I huaji nga paragrafi 1 i këtij neni ka të drejtë të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit.</p> <p>4. I huaji nga paragrafi 1 i këtij neni që ka status të mbrojtjes ndërkombëtare trajtohet sipas procedurave të përcaktuara në ligjin përkatës për azil.</p>	<p>provided such reasons have been notified to the Ministry of MIA.</p> <p style="text-align: center;">Article 57 Refusal or annulment of the residence permit due to state security circumstances</p> <p>1. Security clearance for foreigners in order to determine reasons related to state security shall be carried out by the Kosovo Intelligence Agency.</p> <p>2. In cases of refusal or annulment of the foreigner's residence permit for reasons related to state security, a decision shall be issued without justification regarding the circumstances for which such decision was issued.</p> <p>3. The foreigner subject to paragraph 1 of this Article may initiate an administrative conflict before the competent court. The initiation of the administrative conflict shall not stay the execution of the decision.</p> <p>4. The foreigner subject of paragraph 1 of this Article who has the status of international protection shall be treated according to the procedures defined in the relevant Law on Asylum.</p>	<p style="text-align: center;">Član 57 Odbijanje ili oduzimanje dozvole za privremeni boravak zbog okolnosti nacionalne bezbednosti</p> <p>1. Bezbednosne kontrole za strance radi utvrđivanja razloga koji se odnose na nacionalnu bezbednost vrši Obaveštajna agencija Kosova.</p> <p>2. U slučajevima odbijanja ili oduzimanja dozvole za boravak strancu iz razloga koji se odnose na nacionalnu bezbednost, odluka se donosi bez obrazloženja o okolnostima zbog kojih je ova odluka doneta.</p> <p>3. Stranac iz stava 1. ovog člana, ima pravo da pokrene upravni spor pred nadležnim sudom. Pokretanje upravnog spora ne odlaže izvršenje odluke.</p> <p>4. Sa strancem iz stava 1. ovog člana koji ima status međunarodne zaštite, postupaće se u skladu sa procedurama utvrđenim relevantnim Zakonom o azilu.</p>
---	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 58 Refuzimi dhe shfuqizimi i lejeqëndrimit për ribashkim familjar</p>	<p style="text-align: center;">Article 58 Refusal and annulment of residence permit for family reunification</p>	<p style="text-align: center;">Član 58 Odbijanje i oduzimanje dozvole za boravak po osnovu spajanje porodice</p>
<p>1. MPB mund të refuzojë një kërkesë për pajisje apo vazhdim të lejeqëndrimit për qëllim të ribashkimit familjar, apo të shfuqizojë lejeqëndrimin e lëshuar për anëtarin e familjes në rrethanat si në vijim:</p> <p>1.1. kur kriteret e përcaktuara me këtë ligj nuk janë plotësuar apo nuk plotësohen më. Në rastin e vazhimit të lejeqëndrimit, kur sponsori nuk ka mjete të mjaftueshme pa pasur qasje në sistemin e asistencës sociale të Republikës së Kosovës, merren parasysh kontributet e anëtareve të familjes në ekonominë familjare;</p> <p>1.2. kur sponsori dhe anëtari i familjes se tij nuk jeton, apo nuk jeton më, në një marrëdhënie të vërtetë martesore apo familjare;</p> <p>1.3. kur gjendet se sponsori apo partneri i pamartuar është i martuar, apo është në një marrëdhënie të</p>	<p>1. MIA may reject an application for obtaining or extending a residence permit for the purpose of family reunification, or revoke the residence permit issued to a family member, in the following circumstances:</p> <p>1.1. when the criteria defined by this Law have not been met or are no longer met. In the case of extending the residence permit, when the sponsor does not have sufficient funds without having access to the social assistance system of the Republic of Kosovo, the contributions of family members to the household are taken into account;</p> <p>1.2. when the sponsor and his or her family member do not live, or no longer live in a real marital or family relationship;</p> <p>1.3. when the sponsor or unmarried partner is found to be married or in a stable long-term relationship with another person.</p>	<p>1. MUP može odbiti zahtev za izdavanje ili produženje dozvole za boravak po osnovu spajanja porodice, ili može oduzeti izdatu dozvolu za boravak članu porodice, u sledećim okolnostima:</p> <p>1.1. kada nisu ispunjeni ili više nisu ispunjeni kriterijumi utvrđeni ovim zakonom. Prilikom produženja dozvole za boravak, kada sponsor nema dovoljno sredstava bez pristupa sistemu socijalne pomoći Republike Kosovo, uzeće se u obzir doprinosi članova porodice domaćinstvu;</p> <p>1.2. kada sponsor i član njegove porodice ne žive, ili više ne žive u stvarnoj bračnoj ili porodičnoj vezi;</p> <p>1.3. kada se utvrdi da je sponsor ili vanbračni partner u braku ili u stabilnoj dugoj vezi sa drugim licem.</p>

<p>qëndrueshme afatgjatë me një person tjetër.</p> <p>2. MPB gjithashtu mund të refuzojë një kërkesë për pajisje apo vazhdim të lejeqëndrimit për qëllim të ribashkimit familjar, apo të shfuqizojë lejeqëndrimin e anëtarit të familjes kur:</p> <p>2.1. janë përdorur informacione të falsifikuara apo mashtruese, dokumente të falsifikuara, është kryer mashtrim apo janë përdorur mjete të tjera të kundërligjshme;</p> <p>2.2. martesë, marrëdhënia jashtëmartesore apo adoptimi janë lidhur me qëllim të vetëm të mundësimit të personit të hyjë apo qëndrojë në territorin e Republikës së Kosovës. Kur e bën vlerësimin në lidhje me këtë çështje, MPB-ja mund të marrë parasysh në veçanti faktin se martesë, bashkësia jashtëmartesore apo adoptimi janë lidhur pas lëshimit të lejeqëndrimit për sponsorin.</p> <p>3. MPB mund të shfuqizojë apo refuzojë të vazhdojë lejeqëndrimin për anëtarin e familjes kur lejeqëndrimi i sponsorit skadon dhe anëtari i familjes</p>	<p>2. MIA may also reject an application for obtaining or extending the residence permit for the purpose of family reunification or revoke the residence permit of the family member, when:</p> <p>2.1. falsified or misleading information or falsified documents were used, fraud was committed or other illegal means were used;</p> <p>2.2. marriage, extramarital relationship or adoption are entered into with the sole purpose of enabling the person to enter or stay in the territory of the Republic of Kosovo. When making the assessment regarding this matter, MIA may take into account in particular the fact that the marriage, extramarital union or adoption was concluded after the issuance of the residence permit to the sponsor.</p> <p>3. MIA may revoke or refuse to extend the residence permit for a family member when the sponsor's residence permit expires and the family member has not</p>	<p>2. MUP takođe može odbiti zahtev za izdavanje ili produženje dozvole za boravak po osnovu spajanja porodice, ili da oduzme dozvolu za boravak članu porodice, kada:</p> <p>2.1. su korišćene falsifikovane ili lažne informacije, falsifikovani dokumenti, izvršena je prevara ili su korišćena druga nezakonita sredstva;</p> <p>2.2. brak, vanbračna veza ili usvojenje je zaključeno sa isključivom svrhom da se licu omogućava ulazak ili boravak na teritoriji Republike Kosovo. Prilikom procene u vezi sa ovim pitanjem, MUP može posebno da uzme u obzir činjenicu da je brak, vanbračna zajednica ili usvojenje zaključeno nakon izdavanja dozvole za boravak sponzoru.</p> <p>3. MUP može oduzeti ili odbiti produženje dozvole za boravak članu porodice kada ističe dozvola za boravak</p>
--	--	---

<p>nuk është pajisur me lejeqëndrim autonom.</p> <p>4. MPB mund të inicojë kërkesë në organet kompetente për kontroll specifik dhe inspektim kur ka arsye për të dyshuar se ka mashtrim, apo kur martesë, marrëdhënia jashtëmartesore apo adoptimi është lidhur për interes. Kontrolli specifik mund të ndërmerret edhe në rast të vazhdimit të lejeqëndrimit të anëtarëve të familjes.</p> <p style="text-align: center;">Neni 59 Personat e padëshiruar</p> <p>1. Ministri i MPB-së, për interesa të rëndësishme të shtetit, të rendit kushtetues dhe atij juridik, të sigurisë shtetërore e të rendit publik, me vendim të arsyetuar shpall person të padëshiruar një të huaj nëse:</p> <p>1.1. vepron ose propagandon kundër sovranitetit të Republikës së Kosovës, sigurisë shtetërore, rendit kushtetues dhe rendit e sigurisë publike;</p> <p>1.2. është anëtar ose përkrah organizatën terroriste, ose kryen veprime kundër shtetit;</p>	<p>been provided with an autonomous residence permit.</p> <p>4. MIA may initiate a request to the competent authorities for specific control and inspection when there is reason to suspect fraud, or when marriage, extramarital relationship or adoption is entered into for interest. The specific control may be undertaken even in case of continuation of the residence permit of the family members.</p> <p style="text-align: center;">Article 59 Unwanted persons</p> <p>1. The Minister of MIA shall, for important state interests, of the constitutional and legal order, of state security and public order, by a reasoned decision, declare a foreigner an unwanted person if:</p> <p>1.1. he or she acts or propagates against the sovereignty of the Republic of Kosovo, state security, constitutional order and public security order;</p> <p>1.2. is a member of or support a terrorist organization or commits actions against the state;</p>	<p>sponzora i članu porodice nije izdata dozvola za samostalni boravak.</p> <p>4. MUP može da podnese zahtev nadležnim organima za posebne kontrole i inspekcijske nadzore kada postoji osnovana sumnja da postoji prevara, odnosno da je brak, vanbračna veza ili usvojenje zaključeno radi interesa. Posebne kontrole se takođe mogu preduzeti i u slučaju produženja dozvole za boravak članova porodice.</p> <p style="text-align: center;">Član 59 Nepoželjne osobe</p> <p>1. Ministar MUP-a, za važne državne interese, ustavnog i pravnog poretka, nacionalne bezbednosti i javnog reda, obrazloženim rešenjem proglašava stranca nepoželjnom osobom ako:</p> <p>1.1. deluje ili propagira protiv suvereniteta Republike Kosovo, nacionalne bezbednosti, ustavnog poretka i javnog reda i bezbednosti;</p> <p>1.2. je član ili podržava terorističkih organizacija, ili vrši radnje protiv države;</p>
--	---	---

<p>1.3. përbën kërcënim për vendin, ose cenon marrëdhëniet e Republikës së Kosovës me shtete të tjera;</p> <p>1.4. ekzistojnë dyshime se do të hyjë ose do të qëndrojë në territorin e Republikës së Kosovës për të kryer një veprë penale apo veprime që përbëjnë kërcënim për Republikën e Kosovës;</p> <p>1.5. është i përfshirë në krim të organizuar, në trafikim të qenieve njerëzore, trafikim me substanca narkotike, si dhe në çdo trafikim tjetër, bazuar në të dhënat e institucioneve përgjegjëse të sigurisë.</p> <p>2. I huaji shpallet “person i padëshiruar” për një periudhë jo më pak se pesë (5) vjet nga data e shpalljes dhe i refuzohet hyrja dhe qëndrimi gjatë kësaj periudhe. Të huajit i anulohet lejeqëndrimi në Republikën e Kosovës, si dhe largohet nga territori i Republikës së Kosovës.</p>	<p>1.3. constitutes a threat to the country or violates the relations of the Republic of Kosovo with other countries;</p> <p>1.4. there are suspicions that he or she shall enter or stay in the territory of the Republic of Kosovo to commit a criminal offence or actions that constitute a threat to the Republic of Kosovo;</p> <p>1.5. is involved in organized crime, trafficking in human beings, trafficking in narcotic substances as well as any other trafficking, according to data from the responsible security institutions.</p> <p>2. A foreigner shall be declared an “unwanted person” for a period of not less than five (5) years from the date of the declaration and shall be denied entry and residence during this period. His or her residence permit in the Republic of Kosovo shall be annulled and he or she shall leave the territory of the Republic of Kosovo.</p>	<p>1.3. predstavlja pretnju po zemlju, ili ugrožava odnose Republike Kosovo sa drugim zemljama;</p> <p>1.4. postoji sumnja da će ulaziti ili boraviti na teritoriji Republike Kosovo, da izvrši krivično delo ili radnje, koje predstavljaju pretnju po Republiku Kosovo;</p> <p>1.5. uključen je u organizovani kriminal, trgovinu ljudima, trgovinu opojnim supstancama kao i bilo koju drugu trgovinu, prema podacima dobijenim od nadležnih bezbednosnih institucija.</p> <p>2. Stranac se proglašava „nepoželjnom osobom“ na period od najmanje pet (5) godina od dana proglašenja i odbija mu se ulazak i boravak tokom tog perioda. Strancu mu se poništava dozvola za boravak u Republici Kosovo, i udaljava se sa teritorije Republike Kosovo.</p>
--	--	---

<p>3. Procedurat dhe rregullat për zbatimin e këtij neni rregullohen me akt nënligjor të miratuar nga Ministri i MPB-së.</p> <p style="text-align: center;">Nënkapitulli 6 Lejeqëndrimi për qëllim pune</p> <p style="text-align: center;">Neni 60 Lejeqëndrimi i të huajve për qëllim punësimi në Republikën e Kosovës</p> <p>1. I huaji në Republikën e Kosovës mund të punojë në bazë të lejeqëndrimit për punë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, me marrëveshje ndërkombëtare, apo me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Lejeqëndrimi për punë lëshohet në bazë të miratimit nga APRK brenda kuotës vjetore ose jashtë saj.</p> <p>3. Përjashtohen nga miratimi i APRK-së për pajisje me lejeqëndrim për qëllim punësimi, të huajt:</p>	<p>3. The procedures and rules for the implementation of this Article shall be regulated by a bylaw adopted by the Minister of MIA.</p> <p style="text-align: center;">Subchapter 6 Residence permit for employment purposes</p> <p style="text-align: center;">Article 60 Residence permit of foreigners for employment purposes in the Republic of Kosovo</p> <p>1. A foreigner may work in the Republic of Kosovo based on a work residence permit, unless otherwise provided for by this Law, by international agreement or by decision of the Government of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. The work permit shall be issued based on approval by the EARK within the annual quota or outside of it.</p> <p>3. The EARK's approval for obtaining a residence permit for the purpose of employment shall not apply to these categories of foreigners:</p>	<p>3. Procedure i pravila za sprovođenje ovog člana utvrđuju se podzakonskim aktom koji donosi ministar MUP-a.</p> <p style="text-align: center;">Potpoglavlje 6 Dozvola za boravak po osnovu zapošljavanja</p> <p style="text-align: center;">Član 60 Dozvola za boravak stranca po osnovu zapošljavanja u Republici Kosovo</p> <p>1. Stranac u Republici Kosovo može raditi na osnovu dozvole za boravak po osnovu zapošljavanja, osim slučajeva kada nije drugačije određeno ovim zakonom, međunarodnim sporazumima ili odlukom Vlade Republike Kosovo.</p> <p>2. Dozvola za boravak po osnovu zapošljavanja se izdaje na osnovu odobrenja AZRK-a u okviru godišnje kvote ili van nje.</p> <p>3. Izuzimaju se od odobrenja AZRK-a za izdavanje dozvole za boravak po osnovu zapošljavanja, stranci:</p>
--	--	--

<p>3.1. në proces të vazhimit të lejeqëndrimit të përkohshëm, në rast se nuk ndryshon qëllimi;</p> <p>3.2. me lejeqëndrim të përhershëm;</p> <p>3.3. me status të refugjatit, apo mbrojtje të përkohshme ose plotësuese dhe me status të personave pa shtetësi;</p> <p>3.4. me lejeqëndrim të përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar;</p> <p>3.5. me lejeqëndrim të përkohshëm për arsye studimi;</p> <p>3.6. me lejeqëndrim të përkohshëm për arsye humanitare;</p> <p>3.7. me lejeqëndrim autonom;</p> <p>3.8. me lejeqëndrim të përkohshëm me qëllim të kërkimit shkencor.</p>	<p>3.1. in the process of extending the temporary residence permit, in case the purpose does not change;</p> <p>3.2. with a permanent residence permit;</p> <p>3.3. with refugee status, or temporary or complementary protection and with the status of stateless persons;</p> <p>3.4. with a temporary residence permit for the purpose of family reunification;</p> <p>3.5. with a temporary residence permit for study reasons;</p> <p>3.6. with a temporary residence permit for humanitarian reasons;</p> <p>3.7. with autonomous residence permit;</p> <p>3.8. with a temporary residence permit for the purpose of scientific research.</p>	<p>3.1. u procesu produženja dozvole za privremeni boravak, ako se ne menja cilj;</p> <p>3.2. sa dozvolom za stalni boravak;</p> <p>3.3. sa statusom izbeglice, ili privremenom ili dodatnom zaštitom i sa statusom lica bez državljanstva;</p> <p>3.4. sa dozvolom za privremeni boravak po osnovu spajanja porodice;</p> <p>3.5. sa dozvolom za privremeni boravak po osnovu studiranja;</p> <p>3.6. sa dozvolom za privremeni boravak iz humanitarnih razloga;</p> <p>3.7. sa dozvolom za samostalni boravak;</p> <p>3.8. sa dozvolom za privremeni boravak po osnovu naučnog istraživanja.</p>
---	---	--

<p>4. Punësimi në kuptim të këtij ligji nuk konsiderohet kryerja e veprimeve paraprake për themelimin dhe regjistrimin e shoqërisë ose qarkullimit tregtar.</p> <p>5. Punëdhënësi mund ta punësojë të huajin vetëm në ato punë, për të cilat i është dhënë lejeqëndrimi.</p> <p>6. Punëdhënësi nuk mund ta punësojë të huajin, i cili në mënyrë të paligjshme qëndron në Republikën e Kosovës.</p> <p>7. Kur punëdhënësi punëson një të huaj të kategorisë sipas paragrafit 3 të këtij neni, duhet të njoftojë MPB-në dhe APRK-në brenda tetë (8) ditëve nga fillimi i punës të të huajit.</p> <p>8. Dispozitat e këtij neni që kanë të bëjnë me punëdhënësin zbatohen përshtatshëmrisht edhe për nënkontraktorin.</p>	<p>4. Employment in the light of this Law shall not be considered the performance of preliminary actions for the establishment and registration of a company or commercial circulation.</p> <p>5. An employer may employ a foreigner only in those jobs for which the residence permit was issued.</p> <p>6. An employer may not employ a foreigner who stays illegally in the Republic of Kosovo.</p> <p>7. When an employer hires a foreigner in the category under paragraph 3 of this Article, he or she shall notify MIA and EARK within eight (8) days from the commencement of the foreigner's work.</p> <p>8. The provisions of this Article that relate to the employer shall also apply <i>mutatis mutandis</i> to the subcontractor.</p>	<p>4. Zapošljavanje, u smislu ovog zakona, ne smatra se kao obavljanje preliminarnih radnji za osnivanje i registraciju društva ili prometa poslovanja.</p> <p>5. Poslodavac može da zaposli stranca samo na poslove, za koji mu je izdata dozvola za boravak.</p> <p>6. Poslodavac ne može da zaposli stranca koji boravi nezakonito u Republici Kosovo.</p> <p>7. Kada poslodavac zaposli stranca iz kategorije prema stavu 3. ovog člana, treba da obavesti MUP i AZRK u roku od osam (8) dana od početka rada stranca.</p> <p>8. Odredbe ovog člana koje se odnose na poslodavca primenjuju se shodno i na podizvođača.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 61 Leje pune afatshkurtër për të huaj</p> <p>1. Në bazë të lejes së punës afatshkurtër i huaji mund të punojë deri në nëntëdhjetë (90) ditë brenda çdo</p>	<p style="text-align: center;">Article 61 Short-term work permit for foreigners</p> <p>1. A foreigner may work in the following cases based on a short-term work permit for up to ninety (90) days within each</p>	<p style="text-align: center;">Član 61 Kratkotrajna radna dozvola za strance</p> <p>1. Na osnovu kratkotrajne radne dozvole, do devedeset (90) dana u bilo kojem periodu od sto osamdeset (180) dana,</p>

<p>periudhe prej njëqindetëdhjetë (180) ditëve, në rastet si në vijim:</p> <p>1.1. përfaqësuesi tregtar, personeli kryesor dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës të shoqërisë tregtare, të cilët kryejnë punë për shoqërinë tregtare, por nuk janë në marrëdhënie pune;</p> <p>1.2. ofruesit e shërbimeve në turizëm, përfaqësuesit turistikë, animatorët, në pajtim me legjislacionin në fuqi;</p> <p>1.3. shkencëtarët në aftësimin shkencor dhe profesional, shkencëtarët përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, shkencëtarët që marrin pjesë në realizimin e projekteve shkencore të rëndësishme për Republikën e Kosovës;</p> <p>1.4. personeli udhëheqës, ekspertët, mësimdhënësit dhe ligjëruesit e institucioneve të jashtme kulturore, arsimore dhe shkencore që në Republikën e Kosovës kryejnë punë në kuadër të programeve të bashkëpunimit kulturor dhe arsimor, si dhe personeli udhëheqës,</p>	<p>period of one hundred and eighty (180) days:</p> <p>1.1. the commercial representative, key personnel and members of the supervisory board of the business organization company, who perform work for the business organization, but are not in employment;</p> <p>1.2. service providers in tourism, tourist representatives, and animators in accordance with the applicable legislation;</p> <p>1.3. scientists in scientific and professional training, scientists representing international organizations, scientists who participate in the implementation of scientific projects important for the Republic of Kosovo;</p> <p>1.4. leading personnel, experts, teachers and lecturers of external cultural, educational and scientific institutions that in the Republic of Kosovo carry out work in the course of cultural and educational cooperation programs, as well as leading personnel, experts, teachers and</p>	<p>stranac može raditi u sledećim slučajevima:</p> <p>1.1. trgovinski zastupnik, rukovodeće osoblje i članovi nadzornog odbora privrednog društva, koji obavljaju poslove za privredno društvo, ali nisu u radnom odnosu;</p> <p>1.2. pružaoci usluga u turizmu, turistički predstavnici, odnosno animatori u skladu važećim zakonodavstvom;</p> <p>1.3. naučnici na naučnom i stručnom usavršavanju, naučnici predstavnici međunarodnih organizacija, naučnici koji učestvuju u realizaciji naučnih projekata od značaja za Republiku Kosovo;</p> <p>1.4. rukovodeće osoblje, stručnjaci, nastavnici i predavači stranih kulturnih, obrazovnih i naučnih institucija koje u Republici Kosovo obavljaju poslove u okviru programa kulturne i obrazovne saradnje, kao i rukovodeće osoblje, stručnjaci, nastavnici i predavači stranih</p>
---	--	---

<p>ekspertët, mësimdhënësit dhe ligjëruesit e institucioneve të jashtme kulturore, arsimore dhe shkencore, të cilët në Republikën e Kosovës kanë shoqatat e veta, nëse vijnë nga institucioni amë;</p> <p>1.5. zyrtarët civilë dhe ushtarakë të qeverive të shteteve të tjera, të cilët në Republikën e Kosovës vijnë të punojnë në bazë të kontratës apo marrëveshjes së bashkëpunimit me Qeverinë e Republikës së Kosovës;</p> <p>1.6. korrespondentët e jashtëm të akredituar në Republikën e Kosovës, ose reporterët e mediave të huaja;</p> <p>1.7. përfaqësuesit dhe personeli i bashkësive fetare, të cilët kryejnë punë të lidhura ekskluzivisht me shërbimin fetar;</p> <p>1.8. studentët, të cilët në institucionet e Republikës së Kosovës vijnë për punë vullnetare në kampet punuese ose në programet arsimore dhe të punës, apo në misionet diplomatike dhe konsullore, të akredituara në Republikën e Kosovës;</p>	<p>lecturers of external cultural, educational and scientific institutions, which in the Republic of Kosovo have their own associations, if they come from the parent institution;</p> <p>1.5. civil and military officers of the governments of other countries, who come to the Republic of Kosovo to work on the basis of a contract or cooperation agreement with the Government of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.6. external correspondents accredited in the Republic of Kosovo or foreign media reporters;</p> <p>1.7. representatives and personnel of religious communities, who perform work exclusively related to religious service;</p> <p>1.8. students who come to the institutions of the Republic of Kosovo for voluntary work in labour camps in educational and work programs, or in diplomatic and consular missions, accredited in the Republic of Kosovo;</p>	<p>kulturarnih, obrazovnih i naučnih institucija, koje u Republici Kosovo imaju svoja udruženja, ako dolaze iz matične institucije;</p> <p>1.5. civilni i vojni službenici vlada drugih zemalja, koji dolaze u Republiku Kosovo da rade na osnovu ugovora ili sporazuma o saradnji sa Vladom Republike Kosovo;</p> <p>1.6. strani dopisnici koji su akreditovani u Republici Kosovo ili izveštači stranih medija;</p> <p>1.7. predstavnici i osoblje verskih zajednica, koji obavljaju poslove koji se odnose isključivo na versku službu;</p> <p>1.8. studenti koji dolaze u institucije Republike Kosovo radi dobrovoljnog rada u radnim kampovima ili obrazovnim i radnim programima, ili u diplomatskim i konzularnim predstavništvima, akreditovanim u Republici Kosovo;</p>
---	--	---

<p>1.9. vullnetarët, të cilët punojnë në institucionet jo fitimprurëse në Republikën e Kosovës në pajtim me legjislacionin në fuqi, respektivisht në bazë të programeve të shkëmbimit dhe bashkëpunimit vullnetar;</p> <p>1.10. shtetasit e huaj, të cilët në Republikën e Kosovës vijnë të kryejnë praktikën në shoqëritë tregtare, shoqatat ose përfaqësitë e firmës tregtare të jashtme, nëse ata vijnë nga selia e asaj firme, respektivisht nga përfaqësia ose shoqata e saj në një shtet tjetër;</p> <p>1.11. të huajt që kryejnë punë të mbikëqyrjes dhe inspeksionit të riparimit dhe ndërtimit të anijeve, respektivisht të huajt që kryejnë punë të mbikëqyrjes ose inspektimit të prodhimit të pajisjeve montuese, të makinerisë dhe instrumenteve të tjera, në bazë të kontratës mbi eksportimin ose porosinë e porositësit të huaj;</p> <p>1.12. të huajt që kryejnë praktikën, aftësimin ose punën vullnetare në kuadër të programit të bashkëpunimit</p>	<p>1.9. volunteers who work in non-profit institutions in the Republic of Kosovo in accordance with applicable legislation, respectively on the basis of exchange and voluntary cooperation programs;</p> <p>1.10. foreign citizens who come to the Republic of Kosovo to perform internships in business organizations, associations or representative offices of foreign commercial firms, if they come from that firm's headquarters, respectively from its representative office or association in another country;</p> <p>1.11. foreigners who carry out the supervision and inspection of ship repair and construction, namely foreigners who carry out the supervision or inspection of the production of assembly equipment, machinery and other instruments, based on the export contract or the foreign client's order;</p> <p>1.12. foreigners who do internships, training or voluntary work under the cooperation program and other</p>	<p>1.9. volonteri, koji rade u neprofitnim institucijama u Republici Kosovo, u skladu sa važećim zakonodavstvom, odnosno na osnovu programa razmene i volonterske saradnje;</p> <p>1.10. strani državljani, koji u Republiku Kosovo dolaze radi obavljanja pripravničkog staža u privrednim društvima, udruženjima ili predstavništvima stranih privrednih društava, ako ti stranci dolaze iz sedišta tog društva, u odnosno iz njenog predstavništva ili udruženja u drugoj državi;</p> <p>1.11. stranci koji obavljaju poslove nadgledanja i inspekcijskog nadzora popravke i izgradnje brodova, odnosno stranci koji obavljaju poslove nadgledanja i inspekcijskog nadzora proizvodnje montažne opreme, mehanizacije i drugih instrumenata, na osnovu ugovora o izvozu ili isporuci stranog kupca;</p> <p>1.12. stranci koji pohađaju pripravnički staž, usavršavanje ili volonterski rad u okviru programa</p>
---	--	--

<p>dhe të programeve dhe iniciativave të tjera që i zbaton institucioni përgjegjës për arsim dhe shkencë;</p> <p>1.13. ekspertët në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, të letërsisë dhe arkivave;</p> <p>1.14. të huajt që kryejnë mësimin profesional, aftësimin dhe shkollimin e të punësuarve të personave fizikë dhe juridikë në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.15. të huajt që kryejnë punë të lidhura me porosi, montime ose servisim të makinave ose pajisjeve, kur puna e tyre është kusht për mbajtjen e garancisë, ose është e lidhur me porosinë e makinerisë ose pajisjeve;</p> <p>1.16. të huajt që aftësohen profesionalisht te personi juridik me seli në Republikën e Kosovës, i cili është i lidhur me punëdhënësin e jashtëm;</p> <p>1.17. nxënësit që vijnë në praktikë përmes organizatës së autorizuar ose përmes programit të shkëmbimit të nxënësve;</p>	<p>programs and initiatives, which are implemented by the institution responsible for education and science;</p> <p>1.13. experts in the area of protection of cultural heritage, literature and archives;</p> <p>1.14. foreigners who carry out vocational training, training and education of employees of natural and legal persons in the Republic of Kosovo;</p> <p>1.15. foreigners who perform work related to orders, assembly or servicing of machines or equipment when their work is a prerequisite for abiding by warranties or is related to the order of machinery or equipment;</p> <p>1.16. foreigners who are trained professionally at the legal entity with headquarters in the Republic of Kosovo, which is related to the foreign employer;</p> <p>1.17. students who come to do internships through the authorized organization or the student exchange program;</p>	<p>saradnje, i drugih programa i inicijativa, koje sprovodi nadležna ustanova za obrazovanje i nauku;</p> <p>1.13. stručnjaci u oblasti zaštite kulturnog nasleđa, književnosti i arhiva;</p> <p>1.14. stranci, koji pohađaju stručnu obuku, usavršavanje i obrazovanje zaposlenih kod fizičkih i pravnih lica u Republici Kosovo;</p> <p>1.15. stranci, koji obavljaju poslove koji se odnose na isporuke, montažu ili servisiranje mehanizacije ili opreme, kada je njihov rad uslov za zadržavanje garancije ili se odnosi na isporuku mehanizacije ili opreme;</p> <p>1.16. stranci, koji se stručno usavršavaju kod pravnog lica sa sedištem u Republici Kosovo, koje je povezano sa stranim poslodavcem;</p> <p>1.17. učenici koji dolaze na pripravnički staž preko ovlašćene organizacije ili putem programa razmene učenika;</p>
--	--	---

<p>1.18. mjekë ose specialistë të fushave të ndryshme mjekësore;</p> <p>1.19. mësime dhe ligjëruesit e institucioneve të jashtme kulturore, arsimore dhe shkencore;</p> <p>1.20. anëtarët e bordeve dhe drejtorët ekzekutivë të përfaqësive të huaja;</p> <p>1.21. të huajt që vijnë për të punuar në territorin e Republikës së Kosovës në gastronomi, bujqësi dhe ndërtim;</p> <p>1.22. ekspertë dhe profesionistë, të cilët vijnë në Republikën e Kosovës për të kryer punë në ndërmarrje të caktuara;</p> <p>1.23. të transferuarit brenda shoqërive tregtare/korporatave.</p> <p>2. Në bazë të lejes së punës afatshkurtër, deri në gjashtëdhjetë (60) ditë brenda çdo periudhe prej njëqindetëdhjetë (180) ditësh, mund të punojnë të huajt si vijon:</p>	<p>1.18. doctors or specialists in various medical areas;</p> <p>1.19. teachers and lecturers of external cultural, educational and scientific institutions;</p> <p>1.20. board members and executive directors of foreign representative offices;</p> <p>1.21. foreigners who come to work in the territory of the Republic of Kosovo in gastronomy, agriculture and construction;</p> <p>1.22. experts and professionals who come to the Republic of Kosovo to perform work in certain enterprises;</p> <p>1.23. transferees within business organizations/corporations.</p> <p>2. The following categories of foreigners may also work based on a short-term work permit up to sixty (60) days within each period of one hundred and eighty (180) days:</p>	<p>1.18. lekari ili specijalisti različitih medicinskih oblasti;</p> <p>1.19. nastavnici i predavači stranih kulturnih, obrazovanih i naučnih ustanova;</p> <p>1.20. članovi odbora i izvršni direktori stranih predstavništava;</p> <p>1.21. stranci koji dolaze da rade na teritoriji Republike Kosovo u ugostiteljstvu, poljoprivredi i građevini;</p> <p>1.22. stručnjaci i profesionalci koji dolaze u Republiku Kosovo za obavljanje poslova u određenim preduzećima.</p> <p>1.23. premeštani u okviru privrednih društava/korporacija.</p> <p>2. Na osnovu kratkotrajne radne dozvole, do šezdeset (60) dana u okviru bilo kog perioda od sto osamdeset (180) dana, mogu raditi stranci u sledećim slučajevima:</p>
---	--	--

<p>2.1. ofruesit e shërbimeve të konsulencës;</p> <p>2.2. ligjëruesit që marrin pjesë në tubimet dhe seminarët e organizuara profesionale;</p> <p>2.3. artistët dhe personeli teknik, për shfaqjet e operave, baletit, teatrit, koncerteve dhe shfaqjeve tjera kulturore, respektivisht autorët dhe ekzekutuesit në fushën e artit të filmit dhe televizionit;</p> <p>2.4. punëtorët në parqet e cirkut dhe ato zbavitëse;</p> <p>2.5. punëtorët sezonalë të pakualifikuar, angazhimi i të cilëve është jo më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë brenda çdo periudhe prej njëqindetëdhjetë (180) ditësh;</p> <p>2.6. performuesit dhe krijuesit në fushën e artit dhe kulturës, duke përfshirë edhe ekzekutuesit përcjellës si dhe personelin teknik;</p> <p>2.7. të angazhuarit në shfaqjet e panairit dhe ekspozitës, në të cilat ekspozon punëdhënësi i tyre.</p>	<p>2.1. providers of consulting services;</p> <p>2.2. lecturers who participate in organized professional meetings and seminars;</p> <p>2.3. artists and technical personnel, for performances of operas, ballet, theatre, concerts and other cultural performances, namely authors and performers in the area of film and television art;</p> <p>2.4. workers in circus and entertainment parks;</p> <p>2.5. unskilled seasonal workers, whose engagement is no longer than sixty (60) days within each period of one hundred and eighty (180) days;</p> <p>2.6. performers and creators in the area of art and culture, including accompanying performers and technical personnel;</p> <p>2.7. those engaged at fairs and exhibition shows in which their employer exhibits.</p>	<p>2.1. pružaoci savetodavnih usluga;</p> <p>2.2. predavači koji učestvuju na organizovanim stručnim skupovima i seminarima;</p> <p>2.3. umetnici i tehničko osoblje, za izvođenje opera, baleta, pozorišta, koncerata i drugih kulturnih predstava, odnosno autori i izvođači u oblasti filmske i televizijske umetnosti;</p> <p>2.4. radnici u cirkusima i zabavnim parkovima;</p> <p>2.5. nekvalifikovani sezonski radnici, čije angažovanje nije duže od šestdeset (60) dana u okviru bilo kog perioda od sto osamdeset (180) dana;</p> <p>2.6. izvođači i/ili stvaraoci u oblasti umetnosti i kulture, uključujući i prateće izvođače kao i tehničko osoblje;</p> <p>2.7. onima koji se bave na sajmovima i izložbama u kojima izlaže njihov poslodavac.</p>
--	--	---

<p>3. Kërkesa për leje pune afatshkurtër nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni bëhet në APRK, e cila lëshon leje pune afatshkurtër dhe menjëherë e njofton Administratën Tatimore të Kosovës, MPB-në dhe Policinë e Kosovës.</p> <p>4. Në bazë të lejes së punës afatshkurtër për të huajt, i huaji mund të punojë për të njëjtin punëdhënës ose marrësin e shërbimeve në tërë territorin e Republikës së Kosovës.</p> <p>5. Personi juridik ose fizik, i cili punëson ose i shfrytëzon shërbimet e shtetasit të huaj sipas këtij neni, duhet të ketë kontratë adekuate ose dëshmi tjetër për kryerjen e punëve me shtetasin e huaj ose punëdhënësin e jashtëm, i cili e dërgon shtetasin e huaj në punë në Republikën e Kosovës.</p> <p>6. Ndaj të huajve të cilët në Republikën e Kosovës paraqitën në shfaqjet dhe garat sportive si përfaqësues të ekipeve, klubeve të jashtme ose përfaqësuese shtetërore, nuk aplikohet paragrafi 3 dhe 5 i këtij neni.</p> <p>7. Lidhur me kërkesën për lëshimin e lejes së punës afatshkurtër për të huajt</p>	<p>3. The application for a short-term work permit from paragraphs 1 and 2 of this Article shall be submitted to EARK, which issues a short-term work permit and shall immediately notify the Kosovo Tax Administration, MIA and the Kosovo Police.</p> <p>4. Based on the short-term work permit for foreigners, a foreigner may work for the same employer or recipient of services throughout the territory of the Republic of Kosovo.</p> <p>5. A legal or natural person, who hires or uses the services of a foreign citizen under this Article, shall have adequate contract or other evidence for the performance of work with the foreign citizen or the foreign employer who sends the foreign citizen to work in the Republic of Kosovo.</p> <p>6. Paragraphs 3 and 5 of this Article shall not apply to foreigners who participate in sports events and competitions in the Republic of Kosovo, as representatives of teams, foreign clubs or state representations.</p> <p>7. Regarding the application for issuing a short-term work permit for foreigners,</p>	<p>3. Zahtev za kratkotrajnu radnu dozvolu iz stava 1. i 2. ovog člana podnosi se AZRK-u, koja izdaje kratkotrajnu radnu dozvolu i odmah obaveštava Poresku administraciju Kosova, MUP i Policiju Kosova.</p> <p>4. Na osnovu kratkotrajne radne dozvole za strance, stranac može raditi za istog poslodavca ili primaoca usluga, na celoj teritoriji Republike Kosovo.</p> <p>5. Pravno ili fizičko lice, koje zapošljava ili koristi usluge stranog državljanina u skladu sa ovim članom, treba da ima adekvatni ugovor ili drugi dokaz za obavljanje poslova sa stranim državljaninom ili stranim poslodavcem, koji stranog državljanina pošalje da radi u Republici Kosovo.</p> <p>6. Na strane državljanine koji su u Republici Kosovo nastupili na sportskim priredbama i takmičenjima, kao predstavnici timova, stranih klubova ili državnih reprezentacija, ne primenjuju se stavovi 3. i 5. ovog člana.</p> <p>7. O zahtevu za izdavanje kratkotrajne radne dozvole za strance odlučuje AZRK,</p>
---	---	--

<p>vendos APRK-ja, brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të kërkesës.</p> <p>8. Leja e punës afatshkurtër për të huajt i lëshohet shtetasit të huaj për kohën sa është e nevojshme për kryerjen e punëve, respektivisht për kohën për të cilin është lidhur kontrata e punës ose kontrata tjetër përkatëse, por jo më shumë se periudha sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni.</p> <p>9. Pavarësisht dispozitave të këtij neni, në rast se i huaji ka konsumuar ditët e lejuara të qëndrimit, leja e punës mund ti lëshohet vetëm për ditët e mbetura të qëndrimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 62 Kriteret për pajisje me leje pune afatshkurtër për të huajt</p> <p>1. I huaji për tu pajisur me leje pune afatshkurtër duhet të plotësojë kriteret si në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. të mos ketë tejkaluar periudhën e qëndrimit të rregullt afatshkurtër në territorin e Republikës së Kosovës;</p>	<p>EARK shall decide within seven (7) days after receiving the application.</p> <p>8. The short-term work permit for foreigners shall be issued to a foreigner for the time necessary for the performance of work, respectively for the time for which the employment contract or other relevant contract was concluded, but not longer than the period according to paragraphs 1 and 2 of this Article.</p> <p>9. Notwithstanding the provisions of this Article, in case a foreigner has consumed the allowed days of stay, the work permit may be issued only for the remaining days of stay.</p> <p style="text-align: center;">Article 62 Criteria for obtaining a short-term work permit for foreigners</p> <p>1. In order to obtain a short-term work permit, a foreigner shall meet the following criteria:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. have not exceeded the period of regular short-term stay in the territory of the Republic of Kosovo;</p>	<p>u roku od sedam (7) dana od prijema zahteva.</p> <p>8. Kratkotrajna radna dozvola za strance izdaje se stranom državljaninu na vreme koliko je potrebno za obavljanje poslova, odnosno na vreme na koje je zaključen ugovor o radu ili drugi relevantni ugovor, ali ne više od period iz stava 1. i 2. ovog člana.</p> <p>9. Bez obzira na odredbe ovog člana, u slučaju da je stranac potrošio dozvoljene dane boravka, radna dozvola biće mu izdata samo za preostale dane boravka.</p> <p style="text-align: center;">Član 62 Kriterijumi za izdavanje kratkotrajne radne dozvole za strance</p> <p>1. Za izdavanje kratkotrajne radne dozvole, stranac treba da ispunjava sledeće uslove:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Da nije prekoračio period redovnog kratkotrajnog boravka na teritoriji Republike Kosovo;</p>
---	---	---

<p>1.2. të ketë kontratë pune, përkatësisht vërtetim me shkrim për lidhjen e kontratës për punë ose dëshmi adekuate të punës, apo marrëveshje përkatëse;</p> <p>1.3. të ketë dëshmi mbi arsimimin, ose kualifikimin e fituar, apo aftësimin e të huajt në vendin e punës;</p> <p>1.4. të ketë dëshmi nga punëdhënësi mbi regjistrimin e shoqërisë tregtare, shoqatës, filialit, degës, përfaqësisë apo organizatës në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.5. për anëtarët e bordeve dhe drejtorin ekzekutiv, dëshmitë për zgjedhjen apo angazhimin e tyre në këtë rol në subjektin juridik në Republikën e Kosovës.</p> <p>2. I huaji i cili nuk i plotëson kriteret sipas paragrafit 1 të këtij neni i refuzohet kërkesa për leje pune afatshkurtër. Kundër vendimit të refuzimit mund të parashtrohet ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve në Komisionin e Ankesave për të Huajt.</p>	<p>1.2. have a work contract, namely a written confirmation of the conclusion of a work contract or adequate proof of work, or a relevant agreement;</p> <p>1.3. have proof of education or acquired qualification or on-the-job training;</p> <p>1.4. have evidence from the employer on the registration of the business organization, association, subsidiary, branch, representative office or organization in the Republic of Kosovo;</p> <p>1.5. for the members of the boards and the executive director, evidence of their election or engagement in this role in the legal entity in the Republic of Kosovo.</p> <p>2. A foreigner who does not meet the criteria under paragraph 1 of this Article shall have the application for a short-term work permit rejected. The refusal decision may be appealed within thirty (30) days before the Foreigners' Appeals Commission.</p>	<p>1.2. da ima ugovor o radu, odnosno pismenu potvrdu o zaključivanju ugovora o radu ili adekvatni dokaz o radu, ili relevantni ugovor;</p> <p>1.3. da ima dokaz o obrazovanju, ili stečenoj spremi ili usavršavanju stranca na radnom mestu;</p> <p>1.4. da ima dokaz od poslodavca o registraciji privrednog društva, udruženja, filijale, ogranaka, predstavništva ili organizacije u Republici Kosovo;</p> <p>1.5. za članove odbora i izvršnog direktora, dokaze za njihov izbor ili angažovanje u ovoj ulozi u pravnom licu u Republici Kosovo.</p> <p>2. Strancu koji ne ispunjava uslove iz stava 1. ovog člana, odbija se zahtev za izdavanje kratkotrajne radne dozvole. Na odluku o odbijanju može se podneti žalba Žalbenoj komisiji za strance, u roku od trideset (30) dana.</p>
---	--	--

<p>3. Procedurat e aplikimit për leje pune afatshkurtër, si dhe taksa administrative, përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Ministria përkatëse për punë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 63 Lejeqëndrimi për personat me kualifikim të lartë ‘Karta e Kaltër’</p> <p>1. MPB pajis të huajin me lejeqëndrim ‘Karta e Kaltër’ për punë me kualifikim të lartë, vetëm nëse ka marrë më parë miratimin e APRK-së për punonjës të kualifikuar dhe kur përmbushen kriteret për pajisjen me lejeqëndrim sipas nenit 33 të këtij Ligji.</p> <p>2. Përpos kriterëve të përgjithshme, duhet gjithashtu të plotësohen edhe kriteret e mëposhtme:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. i huaji posedon kontratë të vlefshme pune apo një ofertë detyruese pune për punësim të kualifikimit të lartë për të paktën gjashtë (6) muaj;</p>	<p>3. The application procedures for short-term work permits as well as the administrative tax shall be defined by a bylaw adopted by the relevant Ministry of Labour.</p> <p style="text-align: center;">Article 63 Residence permit for highly qualified persons ‘Blue Card’</p> <p>1. The Ministry of Internal Affairs shall provide the foreigner with a ‘Blue Card’ residence permit for highly qualified work, only if he or she has previously received the approval of EARK for qualified employees and when the criteria for providing a residence permit under Article 33 of this Law are met.</p> <p>2. In addition to the general criteria, the following criteria shall also be met:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. the foreigner holds a valid employment contract or a binding job offer for highly qualified employment for at least six (6) months;</p>	<p>3. Procedure podnošenje zahteva za kratkotrajnu radnu dozvolu, kao i administrativna taksa, utvrđuju se podzakonskim aktom koji donosi relevantno ministarstvo za rad.</p> <p style="text-align: center;">Član 63 Dozvola za boravak za osobe sa visokom stručnom spremom “Plava karta,,</p> <p>1. MUP izdaje strancu dozvolu za boravak „Plava karta“ za rad, sa visokom stručnom spremom, samo ako je prethodno dobio odobrenje AZRK-a za kvalifikovane radnike i kada ispunjava uslove za izdavanje dozvole za boravak iz člana 33. ovog zakona.</p> <p>2. Pored opštih kriterijuma, treba takođe da budu ispunjeni i sledeći kriterijumi:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. stranac ima važeći ugovor o radu ili obavezujuću ponudu za zaposlenje sa visokom stručnom spremom u trajanju od najmanje šest (6) meseci.</p>
--	---	--

<p>2.2. posedon dëshmitë e kualifikimit të lartë profesional në profesionin në të cilën është lidhur kontrata apo oferta e punës;</p> <p>2.3. përmes kontratës apo ofertës detyruese i huaji kompensohet në lartësinë e pagës mujore të përcaktuar me vendim të Ministrit të MPB-së, e cila duhet të jetë të paktën 1.5 herë më e lartë sesa paga mesatare në Republikën e Kosovës.</p> <p>3. Lejeqëndrimi për punë me kualifikim të lartë Karta e Kaltër lëshohet për një periudhë dy (2) vjeçare dhe mund të vazhdohet për një periudhë tre (3) vjeçare.</p> <p>4. I huaji i pajisur me Kartën e Kaltër duhet të njoftojë MPB-në për ndryshimet në marrëdhëniet e punës.</p>	<p>2.2. the foreigner possesses evidence of high professional qualification in the profession to which the contract or job offer is related;</p> <p>2.3. through the contract or binding offer, the foreigner is remunerated at the level of the monthly salary determined by the decision of the Minister of Internal Affairs, which shall be at least 1.5 times higher than the average salary in the Republic of Kosovo.</p> <p>3. A residence permit for highly qualified work, Blue Card, shall issued for a period of two (2) years and may be extended for a period of three (3) years.</p> <p>4. A foreigner with a Blue Card shall notify MIA of changes in employment relationships.</p>	<p>2.2. poseduje dokaze o visokoj stručnoj spremi u profesiji za koju je zaključen ugovor ili ponuda za posao.</p> <p>2.3. preko ugovora ili obavezujuće ponude, stranac dobija naknadu u visini mesečne zarade utvrđene odlukom ministra MUP-a, koja treba da bude najmanje 1.5 puta veća od prosečne zarade u Republici Kosovo.</p> <p>3. Dozvola za boravak po osnovu zapošljavanja sa visokom stručnom spremom Plava karta RKS, izdaje se na period od dve (2) godine i može se produžiti na period od tri (3) godine.</p> <p>4. Stranac, kome se izdaje Plava karta, treba da obavesti MUP o promenama u radnom odnosu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 64 Lejeqëndrimi për punësim sezonal</p> <p>1. Lejeqëndrimi për punësim sezonal i jepet të huajit në rast se plotëson kriteret për lejeqëndrimin e përkohshëm dhe pas miratimit të APRK-së.</p>	<p style="text-align: center;">Article 64 Residence permit for seasonal employment</p> <p>1. A residence permit for seasonal employment shall be issued to a foreigner if he or she meets the criteria for the</p>	<p style="text-align: center;">Član 64 Dozvola za boravak po osnovu sezonskog zapošljavanja</p> <p>1. Dozvola za boravak po osnovu sezonskog zapošljavanja izdaje se strancu ako ispunjava kriterijume za dozvolu za</p>

<p>2. Lejeqëndrimi si punëtor sezonal jepet me vlefshmëri deri në gjashtë (6) muaj për çdo vit kalendarik që lidhet me një punëdhënës, profesion dhe kontratë pune me afat kohor të përcaktuar.</p> <p>3. Në vitin pasardhës kalendarik, punëdhënësi mund të paraqesë kërkesë për lejeqëndrim si punëtor sezonal për të njëjtin të huaj, me kusht që të jetë përmbushur një ndërprerje e detyrueshme kohore prej gjashtë (6) muajsh.</p> <p>4. Pas përfundimit të kontratës së punës, i huaji duhet të rikthehet në vendin e tij të origjinës, me përjashtim të rasteve kur plotëson kriteret për t'u pajisur me lejeqëndrim të përkohshëm.</p> <p>5. Ky nen nuk zbatohet për shtetasit e vendeve të Bashkimit Evropian dhe zonës Shengen, si dhe për rastet kur zbatohet një regjim i posaçëm i përcaktuar me marrëveshje ndërkombëtare.</p>	<p>temporary residence permit and after the approval of EARK.</p> <p>2. A residence permit for a seasonal worker shall be valid for up to six (6) months, for each calendar year, which is related to an employer, profession and employment contract with a fixed time limit.</p> <p>3. In the following calendar year, the employer may submit an application for a residence permit as a seasonal worker for the same foreigner, provided that a mandatory time interval of six (6) months has been met.</p> <p>4. After the termination of the employment contract, a foreigner shall return to his or her country of origin, except in cases where he or she meets the criteria to be provided with a temporary residence permit.</p> <p>5. This Article shall not apply to citizens of European Union countries and the Schengen area, as well as to cases where a special regime provided for by international agreement applies.</p>	<p>privremeni boravak, i nakon odobrenja AZRK-a.</p> <p>2. Dozvola za boravak za sezonskog radnika izdaje se na rok važenja do šest (6) meseci, za svaku kalendarsku godinu, koja se odnosi na poslodavca, profesiju i ugovore o radu na određeno vreme.</p> <p>3. U narednoj kalendarskoj godini poslodavac može da podnese zahtev za dozvolu za boravak sezonskog radnika za istog stranca, pod uslovom da je ispunjen obavezan vremenski prekid od šest (6) meseci.</p> <p>4. Po isteku ugovora o radu, stranac treba da se vrati u svoju zemlju porekla, osim u slučajevima kada ispunjava kriterijume u skladu izdavanju dozvole za privremeni boravak.</p> <p>5. Ovaj član se ne primenjuje na državljane zemalja Evropske unije i Šengen zone, kao i na slučajeve na koje se primenjuje poseban režim, predviđen međunarodnim sporazumom.</p>
---	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 65 Lejeqëndrimi për të transferuarit brenda shoqërive tregtare</p>	<p style="text-align: center;">Article 65 Residence permit for transferees within business organizations</p>	<p style="text-align: center;">Član 65 Dozvola za boravak za premeštene unutar privrednih društava</p>
<p>1. Lejeqëndrimi për të transferuarit brenda shoqërive tregtare lëshohet për qëllim të transferimit të një të huaji brenda shoqërisë tregtare.</p> <p>2. Një transferim brenda shoqërisë tregtare është dërgimi i përkohshëm i një të huaji:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. te një njësi vendore që i përket shoqërisë tregtare në të cilën i huaji është i punësuar, nëse shoqëria ndodhet jashtë territorit të Republikës së Kosovës; ose</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. te një njësi vendore e një shoqërie tjetër të grupit të shoqërive të cilit i përket shoqëria e vendosur jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe nga i cili është punësuar i huaji.</p> <p>3. Një i huaj pajiset me lejeqëndrim sipas paragrafit 1 të këtij nenit nëse:</p>	<p>1. A residence permit for transferees within business organizations shall be issued for the purpose of transferring a foreigner within the business organization.</p> <p>2. An intra-company transfer shall be an interim deployment of a foreigner:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. to a local unit, belonging to the business organization in which the foreigner is employed, if the organisation is located outside the territory of the Republic of Kosovo; or</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. to a local unit of another organization of the group of organizations to which the organization located outside the territory of the Republic of Kosovo belongs and which has employed the foreigner.</p> <p>3. A foreigner shall be provided with a residence permit under paragraph 1 of this Article if:</p>	<p>1. Dozvola za boravak za premeštene unutar privrednog društva se izdaje radi premeštaja stranca unutar privrednog društva.</p> <p>2. Premeštaj unutar privrednog društva je privremeno slanje stranca:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. u domaćoj jedinici koja pripada privrednom društvu u kojoj je stranac zaposlen, ako se društvo nalazi van teritorije Republike Kosovo; ili</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. u domaćoj jedinici drugog društva iz grupe društava, koja pripada društvu koje se nalazi van teritorije Republike Kosovo i u kojoj je stranac zaposleno.</p> <p>3. Strancu se izdaje dozvola za boravak iz stava 1. ovog člana, ako:</p>

<p>3.1. i huaji do të punojë si menaxher ose specialist në njësinë pritëse;</p> <p>3.2. i huaji ka qenë i punësuar nga shoqëria ose grupi i shoqërive tregtare për të paktën gjashtë (6) muaj menjëherë para transferimit dhe punësohet pa ndërprerje nga shoqëria ose grupi i shoqërive tregtare gjatë periudhës së transferimit;</p> <p>3.3. transferimi brenda shoqërisë tregtare kalon periudhën nëntëdhjetë (90) ditore;</p> <p>3.4. i huaji siguron një kontratë pune të vlefshme për kohëzgjatjen e transferimit brenda shoqërisë tregtare, apo një ofertë detyruese ku përcaktohet:</p> <p>3.4.1. informacioni specifik në lidhje me vendin dhe llojin e punës, shpërblimin dhe kushtet e tjera të punësimit gjatë transferimit brenda shoqërisë tregtare;</p> <p>3.4.2. se i huaji do të kthehet në një njësi ekonomike</p>	<p>3.1. a foreigner will work as a manager or specialist in the host unit;</p> <p>3.2. a foreigner has been employed by the organization or group of business organizations for at least six (6) months immediately before the transfer and is employed without interruption by the organization or group of business organizations during the transfer period;</p> <p>3.3. the transfer within the business organization exceeds the ninety (90) day period;</p> <p>3.4. a foreigner provides a valid employment contract for the duration of the transfer within the business organization or a binding offer outlining:</p> <p>3.4.1. specific information about the place and type of work, remuneration and other conditions of employment during the transfer within the business organization;</p> <p>3.4.2. that the foreigner will return to an economic entity</p>	<p>3.1. će stranac raditi kao menadžer ili specijalista u jedinici domaćinu;</p> <p>3.2. je stranac bio zaposlen u društvu ili grupu privrednih društava najmanje šest (6) meseci neposredno pre premeštaja i biće zaposlen neprekidno u društvu ili grupu društava tokom perioda premeštaja;</p> <p>3.3. premeštaj unutar privrednog društva prekoračuje period od devedeset (90) dana;</p> <p>3.4. stranac priloži važeći ugovor o radu za vreme premeštaja unutar privrednog društva ili obavezujuću ponudu u kojoj je utvrđeno:</p> <p>3.4.1. posebne informacije o mestu i vrsti posla, zaradi i drugim uslovima zaposlenja prilikom premeštaja unutar privrednog društva;</p> <p>3.4.2. stranac će se vratiti u ekonomsku jedinicu koja</p>
--	--	---

<p>që i përket së njëjtës shoqëri ose grup shoqëriish tregtare të themeluara jashtë Republikës së Kosovës, pas përfundimit të transferimit brenda shoqërisë tregtare.</p> <p>3.5 i huaji siguron prova për kualifikimet e veta profesionale.</p> <p>4. Lejeqëndrimi për të transferuarit brenda shoqërive tregtare jepet:</p> <p>4.1. për kohëzgjatjen e transferimit, por jo më shumë se tre (3) vjet, për menaxherët dhe specialistët;</p> <p>4.2. për kohëzgjatjen e transferimit, por jo më shumë se një (1) vit, për punonjësit praktikantë.</p> <p>5. Lejeqëndrimi sipas kësaj kategorie nuk u jepet të huajve që janë duke përfunduar një program trajnimi si pjesë e studimeve të tyre.</p> <p>6. Për llogaritjen e periudhës së punës për të njëjtin vend pune, llogaritet gjithë periudha e kryer për atë vend pune nga</p>	<p>that belongs to the same organization or group of business organizations established outside the Republic of Kosovo, after the completion of the transfer within the business organizations.</p> <p>3.5. a foreigner provides proof of his or her professional qualifications.</p> <p>4. A residence permit for transferees within business organizations shall be issued:</p> <p>4.1. for the duration of the transfer, but not longer than three (3) years, for managers and specialists;</p> <p>4.2. for the duration of the transfer, but not longer than one (1) year, for intern employees.</p> <p>5. The residence permit under this category shall not be issued to foreigners who are completing a training program as part of their studies.</p> <p>6. For the calculation of the working period for the same workplace, the entire period performed for that workplace by</p>	<p>pripada istom privrednom društvu ili grupi privrednih društava osnovanih van Republike Kosovo, nakon završetka premeštaja unutar privrednog društva.</p> <p>3.5. stranac priloži dokaze o svojoj stručnoj spremi.</p> <p>4. Dozvola za boravak za premeštene unutar privrednih društava izdaje se:</p> <p>4.1. na vreme premeštaja, ali ne duže od tri (3) godine, za menadžere i specijaliste;</p> <p>4.2. na vreme premeštaja, ali ne duže od jedne (1) godine, za zaposlene pripravnike.</p> <p>5. Dozvola za boravak prema ovoj kategoriji se ne izdaje strancima koji završavaju program obuke u okviru njihovog studiranja.</p> <p>6. Za obračun radnog perioda za isto radno mesto, računa se celokupan obavljen period to radno mesto od strane</p>
---	---	--

<p>punonjës të ndryshëm të huaj, për llogari të punëdhënësit.</p> <p>7. Në mungesë të marrëveshjeve dypalëshe apo shumëpalëshe, i huaji që pajiset me lejeqëndrim brenda shoqërive tregtare i nënshtrohet legjislacionit vendas të mbrojtjes sociale.</p> <p style="text-align: center;">Neni 66 Kuota vjetore e punësimit të shtetasve të huaj</p> <p>1. Qeveria e Republikës së Kosovës me vendim mund të përcaktojë kuotën vjetore të punësimit të të huajve, jo më vonë se deri më 31 tetor për vitin e ardhshëm. Kuota vjetore e punësimit për të huajt bëhet publike.</p> <p>2. Propozimin e kuotës vjetore për punësimin e të huajve e bën ministria përkatëse për punë në bashkëpunim me MPB-në, duke marrë për bazë rekomandimin e Këshillit Ekonomiko-Social.</p> <p>3. Kuota vjetore për punësimin e të huajve përcaktohet në harmoni me politikën e migrimit dhe gjendjen në tregun e punës, në përputhje me nevojat</p>	<p>different foreign employees, on behalf of the employer, shall be calculated.</p> <p>7. In the absence of bilateral or multilateral agreements, a foreigner who is provided with a residence permit within business organizations shall be subject to local legislation on social protection.</p> <p style="text-align: center;">Article 66 Annual employment quota of foreign nationals</p> <p>1. The Government of the Republic of Kosovo may by decision determine the annual quota of employment of foreigners no later than 31 October for the following year. The annual employment quota for foreigners shall be made public.</p> <p>2. The proposal of the annual quota for the employment of foreigners shall be made by the relevant Ministry of Labour in cooperation with MIA, based on the recommendation of the Economic and Social Council.</p> <p>3. The annual quota for the employment of foreigners shall be set in line with the migration policy and the situation in the labour market, in accordance with the</p>	<p>različitim zaposlenih stranac, na račun poslodavca.</p> <p>7. U nedostatku bilateralnih ili multilateralnih sporazuma, stranac kome se izdaje dozvola za boravak unutar privrednog društva podleže domaćem zakonodavstvu o socijalnoj zaštiti.</p> <p style="text-align: center;">Član 66 Godišnja kvota za zapošljavanje stranih državljana</p> <p>1. Vlada Republike Kosovo može odlukom da utvrđuje godišnju kvotu za zapošljavanje stranaca, najkasnije do 31. oktobra, za narednu godinu. Godišnja kvota za zapošljavanje stranaca objavljuje se javno.</p> <p>2. Predlog godišnje kvote za zapošljavanje stranaca daje relevantno ministarstvo za rad, u saradnji se MUP, uzimajući u obzir preporuku Ekonomsko-socijalnog saveta.</p> <p>3. Godišnja kvota za zapošljavanje stranaca utvrđuje se u skladu sa politikom migracije i stanja na tržištu rada, i u skladu sa potrebama i mogućnostima za</p>
--	--	--

<p>dhe mundësitë e punësimit të të huajve në Republikën e Kosovës.</p> <p>4. Me kuotën vjetore për punësimin e të huajve përcaktohen veprimtaritë dhe profesionet në të cilat lejohet punësimi i ri, si dhe kuota për secilën veprimtari dhe profesion.</p> <p>5. Me kuotën vjetore për punësimin e të huajve mund të përcaktohet edhe kuota për punësim sezonal.</p> <p>6. Në rastet kur Qeveria e Republikës së Kosovës nxjerr vendim sipas paragrafit 1 të këtij neni, përcaktohen kategoritë për të cilat lëshohet lejeqëndrim për punë jashtë kuotës vjetore të punësimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 67 Lejeqëndrimi në bazë të kuotës vjetore për punësimin e të huajve</p> <p>1. Lejeqëndrimi në bazë të kuotës vjetore nga neni 66 i këtij ligji i lejohet të huajit, i cili i plotëson kriteret nga neni 33 i këtij ligji dhe ka dokumentet si në vijim:</p>	<p>needs and possibilities of employment of foreigners in the Republic of Kosovo.</p> <p>4. The annual quota for the employment of foreigners shall determine the activities and professions in which new employment is allowed, as well as the quota for each activity and profession.</p> <p>5. With the annual quota for the employment of foreigners, the quota for seasonal employment may also be set.</p> <p>6. In cases where the Government of the Republic of Kosovo issues a decision according to paragraph 1 of this Article, the categories for which a residence permit is issued for work outside the annual employment quota shall be determined.</p> <p style="text-align: center;">Article 67 Residence permit based on the annual quota for the employment of foreigners</p> <p>1. A residence permit based on the annual quota from Article 66 of this Law shall be granted to a foreigner who meet the criteria from Article 33 of this Law and has the following documents:</p>	<p>zapošljavanje stranaca u Republici Kosovo.</p> <p>4. Godišnjom kvotom za zapošljavanje stranaca utvrđuju se delatnosti i profesije, kojima se odobrava novo zapošljavanje, kao i kvota za svaku delatnost i profesiju.</p> <p>5. Godišnjom kvotom za zapošljavanje stranaca, može se utvrditi i kvota za sezonsko zapošljavanje.</p> <p>6. U slučajevima kada Vlada Republike Kosovo donosi odluku, u skladu sa stavom 1. ovog člana, utvrđuju se kategorije za koje se izdaje dozvola za boravak po osnovu zapošljavanja izvan godišnje kvote za zapošljavanje.</p> <p style="text-align: center;">Član 67 Dozvola za boravak po osnovu zapošljavanja na osnovu godišnje kvote za zapošljavanje stranaca</p> <p>1. Dozvola za boravak po osnovu zapošljavanja na osnovu godišnje kvote iz člana 66. ovog zakona biće odobrena strancu, koji ispunjava uslove iz člana 33. ovog zakona, i koji treba da takođe ima sledeću dokumentaciju:</p>
---	--	--

<p>1.1. kontratën e punës, respektivisht vërtetimin me shkrim për lidhjen e kontratës për punë ose dëshminë adekuate të punës;</p> <p>1.2. dëshminë mbi arsimimin, ose kualifikimin e fituar apo aftësimin e të huajit në vendin e punës;</p> <p>1.3. dëshminë mbi regjistrimin e shoqërisë tregtare, shoqatës, degës, përfaqësisë apo organizatës në Republikën e Kosovës.</p> <p>2. Të njëjtat kriteret sipas këtij neni vlejshëm edhe për marrjen e lejeqëndrimit për punë jashtë kuotës vjetore.</p> <p>3. Qeveria, përcakton me akt nënligjor, pas propozimit të MPB-së, kriteret e veçanta për secilën kategori të të huajve të cilët përfitojnë lejeqëndrimin për punë jashtë kuotës vjetore.</p>	<p>1.1. an employment contract, namely a written confirmation of the conclusion of the work contract or the adequate evidence of work;</p> <p>1.2. evidence of the foreigner's education, or acquired qualification or on-the-job training;</p> <p>1.3. a certificate of registration of the business organization, association, branch, representative office or organization in the Republic of Kosovo.</p> <p>2. The same criteria under this Article shall also apply to obtaining a residence permit for work outside the annual quota.</p> <p>3. The Government shall by a bylaw, upon the proposal of MIA, define the special criteria for each category of foreigners who benefit from the residence permit for work outside the annual quota.</p>	<p>1.1. ugovor o radu, odnosno pismenu potvrdu o zaključivanju ugovoru o radu ili adekvatan dokaz o zapošljavanju;</p> <p>1.2. dokaz o obrazovanju, ili stečenu kvalifikaciju ili usavršavanje stranca na radnom mestu;</p> <p>1.3. dokaz o registraciji privrednog društva, udruženja, ogranka, predstavništva ili organizacije u Republici Kosovo.</p> <p>2. Isti kriterijumi iz ovog člana, važe i za izdavanje dozvole za boravak po osnovu zapošljavanja izvan godišnje kvote.</p> <p>3. Vlada, podzakonskim aktom, nakon predloga MUP-a, utvrđuje posebne kriterijume za svaku kategoriju stranaca koji steknu dozvolu za boravak po osnovu zapošljavanja izvan godišnje kvote.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 68 Vendimi për dhënien e lejeqëndrimit për punë</p>	<p style="text-align: center;">Article 68 Decision on granting a work permit</p>	<p style="text-align: center;">Član 68 Odluka o izdavanju dozvole za boravak po osnovu zapošljavanja</p>
<p>1. Lidhur me kërkesën për pajisjen me lejeqëndrim për punë vendos MPB, pas miratimit për punësim të marrë nga APRK-ja.</p> <p>2. Lejeqëndrimi për punë i lëshohet shtetasit të huaj për kohën sa është e nevojshme për kryerjen e punës, respektivisht për kohën për të cilën është lidhur kontrata e punës ose kontrata tjetër përkatëse, jo më pak se nëntëdhjetë (90) ditë dhe jo më gjatë se një (1) vit.</p> <p>3. Përjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, të huajt i cili është pajisur me lejeqëndrim për punë dy (2) herë radhazi dhe ka kontratë pune pa afat, i lëshohet lejeqëndrim me afat të vlefshmërisë prej dy (2) vitesh, nëse nuk kërkon lëshimin e lejeqëndrimit për punë për periudhë më të shkurtër.</p> <p>4. Kundër vendimit sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të ushtrohet ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i</p>	<p>1. Regarding the application for obtaining an employment work residence, MIA shall decide after the approval for employment received from the EARK.</p> <p>2. A residence permit shall be issued to a foreigner for the time necessary to perform the work, namely for the time for which the employment contract or other relevant contract was concluded, not less than ninety (90) days and not longer than one (1) year.</p> <p>3. In derogation from paragraph 2 of this Article, a foreigner who has been granted a residence permit for work for two consecutive times and has an employment contract for an indefinite term, shall be issued a residence permit with a validity period of two (2) years, if he or she does not request the issuance of a residence permit for work for a shorter period.</p> <p>4. The decision according to paragraph 1 of this Article may be appealed before the Foreigners' Appeals Commission within</p>	<p>1. O zahtevu za izdavanje dozvole za boravak po osnovu zapošljavanja odlučuje MUP, nakon dobijenog odobrenja za zapošljavanje od AZRK-a.</p> <p>2. Dozvola za boravak po osnovu zapošljavanja izdaje se stranom državljaninu na vreme koje je potrebno za obavljanje poslova, odnosno na vreme na koje je zaključen ugovor o radu ili drugi relevantni ugovor, ne manje od devedeset (90) dana, i ne duže od jedne (1) godine.</p> <p>3. Izuzetno od stava 2. ovog člana, strancu kome je izdata dozvola za boravak po osnovu zapošljavanja dva puta uzastopno i ima ugovor o radu na neodređeno vreme, izdaje mu se dozvola za boravak sa rokom važenja od dve (2) godine, ako ne traži izdavanje dozvole za boravak po osnovu zapošljavanja na kraći period.</p> <p>4. Na odluku iz stava 1. ovog člana, može se podneti žalba Žalbenoj komisiji za</p>

<p>vendimit në Komisionin e Ankesave për të Huajt.</p> <p style="text-align: center;">Neni 69 Refuzimi i lëshimit të lejeqëndrimit për punë</p> <p>1. Të huajt i refuzohet kërkesa për pajisje me lejeqëndrim për punë në rastet kur:</p> <p>1.1. nuk plotëson, ose nuk plotëson më, kriteret për marrje të lejeqëndrimit për punë;</p> <p>1.2. punëdhënësi shkel legjislacionin e punës dhe dispozitat e mbrojtjes në punë, sigurimit shëndetësor dhe pensional, shmanget nga tatimi, ose në rastet kur i huaji ose punëdhënësi nuk kanë paguar një dënim me gjobë;</p> <p>1.3. punëdhënësi është duke u mbyllur apo është mbyllur në bazë të legjislacionit përkatës në fuqi mbi falimentimin ose nuk është duke zhvilluar asnjë aktivitet ekonomik;</p> <p>1.4. shtetasi i huaj nuk ka respektuar detyrimet që rrjedhin nga</p>	<p>thirty (30) days from the acceptance of the decision.</p> <p style="text-align: center;">Article 69 Refusal to issue a residence permit for work</p> <p>1. A foreigner's application for obtaining a residence permit for work shall be rejected in cases where:</p> <p>1.1. he or she fails to meet, or no longer meets, the criteria for obtaining a residence permit;</p> <p>1.2. the employer violates the labour legislation and the provisions of occupational safety, health and pension insurance, evades tax or in cases where the foreigner or the employer has not paid a fine;</p> <p>1.3. the employer is being closed or has been closed based on the relevant legislation on bankruptcy or is not conducting any business activity;</p> <p>1.4. the foreigner has not complied with the obligations arising from the</p>	<p>strance u roku od trideset (30) dana od prijema odluke.</p> <p style="text-align: center;">Član 69 Odbijanje dozvole za boravak po osnovu zapošljavanja</p> <p>1. Strancu se odbija izdavanje dozvola za boravak po osnovu zapošljavanja, u slučajevima kada:</p> <p>1.1. ne ispunjava, ili više ne ispunjava kriterijume za dobijanje dozvole za boravak po osnovu zapošljavanja;</p> <p>1.2. poslodavac krši zakonodavstvo o radu i odredbe o zaštiti na radu, zdravstvenog i penzijskog osiguranja, utaju poreza ili u slučajevima kada stranac ili poslodavac nije platio novčanu kaznu;</p> <p>1.3. poslodavac je u procesu zatvaranja ili je zatvoren na osnovu relevantnog važećeg zakonodavstva o stečaju ili ne obavlja nikakvu ekonomsku delatnost;</p> <p>1.4. strani državljanin nije ispoštovao obaveze koje proizilaze iz prethodne</p>
--	--	--

<p>vendimi paraprak për lëshimin e lejeqëndrimit;</p> <p>1.5. punëdhënësi është sanksionuar në përputhje me ligjin në fuqi për punë të padeklaruar ose punësim të paligjshëm;</p> <p>1.6. punëdhënësi është themeluar për qëllim kryesor të lehtësimit të hyrjes së të huajve për transferim brenda shoqërive tregtare;</p> <p>1.7. punëdhënësi ka refuzuar të punësojë një punëkërkuar të papunë, ofruar nga zyra e punësimit, i cili plotëson kushtet e përcaktuara nga autoritetet shtetërore përgjegjëse, sipas dispozitave të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 70 Shfuqizimi i lejeqëndrimit për punë</p> <p>1. Përveç rasteve të përcaktuara në nenin 56 të këtij ligji, lejeqëndrimi për punë shfuqizohet edhe nëse:</p> <p>1.1. i huaji kryen punë tjetër nga ajo për të cilën i është lëshuar</p>	<p>preliminary decision on the issuance of the residence permit;</p> <p>1.5. the employer has been sanctioned in accordance with the applicable law for undeclared work or illegal employment;</p> <p>1.6. the employer was established for the main purpose of facilitating the entry of foreigners for transfer within commercial companies;</p> <p>1.7. the employer has refused to hire an unemployed jobseeker, referred by the employment office, who met the conditions determined by the responsible state authorities, according to the provisions of this Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 70 Revocation of work residence permit</p> <p>1. In addition to the cases defined in Article 56 of this Law, a work permit shall be revoked also revoked where:</p> <p>1.1. the foreigner performs work other than that for which the work residence permit was issued, except</p>	<p>odluke o izdavanju dozvole za boravak;</p> <p>1.5. poslodavac je kažnjen u skladu sa važećim zakonom o radu za neprijavljen rad ili nezakonito zapošljavanje;</p> <p>1.6. poslodavac je osnovan sa glavnim ciljem olakšavanja ulaska stranaca za premeštaj unutar privrednih društava;</p> <p>1.7. poslodavac je odbio nezaposlenog tražioca posla, kojeg šalje kancelarija za zapošljavanje, koji je ispunio uslove utvrđene od strane nadležnih državnih organa, u skladu sa odredbama ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 70 Oduzimanje dozvole za boravak po osnovu zapošljavanja</p> <p>1. Osim slučajeva utvrđenih članom 56. ovog zakona, dozvola za boravak po osnovu zapošljavanja se oduzima i ako:</p> <p>1.1. stranac obavlja poslove za koje nije izdata dozvola za boravak po</p>
--	--	---

<p>lejeqëndrimi për punë, përveç kur përcaktohet ndryshe me këtë ligj;</p> <p>1.2. punëdhënësi apo i huaji nuk i respektojnë dispozitat e legjislacionit për punë, të mbrojtjes dhe sigurisë në punë, të sigurimit shëndetësor dhe sigurimit pensional;</p> <p>1.3. punëdhënësi është duke u mbyllur apo është mbyllur në bazë të legjislacionit përkatës në fuqi mbi falimentimin, ose nuk është duke zhvilluar aktivitet ekonomik.</p> <p>2. Kundër vendimit për shfuqizim, i huaji mund të ushtrojë ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve në Komisionin e Ankesave për të Huajt.</p> <p style="text-align: center;">Neni 71 Qëndrimi i të huajit në rast të ndërprerjes së kontratës</p> <p>1. I huaji, të cilit pa fajin e tij i është ndërprerë kontrata e punës ose kontrata tjetër përkatëse, ka të drejtë të qëndrojë në Republikën e Kosovës deri në skadimin e afatit të lejeqëndrimit për punë.</p>	<p>when otherwise determined by this Law;</p> <p>1.2. the employer or the foreigner fails to comply with the provisions of the legislation on labour, occupational health and safety and health and pension insurance;</p> <p>1.3. the employer is being closed or has been closed based on the relevant applicable legislation on bankruptcy or is not developing economic activity.</p> <p>2. The revocation decision may be appealed before the Foreigners' Appeals Commission within thirty (30) days.</p> <p style="text-align: center;">Article 71 Stay of a foreigner in case of contract termination</p> <p>1. A foreigner, whose employment contract or other relevant contract has been terminated without his fault, shall have the right to stay in the Republic of Kosovo until the expiration of the work residence permit.</p>	<p>osnovu zapošljavanja, osim ako nije drugačije određeno ovom zakonom ;</p> <p>1.2. poslodavac ili stranac ne poštuju odredbe iz zakonodavstva o radu, zaštite i bezbednosti na radu, zdravstvenog osiguranja i penzijskog osiguranja;</p> <p>1.3. poslodavac je u procesu zatvaranja ili je zatvoren na osnovu relevantnog važećeg zakonodavstva o stečajju ili ne obavlja nikakvu ekonomsku delatnost.</p> <p>2. Na odluku o oduzimanju, stranac može podneti žalbu Žalbenoj komisiji za strance, u roku od trideset (30) dana.</p> <p style="text-align: center;">Član 71 Boravak stranca u slučaju otkaza ugovora</p> <p>1. Strancu, kome je bez njegove krivice otkazan ugovor o radu ili drugi relevantni ugovor, ima pravo da boravi u Republici Kosovo do isteka roka dozvole za boravak po osnovu zapošljavanja.</p>
--	---	--

<p>2. Në rast të ndërprerjes së kontratës, punëdhënësi dhe i huaji janë të obliguar që ta lajmërojnë MPB-në jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e ndërprerjes.</p> <p style="text-align: center;">Neni 72 E drejta për trajtim të barabartë</p> <p>1. I huaji që punon në Republikën e Kosovës gëzon trajtim të barabartë me shtetasit e Republikës së Kosovës lidhur me:</p> <p>1.1. kushtet e punës sipas legjislacionit në fuqi për punë, përfshirë pagën, largimin, sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës;</p> <p>1.2. lirinë e asocimit, bashkimit dhe anëtarësimit në një organizatë që përfaqëson punëtorët ose punëdhënësit, ose çdo organizatë, anëtarët e të cilës janë të angazhuar në një profesion të veçantë, përfshirë të drejtat dhe përfitimet e dhëna nga organizata të tilla, pa cenuar legjislacionin në fuqi lidhur me politikën dhe sigurinë publike;</p> <p>1.3. arsimimin dhe trajnimin profesional;</p>	<p>2. In case of contract termination, the employer and the foreigner shall be obliged to notify MIA no later than fifteen (15) days from the day of termination.</p> <p style="text-align: center;">Article 72 The right to equal treatment</p> <p>1. A foreigner working in the Republic of Kosovo shall enjoy equal treatment as citizens of the Republic of Kosovo regarding:</p> <p>1.1. working conditions under applicable labour legislation, including pay, dismissal, safety and health in the workplace;</p> <p>1.2. freedom of association, union and membership in an organization representing workers or employers or any organization the members of which are engaged in a particular profession, including the rights and benefits granted by such organizations, without prejudice to the applicable legislation on policies and public safety;</p> <p>1.3. vocational education and training;</p>	<p>2. U slučaju otkaza ugovora, poslodavac i stranac su dužni da obaveste MUP, u roku od petnaest (15) dana od dana otkaza.</p> <p style="text-align: center;">Član 72 Pravo na jednak tretman</p> <p>1. Stranac koji radi u Republici Kosovo uživa isti tretman kao i državljani Republike Kosovo u vezi sa:</p> <p>1.1. uslovima rada, u skladu sa važećim zakonodavstvom o radu, uključujući zaradu, otkaz, bezbednost i zdravlje na radnom mestu;</p> <p>1.2. slobodom udruživanja, pridruživanja i članstva u organizaciji koja zastupa radnike ili poslodavce ili bilo koju organizaciju, čiji su članovi angažovani u posebnoj profesiji, uključujući prava i beneficije koje su dodeljene od takvih organizacija, bez ugrožavanja važećeg zakonodavstva o javnoj politici i javnoj bezbednošću;</p> <p>1.3. stručnim obrazovanjem i obukama;</p>
--	---	--

<p>1.4. njohjen e diplomave, certifikatave dhe kualifikimeve të tjera profesionale në përputhje me legjislacionin përkatës;</p> <p>1.5. dispozitat e legjislacionit përkatës lidhur me mbrojtjen sociale,</p> <p>1.6. qasjen në mallra dhe shërbime publike dhe furnizimin me këto të mallra dhe shërbime që i ofrohen publikut, duke përfshirë shërbimet për strehim;</p> <p>1.7. informimin dhe shërbimet e këshillimit që ofrohen nga zyrat e punësimit;</p> <p>1.8. lehtësira tatimore, për aq sa i huaji konsiderohet të jetë rezident për qëllime tatimore në Republikën e Kosovës</p> <p>3. I huaji, qoftë person fizik apo juridik, ka detyrime të barabarta në punë si shtetasi i Republikës së Kosovës.</p>	<p>1.4. recognition of diplomas, certificates and other professional qualifications in accordance with the relevant legislation;</p> <p>1.5. provisions of the relevant legislation regarding social protection,</p> <p>1.6. access to public goods and services and the provision of these goods and services to the public, including shelter services;</p> <p>1.7. information and counselling services provided by employment offices;</p> <p>1.8. tax facilities, as long as the foreigner is considered to be a resident for tax purposes in the Republic of Kosovo.</p> <p>3. A foreigner, whether a natural or legal person, shall have equal obligations at work as a citizen of the Republic of Kosovo.</p>	<p>1.4. priznavanjem diploma, uverenja i druge stručne spreme u skladu sa relevantnim zakonodavstvom;</p> <p>1.5. odredbama relevantnog zakonodavstva o socijalnoj zaštiti;</p> <p>1.6. pristupom javnim dobrima i uslugama i nabavkom ovih dobara i usluga, koje se pružaju javnošću, uključuju i usluge smeštaja;</p> <p>1.7. informacije i savetodavne usluge koje pružaju kancelarije za zapošljavanje;</p> <p>1.8. poreske olakšice, sve dok se stranac smatra rezidentnim za poreske svrhe u Republici Kosovo.</p> <p>3. Stranac, bilo fizičko ili pravno lice, ima jednake obaveze na radu kao i državljanin Republike Kosovo.</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;">Nënkapitulli 7 Qëndimi i përhershëm</p> <p style="text-align: center;">Neni 73 Qëndrimi i Përhershëm</p>	<p style="text-align: center;">Subchapter 7 Permanent stay</p> <p style="text-align: center;">Article 73 Permanent stay</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje 7 Stalni boravak</p> <p style="text-align: center;">Član 73 Stalni boravak</p>
<p>1. Lejeqëndrimi i përhershëm mund ti jepet të huajit që në kohën e parashtrimit të kërkesës posedon lejeqëndrim të përkohshëm prej pesë (5) vitesh pa ndërprerë në Republikën e Kosovës dhe plotëson kriteret si në vijim:</p> <p>1.1. posedon dokument të vlefshëm të udhëtimit;</p> <p>1.2. posedon mjete të mjaftueshme për jetesë;</p> <p>1.3. posedon sigurim shëndetësor;</p> <p>1.4. ofron dëshmi për adresën e saktë të vendbanimit në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.5. ofron dëshmi që nuk është i dënuar për vepër penale të lëshuar nga organet kompetente të Republikës së Kosovës.</p>	<p>1. A permanent residence permit may be issued to a foreigner who, at the time of submitting the application, has a consequent temporary residence permit for five (5) years in the Republic of Kosovo and meets the following criteria:</p> <p>1.1. possesses a valid travel document;</p> <p>1.2. possesses sufficient subsistence funds;</p> <p>1.3. has health insurance;</p> <p>1.4. provides evidence of the correct address of residence in the Republic of Kosovo;</p> <p>1.5. provides evidence that he or she has not been convicted of a criminal offence issued by the competent authorities of the Republic of Kosovo.</p>	<p>1. Dozvola za stalni boravak može se izdati strancu koji je u vreme podnošenja zahteva ima dozvolu za privremeni boravak neprekidno pet (5) godina u Republici Kosovo, i ispunjava sledeće kriterijume:</p> <p>1.1. ima važeću putnu ispravu;</p> <p>1.2. ima dovoljno sredstva za život;</p> <p>1.3. ima zdravstveno osiguranje;</p> <p>1.4. priloži dokaze o tačnoj adresi prebivališta u Republici Kosovo;</p> <p>1.5. priloži dokaze da nije osuđen za krivično delo izdat od strane nadležnih organa Republike Kosovo.</p>

<p>2. I huaji i cili ka pasur lejeqëndrim të përkohshëm të pandërprerë për tri (3) vite me qëllim të ribashkimit familjar me shtetasin e Republikës së Kosovës, apo me të huajin me qëndrim të përhershëm, gëzon të drejtën e pajisjes me lejeqëndrim të përhershëm.</p> <p>3. Periudha e mungesës në territorin Republikës së Kosovës nuk e ndërpret llogaritjen e afatit sipas paragrafit 1 të këtij neni, nëse ajo është më e shkurtër se gjashtë (6) muaj pa ndërprerë dhe në tërësi nuk e kalon periudhën prej dhjetë (10) muaj.</p> <p>4. Për arsye specifike të argumentuara ose të jashtëzakonshme, si dhe kur i huaji dërgohet jashtë territorit për motive punësimi në kuadër të shërbimeve ndërkufitare, pranohet një periudhë më e gjatë e mungesës se ajo e përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, me kusht që MPB të jetë njoftuar më parë për ekzistencën e këtyre rrethanave nga i huaji apo punëdhënësi i tij.</p> <p>5. Në kohën e aplikimit për lejeqëndrim të përhershëm duhet të jetë i vlefshëm lejeqëndrimi i përkohshëm.</p>	<p>2. A foreigner, who had a continuous temporary residence permit for three (3) years for the purpose of family reunification with a citizen of the Republic of Kosovo or with a foreigner with permanent residence, shall enjoy the right to be issued with a permanent residence permit.</p> <p>3. The period of absence in the territory of the Republic of Kosovo shall not stay the calculation of the term according to paragraph 1 of this Article, if it is shorter than six (6) continuous months and in total does not exceed the period of ten (10) months.</p> <p>4. For specific substantiated or exceptional reasons, as well as when a foreigner is sent outside the territory for reasons of employment in the course cross-border services, a longer period of absence than that defined in paragraph 3 of this Article shall be accepted, provided that MIA has been previously notified of the existence of such circumstances by the foreigner or his or her employer.</p> <p>5. At the time of applying for a permanent residence permit, the temporary residence permit should be valid.</p>	<p>2. Pravo na izdavanje dozvole za stalni boravak ima stranac koji je imao neprekidnu dozvolu za privremeni boravak tri (3) godine po osnovu spajanja porodice sa državljaninom Republike Kosovo ili sa strancem sa stalnim boravkom.</p> <p>3. Period odsustva sa teritorije Republike Kosova ne prekida računanje roka iz stava 1. ovog člana, ako je on kraći od šest (6) meseci neprekidno i ne prelazi ukupan period od deset (10) meseci.</p> <p>4. Iz posebnih argumentovanih ili vanrednih razloga, kao i kada je stranac upućen van teritorije radi zapošljavanja, u okviru pograničnih usluga, priznaje se duži period odsustva od onog koji je utvrđen u stavu 3. ovog člana, pod uslovom da je MUP prethodno obavšten o postojanju ovih okolnosti od strane stranca ili njegovog poslodavca.</p> <p>5. U vreme podnošenja zahteva za dozvolu za stalni boravak, treba da bude važeća dozvola za privremeni boravak.</p>
---	---	--

<p>6. Përjashtimisht paragrafit 1 të këtij neni, kategoritë e personave nën mbrojtje ndërkombëtare dhe personat pa shtetësi përjashtohen nga obligimi i nënparagrafit 1.1, 1.2 dhe 1.3 të paragrafit 1 të këtij neni.</p> <p style="text-align: center;">Neni 74 Llogaritja e kohës së nevojshme për lejeqëndrim të përhershëm</p> <p>1. Si periudhë e nevojshme për dhënie e lejeqëndrimit të përhershëm, sipas nenit 73 të këtij ligji, nuk llogaritet:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. lejeqëndrimi i lëshuar punëtorëve sezonalë dhe ofruesve të shërbimeve në emër të një punëdhënësi të huaj; dhe</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. koha e kaluar gjatë vuajtjes së dënimit me burg.</p> <p>2. Me qëllim të llogaritjes së kohës së nevojshme për lejeqëndrim të përhershëm sipas paragrafit 1 të këtij neni, periudha e qëndrimit për të huajin që i është dhënë lejeqëndrim i përkohshëm për qëllim të studimit ose për aftësim profesional llogaritet vetëm</p>	<p>6. In derogation from paragraph 1 of this Article, categories of persons under international protection and stateless persons shall be exempted from the obligation of subparagraphs 1.1, 1.2 and 1.3 of paragraph 1 of this Article.</p> <p style="text-align: center;">Article 74 Calculation of the time required for a permanent residence permit</p> <p>1. As a necessary period for issuing a permanent residence permit under Article 73 of this Law, the following shall not be counted:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. residence permit issued to seasonal workers and service providers on behalf of a foreign employer; and</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. time spent while serving a prison sentence.</p> <p>2. In order to calculate the time required for a permanent residence permit according to paragraph 1 of this Article, the period of stay for a foreigner who has been issued a temporary residence permit for the purpose of study or for vocational training as half of the time spent based on</p>	<p>6. Izuzetno od stava 1. ovog člana, kategorije lica pod međunarodnom zaštitom i lica bez državljanstva izuzeti su od obaveze iz tačke 1.1, 1.2 i 1.3, stava 1. ovog člana.</p> <p style="text-align: center;">Član 74 Obračun potrebnog vremena za dozvolu za stalni boravak</p> <p>1. Kao potreban period za izdavanje dozvole za stalni boravak prema članu 73. ovog zakona, neće se računati:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. dozvola za boravak izdata sezonskim radnicima i pružaocima usluga u ime stranog poslodavca, i</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. vreme provedeno na izdržavanju kazne zatvora.</p> <p>2. U cilju računanja potrebnog vremena za dozvolu za stalni boravak iz stava 1. ovog člana, strancu kome je izdata dozvola za privremeni boravak po osnovu studiranja ili po osnovu stručnog usavršavanja, period za boravak se računa samo polovina vremena</p>
--	--	---

<p>gjysma e kohës së kaluar në bazë të atij lejeqëndrimi.</p> <p>3. Përjashtimisht paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, personave me mbrojtje ndërkombëtare dhe personave pa shtetësi, nëse procedura e vendimmarrjes zgjat më shumë se tetëmbëdhjetë (18) muaj, llogaritja e kohës bëhet nga data e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare dhe njohjes së statusit të pashtetësisë. Nëse procedura zgjat më pak se tetëmbëdhjetë (18) muaj, llogaritet vetëm gjysma e kohës së kohëzgjatjes së procedurës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 75 Rrethanat e jashtëzakonshme për dhënien e lejeqëndrimit të përhershëm</p> <p>1. Përjashtimisht nga neni 73 i këtij ligji, lejeqëndrimi i përhershëm mund t'i jepet:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. të huajit që deri në ditën e parashtrimit të kërkesës ka së paku pesë (5) vite lejeqëndrim me status të mbrojtjes ndërkombëtare sipas Ligjit për Azil apo të huajit me status të personit pa shtetësi;</p>	<p>such residence permit shall be accounted for.</p> <p>3. In derogation from paragraphs 1 and 2 of this Article, for persons under international protection and stateless persons, if the decision-making procedure lasts more than eighteen (18) months, the time shall be calculated from the date of the request for international protection and recognition of the statelessness status. If the procedure lasts less than eighteen (18) months, only half of the duration of the procedure shall be accounted for.</p> <p style="text-align: center;">Article 75 Extraordinary circumstances for issuing a permanent residence permit</p> <p>1. In derogation from Article 73 of this Law, a permanent residence permit may be issued to:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. a foreigner who, until the day of submission of the application, has at least five (5) years of residence permit with the status of international protection according to the Law on Asylum or a foreigner with the status of a stateless person;</p>	<p>provedenog na osnovu te dozvole za boravak.</p> <p>3. Izuzetno od stava 1. i 2. ovog člana, za lica sa međunarodnom zaštitom i lica bez državljanstva ako postupak odlučivanja traje duže od osamnaest (18) meseci, vreme se računa od dana podnošenja zahteva za međunarodnu zaštitu i priznavanje statusa bez državljanstva. Ako postupak traje manje od osamnaest (18) meseci, računa se samo polovina vremena trajanja postupka.</p> <p style="text-align: center;">Član 75 Vanredne okolnosti za izdavanje dozvole za stalni boravak</p> <p>1. Izuzetno od člana 73. ovog zakona, dozvola za stalni boravak može se dati:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. strancu koji je do dana podnošenja zahteva ima najmanje pet (5) godina sa dozvolom za boravak sa statusom međunarodne zaštite u skladu sa Zakonom o azilu, ili strancu sa statusom lica bez državljanstva;</p>
---	---	--

<p>1.2. të huajit që ka qëndruar në territorin e Republikës së Kosovës pa ndërprerë së paku pesë (5) vitet e fundit para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk e ka të rregulluar statusin e qëndrimit dhe nuk mund të pajiset me dokumentet e nevojshme nga shteti i origjinës. Qëndrimi vërtetohet me dokumente që dëshmojnë qëndrimin e tij të pandërprerë në territorin e Republikës së Kosovës;</p> <p>1.3. fëmijës, të dy prindërit e të cilit në kohën e lindjes së tij kanë pasur lejeqëndrim të përhershëm, ose fëmijës që jeton me një prind vetëshqyes që ka lejeqëndrim të përhershëm;</p> <p>1.4. personave të cilët lirohen nga shtetësia e Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Të huajt nga paragrafi 1 i këtij neni nuk kërkohet t'i plotësojnë kriteret e parapara sipas paragrafit 1 nënparagrafit 1.1, 1.2 dhe 1.3 të nenit 73 të këtij ligji.</p> <p>3. Përfundimisht, personat të cilët lirohen nga shtetësia e Republikës së</p>	<p>1.2. a foreigner who stayed in the territory of the Republic of Kosovo for at least the last five (5) consecutive years before the entry into force of this Law, does not have his or her residence status regulated and may not be provided with the necessary documents from the state of origin. The stay shall be proven by documents that prove his or her consecutive stay in the territory of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.3. a child, whose both parents at the time of his or her birth had a permanent residence permit, or a child who lives with a single parent who has a permanent residence permit;</p> <p>1.4. persons who are released from the citizenship of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. A foreigner from paragraph 1 of this Article shall not be required to meet the criteria stipulated in paragraph 1, subparagraphs 1.1, 1.2 and 1.3 of Article 73 of this Law.</p> <p>3. Exceptionally, persons who are released from the citizenship of the</p>	<p>1.2. strancu, koji je boravio na teritoriji Republike Kosovo neprekidno najmanje pet (5) godina, pre stupanja na snagu ovog zakona i nema uređen status boravka i ne može dobiti potrebnu dokumentaciju iz zemlje porekla. Boravak se potvrđuje dokumentima koji dokazuju njegov neprekidni boravak na teritoriji Republike Kosovo;</p> <p>1.3. detetu, čiji su roditelji u vreme njegovog rođenja imali dozvolu za stalni boravak, ili detetu koje živi sa jednim samohranim roditeljom, koji ima dozvolu za stalni boravak;</p> <p>1.4. licima kojima je otpušteno državljanstvo Republike Kosovo.</p> <p>2. Strancima iz stava 1. ovog člana, ne traži se da ispunjavaju kriterijume propisane stavom 1. tačka 1.1, 1.2 i 1.3, člana 73. ovog zakona.</p> <p>3. Izuzetno, licima kojima je otpušteno državljanstvo Republike Kosovo, može</p>
--	---	---

<p>1. I huaji mund të detyrohet të paraqitet në periodha të rregullta kohore pranë Policisë së Kosovës kur:</p> <p>1.1. ndaj tij është nxjerrë vendimi për kthim dhe kërkohet të sigurohet zbatimi i këtij vendimi, apo nevojitet të mbikëqyret largimi i të huajit nga territori i Republikës së Kosovës;</p> <p>1.2. i huaji para vendimit për kthim ka pasur një adresë të saktë dhe të</p>	<p>1. A foreigner may be obliged to report at regular periods of time to the Kosovo Police when:</p> <p>1.1. a return decision has been issued against him or her and it is required to ensure the implementation of this decision or it is necessary to supervise the foreigner's removal from the territory of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.2. the foreigner before the return decision had a correct address known</p>	<p>1. Stranac može biti prinuđen da se javlja u redovnim vremenskim periodima Policiji Kosova, kada je:</p> <p>1.1. protiv njega doneta odluka o vraćanju i traži se da se obezbedi primena ove odluke ili je potrebno nadgledanje udaljavanja stranca sa teritorije Republike Kosovo;</p> <p>1.2. stranac, pre donošenja odluke o vraćanju imao tačnu adresu poznatu</p>

<p>njohur nga Policia e Kosovës dhe nuk i ka respektuar afatet e zbatimit vullnetar të vendimit për kthim, por nuk ka indikacione se i huaji mund t'i shmanget zbatimit të largimit; dhe</p> <p>1.3. vlerësohet interesi më i mirë i familjes së të huajit.</p> <p>2. I huaji me detyrim paraqitjeje duhet të informohet për arsyet e këtij detyrimi.</p> <p>3. Detyrimi për tu paraqitur mbetet në fuqi deri kur i huaji largohet nga territori.</p>	<p>by the Kosovo Police and did not comply with the deadlines for the voluntary implementation of the return decision, but there are no indications that the foreigner can avoid the implementation of dismissal; and</p> <p>1.3. the best interest of the foreigner's family is considered.</p> <p>2. A foreigner obliged to report shall be informed of the reasons for such obligation.</p> <p>3. The obligation to report shall remain in force until the foreigner leaves the territory.</p>	<p>Policiji Kosova i nije ispoštovao rokove za dobrovoljnu primenu odluke o vraćanju, ali ne postoje indicije da stranac može da izbegne sprovođenje udaljenja; i</p> <p>1.3. razmotren najbolji interes porodice stranca.</p> <p>2. Stranac koji je prinuđen da se javlja, treba da bude obavešten o razlozima ove obaveze.</p> <p>3. Obaveza javljanja ostaje na snazi dok se stranac udalji sa teritorije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 89 Sekuestrimi i mjeteve financiare ose paraqitja e garancisë</p> <p>1. Gjatë periudhës së zbatimit të vendimit për kthim, Policia e Kosovës mund ti sekuestrojë të huajit mjetet financiare deri në shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet e kthimit të tij.</p> <p>2. Paralelisht me masat e tjera, sipas vlerësimit rast pas rasti, Policia e Kosovës mund t'i kërkojë të huajit të</p>	<p style="text-align: center;">Article 89 Sequestration of funds or presentation of guarantee</p> <p>1. The Kosovo Police may, during the period of implementation of the return decision, seize the foreigner's funds, up to the amount necessary to cover the costs of his or her return.</p> <p>2. Similar to the other measures, according to the case-by-case assessment, the Kosovo Police may ask the foreigner</p>	<p style="text-align: center;">Član 89 Zaplena finansijskih sredstava i pružanje garancije</p> <p>1. Tokom perioda primene odluke o vraćanju, Policija Kosova može zapleniti strancu finansijska sredstva, do neophodnog iznosa za pokrivanje troškova njegovog vraćanja.</p> <p>2. Uparedo sa drugim merama, prema proceni od slučaja do slučaja, Policija Kosova može tražiti od stranca da pruža</p>

<p>paraqesë një garanci financiare me anë të së cilës mundëson kthimin e tij.</p> <p>3. Garancia financiare i kthehet të huajit menjëherë kur kjo vlerësohet se nuk është më e nevojshme, ose kur realizohet kthimi i të huajit.</p> <p>4. Garancia financiare nuk i kthehet të huajit, nëse ai i shmanget procedurave të kthimit.</p> <p>5. Forma e garancisë financiare si dhe shuma përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Ministri i MPB-së.</p>	<p>to present a financial guarantee by which it is enabled his or her return.</p> <p>3. The financial guarantee shall be returned to the foreigner immediately when it is assessed that it is no longer necessary or when the return of the foreigner is implemented.</p> <p>4. The financial guarantee shall not be returned to the foreigner if the same avoids the return procedures.</p> <p>5. The form of the financial guarantee as well as the amount shall be defined by a bylaw approved by the Minister of MIA.</p>	<p>novçanu garanciju preko koje se omogućava njegovo vraćanje.</p> <p>3. Novčana garancija se vraća strancu odmah kada se proceni da više nije potrebna ili kada se realizuje vraćanje stranca.</p> <p>4. Novčana garancija se ne vraća strancu, ako isti izbegava procedure vraćanja.</p> <p>5. Oblik novčane garancije kao i iznos, utvrđuju se podzakonskim aktom koji donosi ministar MUP-a.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 90 Qëndrimi i detyrueshëm në një territor të caktuar</p> <p>1. Policia e Kosovës i vendos kufizimin e lirisë së lëvizjes të huajit, duke e detyruar atë të qëndrojë në një territor të caktuar, në rastet kur:</p> <p>1.1. kthimi nuk mund të zbatohet për arsye objektive, ose për shkak të një detyrimi të marrë përsipër nga Republika e Kosovës në kuadër të një marrëveshjeje ndërkombëtare;</p>	<p style="text-align: center;">Article 90 Mandatory stay in a certain territory</p> <p>1. The Kosovo Police shall restrict the foreigner's freedom of movement, obliging him or her to stay in a certain territory, in cases where:</p> <p>1.1. the return may not be implemented for objective reasons or because of an obligation assumed by the Republic of Kosovo within an international agreement;</p>	<p style="text-align: center;">Član 90 Prinudni boravak na određenoj teritoriji</p> <p>1. Policija Kosova uspostavlja ograničenja slobode kretanja stranca, primoravajući ga da ostane na određenoj teritoriji, u sledećim slučajevima:</p> <p>1.1. vraćanje se ne može sprovesti iz objektivnih razloga ili zbog obaveze preuzete od strane Republike Kosovo, u okviru međunarodnog sporazuma;</p>

<p>1.2. ka përfunduar afati i ndalimit në qendër të mbajtjes dhe nuk është i mundur largimi i të huajit, ose për arsye humanitare i huaji nuk mund të mbahet i ndaluar;</p> <p>1.3. në rastet kur autoritetet e shëndetit publik, në bazë të një vlerësimi dhe sipas Rregullave Ndërkombëtare të Shëndetit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë rekomandojnë izolimin e të huajt për një periudhë të caktuar kohore.</p> <p>2. Ndaj vendimit për qëndrim në një territor të caktuar, i huaji ka të drejtë të parashtojë ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve në Komisionin e Ankesave për të Huajt. Komisioni nxjerr vendim brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i ankesës.</p> <p>3. Në vendimin për qëndrim në një territor të caktuar Policia e Kosovës përcakton rregullat e përgjithshme të qëndrimit si dhe territorin ku duhet të qëndrojë i huaji.</p> <p>4. Rregullat dhe procedurat për zbatimin e këtij neni përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri i MPB-së.</p>	<p>1.2. the period of detention in the detention centre has ended and it is not possible to leave the foreigner, or for humanitarian reasons, the foreigner may not be detained;</p> <p>1.3. in cases where the public health authorities, based on an assessment and according to the International Health Rules of the World Health Organization, recommend the isolation of the foreigner for a certain period of time.</p> <p>2. A foreigner shall be obliged to appeal against the decision to stay in a certain territory within thirty (30) days before the Foreigners' Appeals Commission. The Commission shall issue a decision within thirty (30) days of the receipt of the appeal.</p> <p>3. Kosovo Police shall, in the decision to stay in a certain territory, determine the general rules of stay as well as the territory where the foreigner should stay.</p> <p>4. The rules and procedures for the implementation of this Article shall be defined by a bylaw issued by the Minister of MIA.</p>	<p>1.2. završen je rok za zadržavanje u pritvorskom centru i nije moguće udaljavanje stranca, ili iz humanitarnih razloga stranac se ne može zadržati u pritvoru;</p> <p>1.3. u slučajevima kada organi javnog zdravlja, na osnovu procene i u skladu sa Međunarodnim zdravstvenim pravilnikom Svetske zdravstvene organizacije, preporučuju izolaciju stranca za određeni vremenski period.</p> <p>2. Na odluku o boravku na određenoj teritoriji, stranac ima pravo da podnese žalbu Žalbenoj komisiji za strance, u roku od trideset (30) dana. Komisija donosi odluku u roku od trideset (30) dana od prijema žalbe.</p> <p>3. Odlukom o boravku na određenoj teritoriji, Policija Kosova utvrđuje opšta pravila boravka kao i teritoriju u kojoj treba da boravi stranac.</p> <p>4. Pravila i procedure za sprovođenje ovog člana utvrđuju se podzakonskim aktom koji donosi ministar MUP-a.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 91 Statusi i Toleruar</p>	<p style="text-align: center;">Article 91 Tolerated Status</p>	<p style="text-align: center;">Član 91 Tolerisani status</p>
<p>1. MPB mund t'i japë statusin e toleruar të qëndrimit një të huaji i cili është subjekt i kthimit, kur për shkaqe objektive ekzekutimi i vendimit për kthim është i pamundur.</p> <p>2. Statusi i toleruar i jepet të huajit nëse përmbushet njëri nga kriteret në vijim:</p> <p>2.1. pamundësia e përcaktimit të identitetit;</p> <p>2.2. mungesa e dokumenteve të udhëtimit ose dokumenteve tjera që mundësojnë kthimin e të huajit;</p> <p>2.3. mungesa e bashkëpunimit diplomatik apo konsullor me vendin e origjinës së të huajit pengon kthimin e të huajit;</p> <p>2.4. rastet kur kthimi nuk mund të realizohet për arsye objektive, ose për shkak të një detyrimi të marrë përsipër nga Republika e Kosovës në kuadër të një marrëveshje ndërkombëtare.</p>	<p>1. MIA may grant a tolerated status of residence to a foreigner who is subject to return when for objective reasons the execution of the return decision is impossible.</p> <p>2. A tolerated status shall be granted to a foreigner if one of the following criteria is met:</p> <p>2.1. impossibility of determining identity;</p> <p>2.2 lack of travel documents or other documents enabling the foreigner's return;</p> <p>2.3 lack of diplomatic or consular cooperation with the foreigner's country of origin, which makes it impossible to return the foreigner;</p> <p>2.4 cases when the return may not be carried out for objective reasons or due to an obligation assumed by the Republic of Kosovo within the framework of an international agreement.</p>	<p>1. MUP može izdati tolerisani status boravka strancu koji je predmet vraćanja, kada je iz objektivnih razloga izvršenje odluke o vraćanju nemoguće.</p> <p>2. Tolerisani status izdaje se strancu ako je ispunjen jedan od sledećih kriterijuma:</p> <p>2.1. nemogućnost utvrđivanja identiteta;</p> <p>2.2. nedostatak putnih isprava ili drugih dokumenata koji onemogućavaju vraćanje stranca;</p> <p>2.3. nedostatak diplomatske ili konzularne saradnje sa zemljom porekla stranaca, što onemogućava vraćanje stranca;</p> <p>2.4. slučajevi kada se vraćanje ne može sprovesti iz objektivnih razloga ili zbog obaveze preuzete od strane Republike Kosovo, u okviru međunarodnog sporazuma.</p>

<p>3. Pavarësisht kohës së qëndrimit të të huajit me status të toleruar, koha e qëndrimit nuk llogaritet si qëndrim i ligjshëm në Republikën e Kosovës.</p> <p>4. Procedura, rregullat, kohëzgjatja, forma dhe përmbajtja e dëshmisë për statusin e toleruar përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Ministri i MPB-së.</p> <p>5. Dëshmia e statusit të toleruar nuk mund të përdoret për rihyrje në territorin e Republikës së Kosovës.</p>	<p>3. Regardless of the length of stay of a foreigner with a tolerated status, the length of stay shall not be counted as a legal stay in the Republic of Kosovo.</p> <p>4. The procedure, rules, duration, form and content of the testimony for a tolerated status shall be defined by a bylaw issued by the Minister of MIA.</p> <p>5. Evidence of a tolerated status may not be used for re-entry to the territory of the Republic of Kosovo.</p>	<p>3. Bez obzira na vreme boravka stranca sa tolerisanim statusom, vreme boravka se ne računa kao zakoniti boravak u Republici Kosovo.</p> <p>4. Procedure, pravila, trajanje, oblik i sadržaj dokaza o tolerisanom statusu, utvrđuju se podzakonskim aktom koji donosi ministar MUP-a.</p> <p>5. Dokaz o tolerisanom statusu se ne može koristiti za ponovni ulazak na teritoriju Republike Kosovo.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 92 Ndërprerja e masave alternative</p> <p>1. Masat alternative ndërpriten nëse plotësohet njëri nga këto kushte:</p> <p>1.1. kanë pushuar arsyet mbi bazën e të cilave është dhënë masa;</p> <p>1.2. i huaji ka lëshuar territorin e Republikës së Kosovës;</p> <p>1.3. kanë ndryshuar rrethanat ligjore lidhur me statusin e qëndrimit të të huajit në territorin e Republikës së Kosovës;</p>	<p style="text-align: center;">Article 92 Termination of alternative measures</p> <p>1. Alternative measures shall be terminated if one of the following conditions is met:</p> <p>1.1. the reasons based on which the measure was imposed have ceased;</p> <p>1.2. the foreigner left the territory of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.3. the legal circumstances related to the status of the foreigner’s stay in the territory of the Republic of Kosovo have changed;</p>	<p style="text-align: center;">Član 92 Prestanak alternativnih mera</p> <p>1. Alternativne mere prestaju ako je ispunjen jedan od sledećih uslova:</p> <p>1.1. prestali su razlozi na osnovu kojih je izrečena mera;</p> <p>1.2. stranac je napustio teritoriju Republike Kosovo;</p> <p>1.3. promenjene su pravne okolnosti u vezi sa statusom boravka stranca na teritoriji Republike Kosovo;</p>

<p>1.4. i huaji përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë e Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 93 Ndalimi i të huajit në qendra të mbajtjes</p> <p>1. I huaji që i nënshtrohet zbatimit me forcë të vendimit për kthim mund të ndalohej në qendra të dedikuara për ndalim, në të cilat të huajt i kufizohet lëvizja në afate sa më të shkurtra kohore, derisa të kryhen procedurat për të mundësuar largimin e tij nga Republika e Kosovës.</p> <p>2. Ndalimi sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të bëhet me vendim të Gjykatës apo me vendim administrativ të Policisë së Kosovës.</p> <p>3. Ndalimi sipas paragrafit 1 të këtij neni është masa e fundit që ekzekutohet nga Policia e Kosovës ndaj të huajit për të cilin është nxjerrë vendim për kthim, në bazë të vlerësimit rast pas rasti, kur janë zbatuar të gjitha masat e mundshme alternative apo kur nga vlerësimi</p>	<p>1.4. the foreigner poses a threat to the order and security of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Article 93 Detention of foreigners in detention centres</p> <p>1. A foreigner who is subject to the forceful implementation of the return decision may be detained in dedicated detention centres, in which the foreigner's movement is restricted to the shortest possible time until the procedures to enable his or her removal from the Republic of Kosovo are completed.</p> <p>2. The ban according to paragraph 1 of this Article may be imposed by a Court decision or by an administrative decision of the Kosovo Police.</p> <p>3. The ban according to paragraph 1 of this Article shall be the last resort which is executed by the Kosovo Police, against a foreigner for whom a return decision has been issued based on a case-by-case assessment, when all possible alternative measures have been implemented or</p>	<p>1.4. stranac predstavlja pretnju po red i bezbednost Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Član 93 Zadržavanje stranca u pritvornom centru</p> <p>1. Stranac koji je predmet prinudne primene odluke o vraćanju, može biti zadržan u centrima namenjenim za zadržavanje, u kojima je strancu ograničeno kretanje, u najkraćim mogućim rokovima, dok se ne sprovedu zakonske procedure koje omogućavaju njegovo udaljenje iz Republike Kosova.</p> <p>2. Zadržavanje iz stava 1. ovog člana može se vršiti odlukom suda ili administrativnom odlukom Policije Kosova.</p> <p>3. Zadržavanje iz stava 1. ovog člana je zadnja mera, koju izvršava Policija Kosova protiv stranca, za kojeg je doneta odluka o vraćanju, na osnovu procene od slučaja do slučaja, kada su primenjene sve moguće alternativne mere ili kada se iz procene smatra da se takve mere ne mogu primeniti.</p>
--	--	--

<p>konsiderohet se këto masa nuk mund të zbatohen.</p> <p>4. Qendrat, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të plotësojnë të gjitha kushtet e trajtimit njerëzor si dhe respektimin e të drejtave njerëzore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të mundësojnë ofrimin e shërbimeve shëndetësore.</p> <p>5. Në rast të ndalimit të një të huaji në qendrat sipas paragrafit 1 të këtij neni, me kërkesën e të huajit, Policia e Kosovës merr masa të menjëhershme në bashkëpunim me autoritetet tjera kompetente për kujdesin ndaj anëtarëve të familjes së të huajit të ndaluar që kanë mbetur pa mbikëqyrje.</p> <p>6. Në rastet kur i huaji i ndaluar është në procedurë të kthimit dhe parashtron kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare e tërë procedura e shqyrtimit të kërkesës zhvillohet në qendër të mbajtjes, përveç në rastet kur autoriteti kompetent vlerëson ndryshe.</p> <p>7. Ndalimi i të huajit sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet me vendim me shkrim në njërën nga gjuhët zyrtare, i cili përmban arsyen e ndalimit, afatin e ndalimit, të</p>	<p>when the assessment considers that these measures may not be applied.</p> <p>4. The centres under paragraph 1 of this Article shall fulfil all the conditions of human treatment as well as the respect of human rights guaranteed by the Constitution of the Republic of Kosovo and enable the provision of health services.</p> <p>5. In case of detention of a foreigner in the centres under paragraph 1 of this Article, at the request of the foreigner, the Kosovo Police shall take immediate measures in cooperation with other competent authorities to take care of the family members of the detained foreigner who have been left without supervision.</p> <p>6. In cases where a detained foreigner is under the return procedure and submits a request for international protection, the entire procedure of examining the request shall take place in the detention centre, unless otherwise assessed by the competent authority.</p> <p>7. The detention of a foreigner under paragraph 1 of this Article shall be made by a written decision in one of the official languages, containing the reason for the</p>	<p>4. Centri iz stava 1. ovog člana, treba da ispune sve uslove humanog postupanja kao i poštovanja ljudskih prava zagarantovanih Ustavom Republike Kosovo i da omoguće pružanje zdravstvenih usluga.</p> <p>5. U slučaju zadržavanja stranca u centrima iz stava 1. ovog člana, na zahtev stranca, Policija Kosova preuzima hitne mere, u saradnji sa drugim nadležnim organima, za zbrinjavanje članova porodice zadržanog stranca, koji su ostali bez nadzora.</p> <p>6. U slučajevima kada je zadržani stranac u proceduri vraćanja i podnese zahtev za međunarodnu zaštitu, celokupna procedura razmatranja zahteva odvija se u pritvornom centru, osim u slučajevima kada nadležni organ drugačije oceni.</p> <p>7. Zadržavanje stranca iz stava 1. ovog člana, vrši se pismenom odlukom na jednom od službenih jezika, koja sadrži razlog za zadržavanje, rokove</p>
---	---	---

<p>drejtën për sigurimin e mbrojtjes ligjore të tij, të drejtën dhe afatin për mjetet juridike, si dhe të drejtën që të kontaktojë me të afërmit e tij.</p> <p>8. Në rast të kërkesës nga i huaji autoriteti kompetent i ofron me shkrim apo me gojë elementet kryesore të vendimit në njërën nga gjuhët që i huaji e kupton, apo supozohet që kupton.</p> <p>9. Rregullat dhe procedurat për zbatim të këtij neni, duke përfshirë rregullat e brendshme për menaxhimin e qendrave, si dhe forma e vendimit për ndalim përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Ministri i MPB-së.</p> <p style="text-align: center;">Neni 94 Ankesa ndaj vendimit për ndalim në qendër të mbajtjes</p> <p>1. Kundër vendimit për ndalim i huaji ka të drejtë të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda dyzetetë (48) orëve pas pranimit të vendimit për ndalim ose për zgjatjen e ndalimit. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit.</p>	<p>detention, the terms of the detention, the right to ensure his or her legal protection, the right and deadlines for legal remedies, as and the right to contact his or her relatives.</p> <p>8. The competent authority shall, in case of a request from the foreigner, provide the key elements of the decision in writing or orally in one of the languages that the foreigner understands or is assumed to understand.</p> <p>9. The rules and procedures for the implementation of this Article, including the internal rules for the management of the centres, as well as the form of the ban decision shall be defined by a bylaw adopted by the Minister of MIA.</p> <p style="text-align: center;">Article 94 Appeal against the decision on detention in the detention centre</p> <p>1. A foreigner shall be entitled to initiate an administrative conflict against the decision on detention before the competent court within forty (48) hours of the receipt of the decision on detention or the extension of the detention. The initiation of the administrative conflict</p>	<p>zadržavanja, pravo na obezbeđenje njegove pravne zaštite, pravo i rokove za pravne lekove, kao i pravo da kontaktira svoje bližnje.</p> <p>8. Nadležni organ, u slučaju zahteva stranca, pismeno ili usmeno iznosi osnovne elemente odluke na jednom od jezika koja stranac razume ili za koje se pretpostavlja da razume</p> <p>9. Pravila i procedure za sprovođenje ovog člana, uključujući interna pravila za upravljanje centrima, kao i oblik odluke o zadržavanju, utvrđuju se podzakonskim aktom koji donosi ministar MUP-a.</p> <p style="text-align: center;">Član 94 Žalba na odluku o zadržavanju u pritvornom centru</p> <p>1. Na odluku o zadržavanju, stranac ima pravo da pokrene upravni spor pred nadležnim sudom u roku od četrdeset osam (48) sati od dana prijema odluke o zadržavanju ili produženju zadržavanja. Pokretanje upravnog spora ne obustavlja izvršenje odluke.</p>
--	---	--

<p>2. Gjykata kompetente vendos lidhur me ligjshmërinë e vendimit për ndalim në afat prej shtatëdhjetë e dy (72) orëve pas inicimit të konfliktit administrativ.</p> <p style="text-align: center;">Neni 95 Kohëzgjatja e ndalimit</p> <p>1. I huaji mund të ndalohet në qendrat e mbajtjes për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj.</p> <p>2. Policia e Kosovës mund të zgjasë periudhën e ndalimit deri në dymbëdhjetë (12) muaj të tjerë, nëse brenda periudhës gjashtë (6) mujore të ndalimit, largimi i të huajit ka qenë i pamundur dhe atë në rastet kur:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. i huaji refuzon të japë të dhëna apo informacione personale si dhe dokumente udhëtimi të nevojshme për kthimin e tij, ose paraqet informacione të rreme;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. i huaji ka penguar kthimin e tij në forma të ndryshme; apo</p>	<p>shall not stay the execution of the decision.</p> <p>2. The competent court shall rule on the legality of the decision on detention within seventy-two (72) hours after the initiation of the administrative conflict.</p> <p style="text-align: center;">Article 95 Duration of detention</p> <p>1. A foreigner may be detained in detention centres for a period of up to six (6) months.</p> <p>2. The Kosovo Police may extend the period of detention up to another twelve (12) months if within the six (6) month period of detention, the foreigner's removal is impossible and in cases where:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1 a foreigner refuses to provide personal data or information as well as travel documents necessary for his or her return or presents false information;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2 a foreigner has prevented his or her return in various forms; or</p>	<p>2. Nadležni sud odlučuje o zakonitosti odluke o zadržavanju u roku od sedamdeset dva (72) sata od pokretanje upravnog spora.</p> <p style="text-align: center;">Član 95 Trajanje zadržavanja</p> <p>1. Stranac se može zadržati u pritvornim centrima na period do šest (6) meseci.</p> <p>2. Policija Kosova može da produži period zadržavanja za dvanaest (12) meseci, ako u roku od šest (6) meseci zadržavanja, nije bilo moguće udaljavanje stranca iz razloga, kao što su:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. stranac odbija da pruža lične podatke ili informacije kao i potrebne putne isprave za njegovo vraćanje, ili daje lažne informacije;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. stranac je ometao njegovo vraćanje u različitim oblicima; ili</p>
--	---	--

<p>2.3. ka vonesa në lëshimin e dokumentit të udhëtimit apo ndonjë dokumenti tjetër të nevojshëm për kthim.</p> <p>3. Shtyrja e afatit të ndalimit bëhet së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para mbarimit të afatit të ndalimit paraprak.</p> <p>4. Në rast të shtyrjes së ndalimit, vlejné dispozitat e nenit 93 të këtij ligji. Gjykata mund të rishikojë kohëzgjatjen e ndalimit sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë të të huajit.</p> <p>5. Gjatë kohës së ndalimit, Policia e Kosovës shqyrton rrethanat e ndalimit në bashkëpunim me MPB-në. Në varësi të vlerësimit të rrethanave, Policia e Kosovës mund të vendosë për zëvendësimin e masës së ndalimit me masa alternative.</p> <p>6. Në rast se plotësohen kushtet për kthimin e të huajit në vendin e origjinës, i huaji lirohet nga ndalimi dhe largohet nga Republika e Kosovës.</p>	<p>2.3 there are delays in issuing the travel document or any other document needed for return.</p> <p>3. Postponement of the detention period shall be made at least fifteen (15) days before the end of the preliminary detention period.</p> <p>4. In case of postponement of the detention, the provisions of Article 93 of this Law shall apply. The court may review the duration of the detention <i>ex officio</i> or at the request of the foreigner.</p> <p>5. During the detention, the Kosovo Police shall, in cooperation with MIA, examine the circumstances of the detention. Depending on the assessment of the circumstances, the Kosovo Police may decide to replace the detention measure with alternative measures.</p> <p>6. If the conditions for the return of a foreigner to the country of origin are met, a foreigner shall be released from detention and shall leave the Republic of Kosovo.</p>	<p>2.3. ima kašnjenja u izdavanju putne isprave ili bilo kojeg drugog dokumenta potrebnog za vraćanje.</p> <p>3. Odlaganje roka zadržavanja vrši se najmanje petnaest (15) dana pre isteka roka prethodnog zadržavanja.</p> <p>4. U slučaju odlaganja zadržavanja, primenjuju se odredbe člana 93. ovog zakona. Sud može preispitati trajanje zadržavanja <i>ex officio</i> ili na zahtev stranca.</p> <p>5. Tokom vremena zadržavanja, Policija Kosova u saradnji sa MUP-om razmatra okolnosti zadržavanja. U zavisnosti od procene okolnosti, Policija Kosova može da odlučuje o zameni mere zadržavanja sa alternativnom merom.</p> <p>6. Ako su ispunjeni uslovi za vraćanje stranca u zemlju porekla, stranac se oslobađa iz zadržavanja, i udaljava se iz Republike Kosovo.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 96 Ndalimi i grupeve të cenueshme</p> <p>1. Gratë, familjet, fëmijët, personat e moshuar dhe personat e sëmurë ndaj të cilëve është nxjerrë vendimi për ndalim, nëse ekzitojnë kushtet, akomodohen në hapësira të tjera nga institucionet shtetërore apo në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare.</p> <p>2. Në rast të pamundësisë për zbatim të paragrafit 1 të këtij neni, të huajt mund të mbahen vetëm në hapësira të ndara në qendra të mbajtjes, ku u sigurohet privatësia adekuate.</p>	<p style="text-align: center;">Article 96 Detention of vulnerable groups</p> <p>1. Women, families, children, elderly persons and sick persons against whom the decision of detention has been issued, if the conditions exist, shall be accommodated in other spaces, by state institutions or in cooperation with international organizations.</p> <p>2. In case of the impossibility of implementing paragraph 1 of this Article, the foreigners may only be accommodated in separate spaces in detention centres, where adequate privacy shall be ensured.</p>	<p style="text-align: center;">Član 96 Zadržavanje ranjivih grupa</p> <p>1. Žene, porodice, deca, starije osobe i bolesne osobe protiv kojih je doneta odluka o zadržavanju, ukoliko postoje uslovi, smeštaju se u druge prostorije, od strane državnih institucija ili u saradnji sa međunarodnim organizacijama.</p> <p>2. U slučaju nemogućnosti sprovođenja stava 1. ovog člana, stranca mogu se zadržati samo u posebnim prostorijama u pritvornim centrima, gde je obezbeđena adekvatna privatnost.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 97 Të drejtat e të huajit gjatë ndalimit në qendra të mbajtjes</p> <p>1. I huaji i cili qëndron në qendrat e mbajtjes, informohet në gjuhën e tij ose në gjuhën që ai e kupton apo supozohet që e kupton, për çdo veprim të ndërmarrë nga autoritetet kompetente për ndalimin e tij.</p> <p>2. I huaji gëzon të drejtën për trajtim njerëzor, ushqim të mjaftueshëm, ndihmë juridike falas, përkujdesje shëndetësore</p>	<p style="text-align: center;">Article 97 Foreinger's rights during detention in detention centres</p> <p>1. A foreigner who stays in detention centres shall be informed in his or her own language or in the language he or she understands or is assumed to understand, of any actions taken by the competent authorities for his or her detention.</p> <p>2. A foreigner shall enjoy the right to human treatment, adequate food, free legal aid, health care and psycho-social</p>	<p style="text-align: center;">Član 97 Prava stranca tokom zadržavanja u pritvornom centru</p> <p>1. Stranac, koji boravi u pritvornom centru, informiše se na svom jeziku ili na jeziku koji razume ili se pretpostavlja da razume, o svakoj radnji nadležnih organa za njegovo zadržavanje.</p> <p>2. Stranac uživa pravo na humano postupanje, dovoljnu hranu, besplatnu pravnu pomoć, zdravstvenu zaštitu i</p>

<p>dhe ndihmë psiko-sociale, qasje në informim, mjete të informimit dhe komunikimit si dhe të drejta të tjera në përputhje me rregullat e sigurisë në qendrat e mbajtjes.</p> <p>3. Me kërkesën e të huajit ose kur është përcaktuar me marrëveshje ndërkombëtare, MPB njofton përfaqësuesin diplomatik apo konsullor të vendit të të huajit në Republikën e Kosovës për ndalimin e të huajit, si dhe për kohëzgjatjen e periudhës së ndalimit.</p> <p>4. I huaji ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente për shkeljen e të drejtave të tij gjatë ndalimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 98 Kompensimi i shpenzimeve të kthimit</p> <p>1. I huaji ngarkohet me shpenzimet për kthimin e tij.</p> <p>2. Sekuestrimi i mjeteve financiare të të huajit që është subjekt kthimi, bëhet kundrejt lëshimit të një vërtetimi.</p>	<p>assistance, access to information, means of information and communication as well as other rights in accordance with the security rules in detention centres.</p> <p>3. At the request of a foreigner or when it is determined by international agreements, MIA shall notify the diplomatic or consular representative of the country of the foreigner in the Republic of Kosovo of the detention of the foreigner, as well as the duration of the detention period.</p> <p>4. A foreigner shall be entitled to file an appeal before the competent court about the violation of his or her rights during detention.</p> <p style="text-align: center;">Article 98 Compensation of return costs</p> <p>1. A foreigner shall be charged with the costs for his or her return.</p> <p>2. The sequestration of the funds of a foreigner who is subject to return shall be made against the issuance of a certificate.</p>	<p>psiko-socijalnu pomoć, pristup informisanju, sredstvima informisanja i komunikacije kao i druga prava u skladu sa bezbednosnim pravilima u pritvornim centrima.</p> <p>3. Na zahtev stranca ili kada je to utvrđeno međunarodnim sporazumom, MUP će obavestiti diplomatskog ili konzularnog predstavnika zemlje stranca u Republici Kosovo o zadržavanju stranca, kao i o trajanju zadržavanja.</p> <p>4. Stranac ima pravo da se žali nadležnom sudu zbog povrede njegovih prava tokom zadržavanja.</p> <p style="text-align: center;">Član 98 Nadoknada troškova vraćanja</p> <p>1. Stranac snosi troškove njegovog vraćanja.</p> <p>2. Zaplena finansijskih sredstava stranca koji je predmet vraćanja, vrši se uz izdavanje potvrde.</p>
---	---	---

<p>3. Mjetet financiare që i sekuestrohen të huajit përdoren vetëm për të mbuluar shpenzimet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.</p> <p>4. Nëse i huaji nuk ka mjete për mbulimin e shpenzimeve sipas paragrafit 1 të këtij neni, shpenzimet i ngarkohen personit fizik ose juridik, i cili ka mundësuar hyrjen ose qëndrimin e të huajit në territorin e Republikës së Kosovës, ose personit fizik apo juridik i cili ka marrë përsipër mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit dhe kthimit të të huajit nga territori i Republikës së Kosovës, transportuesit si dhe punëdhënësit i cili ka punësuar një të huaj në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.</p> <p>5. Në rastet kur mjetet nuk mund të sigurohen sipas paragrafit 1 dhe 4 të këtij neni, shpenzimet e kthimit mbulohen nga MPB.</p>	<p>3. The funds sequestrated from a foreigner shall be used only to cover the costs defined in paragraph 1 of this Article.</p> <p>4. If a foreigner does not have funds to cover the costs under paragraph 1 of this Article, the costs shall be charged to the natural or legal person who enabled the foreigner to enter or stay in the territory of the Republic of Kosovo, or the natural or legal person who has undertake to cover the costs of the foreigner's stay and return from the territory of the Republic of Kosovo, the carrier as well as the employer who has employed the foreigner in violation of the provisions of this Law.</p> <p>5. In cases where the means may not be provided according to paragraphs 1 and 4 of this Article, the return expenses are covered by the MIA.</p>	<p>3. Finansijska sredstva koja se zaplenjuju strancu, koriste se samo za pokrivanje troškova utvrđenih stavom 1. ovog člana.</p> <p>4. Ako stranac nema sredstva za pokrivanje troškova iz stava 1. ovog člana, troškove snosi fizičko ili pravno lice koje je omogućilo ulazak ili boravak stranca na teritoriji Republike Kosovo, ili fizičko ili pravno lice koje se obavezalo da pokrije troškove boravka i vraćanja stranca sa teritorije Republike Kosovo, prevoznik kao i poslodavac koji je zaposlio stranca u suprotnosti sa odredbama ovog zakona.</p> <p>5. U slučajevima kada se sredstva ne mogu obezbediti, u skladu sa stavom 1. i 4. ovog člana, troškovi vraćanja pokriva MUP.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 99 Fletëudhëtimi për të huajt</p> <p>1. Fletudhëtimi për të huajin, i vlefshëm për një dalje apo hyrje të vetme, lëshohet nga MPB për të huajin i cili nuk posedon dokument të vlefshëm të udhëtimit nëse:</p>	<p style="text-align: center;">Article 99 Travelpaper for foreigners</p> <p>1. The foreigner's travelpaper, valid for a single exit or entry, shall be issued by MIA to a foreigner who does not have a valid travel document if:</p>	<p style="text-align: center;">Član 99 Putni list za strance</p> <p>1. Putni list za stranca, koji važi za jedan izlazak ili ulazak, izdaje MUP za stranca koji ne poseduje važeću putnu ispravu ako:</p>

<p>1.1. lirohet nga shtetësia e Republikës së Kosovës, për të lëshuar territorin;</p> <p>1.2. ka humbur dokumentin e udhëtimit apo në ndonjë mënyrë tjetër ka mbetur pa të, ndërsa shteti, shtetasi i të cilit është, nuk ka mision diplomatik apo konsullor në Republikën e Kosovës; dhe</p> <p>1.3. është në procedurë të kthimit nga Republika e Kosovës;</p> <p>1.4. për qëllime humanitare.</p> <p>2. Nëse gjatë qëndrimit jashtë vendit i huaji ka humbur dokumentin e udhëtimit për refugjatë, dokumentin e udhëtimit për personat pa shtetësi apo personat nën mbrojtje plotësuese të lëshuara nga Republika e Kosovës, fletudhëtimi lëshohet nga misionet diplomatike apo konsullore të Republikës së Kosovës, në bazë të pëlqimit paraprak nga MPB.</p> <p>3. Fletudhëtimi për të huajt lëshohet me afat vlefshmërie prej tridhjetë (30) ditësh.</p> <p>4. Forma, përmbajtja dhe procedura për lëshimin e fletudhëtimit për të huajt</p>	<p>1.1. he or she is released from the citizenship of the Republic of Kosovo, to leave the territory;</p> <p>1.2. he or she has lost the travel document or in some other way has been left without it, while the country of which he or she is a citizen, does not have a diplomatic or consular mission in the Republic of Kosovo; and</p> <p>1.3. he or she is under the procedure of return from the Republic of Kosovo;</p> <p>1.4. for humanitarian purposes.</p> <p>2. If, during the stay abroad, the foreigner has lost the travel document for refugees, the travel document for stateless persons or persons under supplementary protection issued by the Republic of Kosovo, the travel document is issued by the diplomatic or consular missions of the Republic of Kosovo, based on prior consent from the MIA.</p> <p>3. The travelpaper for foreigners shall be issued for a validity period of thirty (30) days.</p> <p>4. The form, content and procedure for issuing travelpapers to foreigners shall be</p>	<p>1.1. otpušteno mu je državljanstvo Republike Kosovo, za napuštanje teritorije;</p> <p>1.2. izgubio je putnu ispravu ili je na drugi način ostao bez nje, dok zemlja, čiji je državljanin nema diplomatsko ili konzularno predstavništvo u Republici Kosovo;</p> <p>1.3. nalazi se u proceduri vraćanja iz Republike Kosovo;</p> <p>1.4. za humanitarne svrhe.</p> <p>2. Ako je za vreme boravka u inostranstvu, stranac izgubio putnu ispravu za izbeglice, putnu ispravu za lica bez državljanstva ili lica pod dodatnom zaštitom izdatu od strane Republike Kosovo, putni list se izdaje od strane diplomatskih ili konzularnih predstavništava Republike Kosovo, na osnovu prethodne saglasnosti MUP-a.</p> <p>3. Putni list za strance izdaje se sa rokom važenja od trideset (30) dana.</p> <p>4. Oblik, sadržaj i procedure za izdavanje putnog lista za strance, utvrđuju se</p>
--	---	--

<p>përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Ministri i MPB-së.</p> <p style="text-align: center;">Neni 100 Dokumentet e udhëtimit për të huajt</p> <p>1. MPB lëshon dokumentet e udhëtimit për të huajt të cilët nuk posedojnë dokument udhëtimi në rastet si në vijim:</p> <p>1.1. dokument udhëtimi për të huajin, i cili qëndron ligjërisht në Republikën e Kosovës por që nuk posedon dhe nuk është në gjendje të marrë një dokument udhëtimi nga shteti, shtetas i të cilit është;</p> <p>1.2. dokument udhëtimi për të huajin të cilit i është dhënë statusi i mbrojtjes ndërkombëtarë në pajtim me ligjin përkatës për azil; dhe</p> <p>1.3. dokument udhëtimi për personat me status të personit pa shtetësi.</p> <p>2. Forma, përmbajtja dhe procedura për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit të parapara në këtë nen, përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Ministri i MPB-së.</p>	<p>defined by a bylaw adopted by the Minister of MIA.</p> <p style="text-align: center;">Article 100 Travel documents for foreigners</p> <p>1. MIA shall issue travel documents to foreigners who do not have a travel document in the following cases:</p> <p>1.1. travel document for a foreigner, who legally resides in the Republic of Kosovo but who does not possess and is unable to obtain a travel document from the country of which he or she is a citizen;</p> <p>1.2. a travel document for a foreigner who has been granted international protection status in accordance with the relevant Law on Asylum; and</p> <p>1.3. travel document for stateless persons.</p> <p>2. The form, content and procedure for issuing the travel documents provided for in this Article shall be defined by a bylaw adopted by the Minister of MIA.</p>	<p>podzakonskim aktom koji donosi ministar MUP-a.</p> <p style="text-align: center;">Član 100 Putne isprave za strance</p> <p>1. MUP izdaje putne isprave za strance koji ne poseduju putnu ispravu, u sledećim slučajevima:</p> <p>1.1. putna isprava za stranca, koji zakonito boravi u Republici Kosovo, ali koji ne poseduje i nije u stanju da dobija putnu ispravu iz zemlje čiji je državljanin;</p> <p>1.2. putna isprava za stranca, kome je odobren status međunarodne zaštite u skladu sa relevantnim Zakonom o azilu; i</p> <p>1.3. putna isprava za lica sa statusom lica bez državljanstva.</p> <p>2. Oblik, sadržaj i procedura za izdavanje putnih isprava propisanih ovim članom, utvrđuju se podzakonskim aktom koji donosi ministar MUP-a.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 101 Refuzimi për lëshimin e dokumentit të udhëtimit për të huajt</p>	<p style="text-align: center;">Article 101 Refusal to issue a travel document to foreigners</p>	<p style="text-align: center;">Član 101 Odbijanje izdavanja putne isprave za strance</p>
<p>1. Dokument udhëtimi për të huajt nuk i lëshohet të huajt:</p> <p>1.1. kundër të cilit është duke u zhvilluar një procedurë penale, përveç nëse ekziston pëlqimi i organit shtetëror i cili zhvillon procedurën;</p> <p>1.2. i cili është i dënuar me burgim ose me gjobë për vepër penale, përderisa nuk e vuan dënimin apo derisa nuk paguan dënimin me gjobë;</p> <p>1.3. i cili nuk ka kryer detyrimet financiare ndaj shtetit.</p> <p>2. Një të huaji në proces të largimit mund t'i lëshohet fletudhëtimit për të huajt, pavarësisht rrethanave sipas paragrafit 1 të këtij neni.</p> <p>3. Kur vërtetohet se ekziston njëra prej arsyeve të parapara në paragrafin 1 të këtij neni, MPB shfuqizon vendimin dhe dokumentin e udhëtimit për të huajt.</p>	<p>1. A travel document for foreigners shall not be issued to a foreigner:</p> <p>1.1. against whom criminal proceedings are being conducted, unless there is the consent of the state authority conducting the proceedings;</p> <p>1.2. who is sentenced to imprisonment or a fine for a criminal offense, as long as he or she does not serve the sentence or until he or she does not pay the fine;</p> <p>1.3. who has not fulfilled his financial obligations to the state.</p> <p>2. A foreigner in the process of removal may be issued a foreigner's travel paper, regardless of the circumstances according to paragraph 1 of this Article.</p> <p>3. When it is proven that one of the reasons provided for under paragraph 1 of this Article exists, MIA shall revoke the decision and the travel document for foreigners.</p>	<p>1. Putna isprava za strance neće se izdati strancu:</p> <p>1.1. protiv kojeg se vodi krivični postupak, osim ako postoji saglasnost državnog organa koji vodi postupak;</p> <p>1.2. koji je osuđen kaznom zatvora ili kažnjen novčanom kaznom za krivično delo, dok ne izdrži kaznu ili dok ne plati novčanu kaznu;</p> <p>1.3. koji nije izmirio finansijske obaveze prema državi;</p> <p>2. Strancu koji je u procesu udaljenja, može se izdati putni list za strance, bez obzira na okolnosti iz stava 1. ovog člana.</p> <p>3. Kada se dokaže da postoji jedan od razloga propisanih stavom 1. ovog člana, MUP će ukinuti odluku i putnu ispravu za strance.</p>

4. Kundër vendimit për refuzimin apo shfuqizimin e vendimit për dokumentet e udhëtimit, i huaji brenda tridhjetë (30) ditëve ka të drejtë të parashtojë ankesë në Komisionin e Ankesave për të Huajt.

KAPITULLI V MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI

Neni 102 Mbikëqyrja dhe kontrolli i të huajve

1. Në ushtrim të detyrave të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi, gjatë mbikëqyrjes dhe kontrollit të të huajve Policia e Kosovës ndërmer veprimet si në vijim:

1.1. mbikëqyr zbatimin e rregullave të hyrjes dhe qëndrimit të të huajve, siç parashihet me këtë ligj;

1.2. kryen kontroll dhe hyn në mjedise private ku qëndron i huaji, në rast se ekziston dyshimi i bazuar, në përputhje me rregullat dhe kushtet e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale;

4. Against the decision to reject or revoke the decision on travel documents, the foreigner has the right to appeal with the Foreigners' Appeals Commission within thirty (30) days.

CHAPTER V SUPERVISION AND CONTROL

Article 102 Supervision and control of foreigners

1. The Kosovo Police shall, in the exercise of the duties provided for by the applicable legislation, during the supervision and control of foreigners, undertake the following actions:

1.1. supervises the implementation of the rules of entry and stay of foreigners, as provided for by this Law;

1.2. conducts control and enters private premises where the foreigner is staying, in case there is a grounded suspicion, in accordance with the rules and conditions provided for in the Criminal Procedure Code;

4. Protiv odluke o odbijanju ili ukidanju odluke o putnim ispravama stranac ima pravo žalbe Komisiji za žalbe stranaca u roku od trideset (30) dana.

POGLAVLJE V NADZOR I KONTROLA

Član 102 Nadzor i kontrola stranaca

1. Policija Kosova, u vršenju dužnosti propisanih u skladu sa važećim zakonodavstvom, tokom nadzora i kontrole stranaca, preduzima sledeće radnje:

1.1. nadzire primenu pravila ulaska i boravka stranaca, kako je propisano ovim zakonom;

1.2. vrši kontrole i ulazi u privatne objekte, gde boravi stranac, ukoliko postoji osnovana sumnja, u skladu sa pravilima i uslovima propisanim u Zakoniku o krivičnom postupku;

